

Financat
personale

në Duart tuaja

Nxënës!

Zgjidhni të ndiqni modulin me zgjedhje të lirë "Financat personale në duart tuaja", pasi njohuritë e përfituara prej tij do t'ju vijnë në ndihmë:

- 🍌 në jetën tuaj si konsumator,
- 🍌 në marrëdhëniet tuaja të ardhshme me bankat dhe institucionet financiare,
- 🍌 në karrierën universitare,
- 🍌 në aftësitë sipërmarrëse,
- 🍌 në administrimin e mirë të të ardhurave,
- 🍌 në planifikimin e suksesshëm të financave tuaja,
- 🍌 në pëmbushjen e objektivave tuaj afatgjatë.

Mëso ta përdorësh parinë!
Është e ardhmja jote.

Miraturar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, korrik 2011.

Titulli:	“Financat personale në duart tuaja”
Autor:	Banka e Shqipërisë
Bashkëpunëtor:	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
Kopertina:	Banka e Shqipërisë & “BRAND.al”
Design	Banka e Shqipërisë & “BRAND.al”
Fotot:	Arkiva e Bankës së Shqipërisë; www.sxc.hu

ISBN: 978-99956-42-48-8

Botimi i parë, 2011

E drejta e autorit i përket © Bankës së Shqipërisë. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Banka e Shqipërisë falënderon Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Institutin e Zhvillimit të Arsimit, për bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë për formimin e kulturës financiare në Shqipëri.

Komente dhe sugjerime janë të mirëpritura në adresën elektronike të Bankës së Shqipërisë public@bankofalbania.org

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KREU 1: NJOHURI TË PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE FINANCIARE

1.	Edukimi financiar fillon në shkollë	8
2.	Sistemet ekonomike	14
3.	Ekonomia dhe inflacioni	21
	3.1 Ekonomia	21
	3.2 Inflacioni	26
4.	Politikat makroekonomike	36
	4.1 Politika monetare dhe Banka e Shqipërisë	37
	4.2 Politika fiskale	42
5.	Sistemi financiar	46

KREU 2: FINANCAT PERSONALE

1.	Çështë para? Funkcionet e saj	58
2.	Vlera në kohë e parasë	65
3.	Efekti i inflacionit mbi vlerën e parasë	69
4.	Kursi i këmbimit dhe ndikimi i tij në jetën tonë	75
5.	Buxheti personal	81
6.	Hartimi i një plani kursimi	87
7.	Produktet dhe shërbimet bankare	91
8.	Investimi i kursimeve	98
9.	Kredia	111
10.	Të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit	120
11.	Planet individuale të pensionit	126
12.	Sigurimet – Një mënyrë për të kontrolluar rrezikun	133
13.	Taksat, tatimet dhe sigurimet	143
	13.1 Taksat dhe tatimet	144
	13.2 Sigurimet shëndetësore dhe shoqërore	150



LINJA 1:

NJOHURI TË PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE FINANCIARE



1. EDUKIMI FINANCIAR FILLON NË SHKOLLË

Paratë nuk rriten nëpër pemë! Sa herë e kemi dëgjuar këtë shprehje nga prindërit tanë ndoshta pa i kushtuar shumë vëmendje. Gjithmonë kemi menduar se prindërit kanë një pemë të artë ku mjafton të zgjasësh dorën dhe të marrësh paratë e nevojshme, për të blerë atletet që kemi parë në vitrinën e një dyqani apo celularin e fundit në treg. Por, duke u rritur, kemi filluar të kuptojmë se paratë fitohen me vështirësi dhe për këtë arsye duhen administruar me kujdes.



Paratë nuk rriten nëpër pemë, ku mjafton të zgjasësh dorën ...

Çfarë është edukimi financiar dhe përse është i rëndësishëm ai?

Ekonomistët e përshkruajnë *edukimin financiar* si procesin me të cilin konsumatorët shtojnë njohuritë e tyre për produktet financiare dhe rreziqet që i shoqërojnë ato, në mënyrë që të aftësohen për të bërë zgjedhje të zgjuara, bazuar në informacion të saktë. Nga ana tjetër, ata mësojnë se ku mund të drejtohen për ndihmë dhe për të ndërmarrë veprime të tjera konkrete për të përmirësuar mirëqenien financiare. Në këtë këndvështrim, me *informim* do të kuptojmë pajisjen e konsumatorëve me fakte, të dhëna dhe njohuri specifike për të qenë në dijeni të mundësive të ndryshme financiare. Mësimi i edukimit financiar në shkollë përfshin përvetësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për të kuptuar konceptet financiare nëpërmjet trajnimeve dhe orientimit të individëve. *Këshillimi* nënkupton dhënien e këshillave mbi çështje dhe produkte të përgjithshme financiare, në mënyrë që konsumatorët të jenë në gjendje ta përdorin sa më mirë informacionin dhe udhëzimet e marra.

Në mënyrë më të thjeshtë, edukatën financiare mund ta përkufizojmë edhe si aftësinë për të kuptuar paranë dhe për ta administruar atë në mënyrë të tillë që të marrim vendime financiare, që do të na sjellin përfitime në të tashmen dhe në të ardhmen. Një person i edukuar financiarisht zotëron aftësinë për të marrë vendime lidhur me:

- **kursimin** – për të përmbushur objektivat afatshkurtër dhe afatgjatë;
- **kredinë** – përdorimin e përgjegjshëm të saj;
- **administrimin e rreziqeve financiare.**

Edukimi financiar i shërben jo vetëm individit por edhe shoqërisë. Ai përmirëson aftësinë e publikut për të vlerësuar drejt ecurinë e zhvillimit ekonomik, politik dhe social të vendit e për pasojë, për të marrë vendime të matura ekonomike. Pra, edukimi financiar ndihmon dhe lehtëson funksionimin më të mirë të shoqërisë ku ne jetojmë.

Të paturit e një kulture financiare është si njohja e një gjuhe të huaj. Nëse ndodhemi në një ambient të rrethuar me persona që flasin një gjuhë të huaj, të cilën nuk e njohim dhe nuk e kuptojmë, do të ndihemi të përjashtuar nga biseda. Por, nëse kemi disa njohuri bazë të kësaj gjuhe, të paktën do të jemi në gjendje të kapim thelbin e diskutimit, të bëjmë disa pyetje dhe në këtë mënyrë të kuptojmë e të mësojmë më tepër.

Të gjithë ne duhet të kemi disa njohuri bazë për të kuptuar si funksionon ekonomia dhe financat e një vendi. Duhet të njohim sistemet e ndryshme ekonomike dhe karakteristikat e tyre; institucionet kryesore që hartojnë politikat ekonomike dhe ndikimin e tyre në ekonominë e vendit; çfarë produktesh dhe shërbimesh ofrojnë bankat apo institucionet e tjera financiare dhe si të sillemi me to; pse është e rëndësishme të kursejmë dhe cilat janë instrumentet



Të paturit e një kulture financiare është si njohja e një gjuhe të huaj.

kryesore të kursimit; çdo të thotë të investojmë dhe si të bëjmë investime të kujdesshme; dhe së fundmi, si të investojmë mbi vetveten dhe si të gjejmë një punë të mirë.

Shpesh, në disa shoqëri përfshirë dhe tonën, i kushtohet më shumë vëmendje fitimit të parave dhe akoma më tepër shpenzimit të tyre, duke lënë gabimisht mënjanë administrimin e parave, që ka të bëjë me përdorimin sa më të mirë të të ardhurave që kemi. Është e rëndësishme të kuptojmë se kultura financiare e nevojshme për të njohur mjedisin përreth dhe për të administruar të ardhurat personale është diçka që duhet mësuar, njësoj si drejtimi i makinës, gatimi apo përdorimi i kompjuterit. Administrimi i parave apo i financave personale është një aftësi e përvetësuar, që përfitohet me edukim dhe përvojë.

Fjala kyçe në administrimin e financave personale është përgjegjësia. Pavarësisht shumës që mund të kemi në dispozicion, 100 lekë, 1,000 lekë ose 100,000 lekë, jemi njësoj përgjegjës për mënyrën e përdorimit të saj. Secili prej nesh është përgjegjës për të ardhmen e tij financiare dhe kjo fillon në momentin e ndërgjegjësimit për vlerën e vërtetë të parave dhe përdorimin e tyre në mënyrë të mençur për të arritur objektivat e jetës.

Të njohim ekonominë dhe financën

Përpara se të shkojmë më tej, le të fillojmë të njihemi me disa koncepte bazë, që do të na ndihmojnë të kuptojmë drejt se ku qëndron dallimi mes dy shkencave që shpesh ngatërrohen me njëra-tjetrën: ekonomia dhe financa.

Ekonomia është shkencë sociale, që studion prodhimin, konsumin dhe shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve. Kjo shkencë përqipet të shpjegojë si funksionojnë ekonomitë



Fjala kyçe në administrimin e financave personale është përgjegjësia.

e ndryshme dhe si bashkëveprojnë ato me njëra-tjetrën. Njohuritë mbi ekonominë i shërbejnë edhe fushave të tjera, si financës, biznesit, qeverisjes, arsimit, drejtësisë dhe politikës.

Financa është shkencë që studion administrimin e fondeve; shpërndarjen dhe administrimin e burimeve financiare, kursimet dhe investimet. Parimi kryesor i financës është krijimi dhe administrimi i çdo mjeti, që në përgjithësi rritet në vlerë dhe të jep të ardhura. Fushat kryesore të financës janë: financat personale, financat e biznesit dhe financat publike.

- **Financat personale** – e thënë thjesht, financat personale kanë të bëjnë me administrimin e parave, të cilat mund të përdoren për shpenzimet e përditshme (si për shembull për pagimin e faturave), për kursim dhe për kryerjen e investimeve. Vendimet financiare personale lidhen me llogaritjen e parave të nevojshme në çdo fazë të jetës. Ato përfshijnë administrimin e shpenzimeve në varësi të të ardhurave; përzgjedhjen e bankës që na ofron kushtet më të favorshme; përdorimin e llogarive bankare; marrjen e një kredie për qëllime banimi/studimi/blerje makine/financimi pushimesh; investimin e kursimeve duke zgjedhur instrumentin më fitimprurës; pagimin e taksave dhe të sigurimeve.
- **Financat e biznesit** – konsistojnë kryesisht në gjetjen dhe administrimin e fondeve të nevojshme për financimin e aktivitetit të biznesit.
- **Financat publike** – mbulojnë financat e shtetit, bashkive, komunave dhe të subjekteve apo agjencive të lidhura me shtetin. Aktiviteti kryesor i tyre lidhet me identifikimin e shpenzimeve të nevojshme të këtyre institucioneve dhe gjetjen e burimeve financiare për të financuar këto shpenzime apo investime.



Financat personale kanë të bëjnë me administrimin e parave tuaja.

Në këtë lëndë, do të trajtojmë fillimisht disa çështje kryesore të ekonomisë, për t'u ndalur më gjatë tek financat personale të individit, njohuri të cilat janë mëse të nevojshme për të marrë vendime të drejta financiare në jetën tuaj si qytetarë.

PYETJE ?

1. Shpjegoni me fjalët tuaja konceptin e edukimit financiar.
2. Argumentoni se si arrihet administrimi i financave personale.
3. Si ndikon të paturit e një kulture financiare në aspektet e ndryshme të jetës tuaj të përditshme?
4. Dalloni konceptet e ekonomisë dhe financës dhe jepni shembuj nga jeta e përditshme.
5. Cilat janë tre llojet kryesore të financës?
6. Cilat janë fushat kryesore të financave personale?

FJALËR

Konsumator – është blerësi i fundit i produkteve dhe shërbimeve për nevojat e tij apo të personave që ka në ngarkim, dhe jo për t'i rishitur.

Produkte dhe shërbime financiare – janë të gjitha ato produkte dhe shërbime, që ofrohen nga institucionet financiare. Shembuj të këtyre produkteve dhe shërbimeve janë kreditë, depozitat, llogaritë rrjedhëse dhe të kursimit,

kartat bankare, shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave dhe këmbimi valutor.

Rrezik financiar – është mundësia e humbjes financiare, si rezultat i ndodhjes së një ngjarjeje të pritshme. Rreziqet kryesore financiare janë: a) rreziku i ndryshimit të tarifave tatimore (për shembull, rritja e taksave mund të ndikojë në uljen e fitimeve të një kompanie), b) rreziku i kursit të këmbimit (për shembull, ndryshimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj euros do të sillte favorizime ose dëmtime në ekonominë vendase, por edhe në të ardhurat e kompanive të import-eksportit), c) rreziku i normave të interesit (për shembull, rritja e normave të interesit të kredive do të sillte shpenzime shtesë për huamarrësit, duke rënduar situatën e tyre ekonomike).

Subjekt/ndërmjetës financiar – janë institucionet (të tilla si: banka, kompani sigurimi, fonde pensioni etj.) që marrin hua, fonde, nga individët ose bizneset dhe ua japin hua të tjerëve që kanë nevojë për to.

Investim – nënkupton përdorimin e parave në një moment të dhënë, me qëllim rritjen e vlerës ose përfitimin e të ardhurave shtesë prej tyre në të ardhmen. Disa forma investimi janë depozitat bankare, bonot e thesarit, letrat me vlerë, pasuritë e paluajtshme.

Administrim i parave/administrim i financave personale – tregon procesin e planifikimit, organizimit dhe marrjes nën përkujdesje të pasurisë dhe të të ardhurave personale me qëllim përmbushjen e objektivave financiare dhe sjelljen e përfitimeve në të ardhmen.

Mjet – çdo artikull me vlerë ekonomike që një person apo kompani mund të ketë në pronësi, sidomos artikujt të cilët mund të kthehen lehtësisht në para në dorë (*cash*).

2. SISTEMET EKONOMIKE

Mënyra se si çdo individ jeton në një shoqëri dhe vendimet e tij ekonomike varen, ndër të tjera, nga sistemi ekonomik i shoqërisë. Sistemi ekonomik është i përbërë nga individë dhe organizma, të cilët veprojnë për të përmbushur nevojat e shoqërisë nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve të ndryshme.

Tre janë pyetjet kryesore ekonomike, të cilave një shoqëri duhet t'u japë përgjigje:

1. **Çfarë** duhet të prodhohet me burimet që ajo ka, të cilat janë të kufizuara? (Ç'lloj produktesh dhe në çfarë sasi të prodhohen?)
2. **Si** duhet të prodhohen këto produkte dhe shërbime? (Kush do t'i prodhojë, duke kombinuar cilat burime dhe çfarë teknologjie do të përdorë?)
3. **Për kë** duhet të prodhohen këto produkte dhe shërbime? (Kush do t'i konsumojë dhe si do të shpërndahen midis grupeve të ndryshme të shoqërisë?)


Përgjigjet, që shoqëri të ndryshme u japin këtyre pyetjeve, përcaktojnë edhe sistemin ekonomik të ndjekur prej tyre.

Tre janë sistemet kryesore ekonomike:

- Ekonomia e komanduar (ekonomi e planifikuar),
- Ekonomia e tregut të lirë,
- Ekonomia e përzier ose mikse.



Qeveria është aktori kryesor në ekonominë e komanduar.



Ekonomia e komanduar (ekonomi e planifikuar)

Në një ekonomi të komanduar, tre pyetjet e mësipërme e marrin përgjigjen nga organet qendrore qeverisëse të vendit. Këto organe zotërojnë dhe kontrollojnë të gjithë faktorët e prodhimit (ose burimet – tokën, kapitalin dhe punën), mënyrën e përdorimit të tyre dhe shpërndarjen te konsumatorët e fundit. Në këtë sistem ekonomik, pronësia private është shumë e kufizuar.

Sasia e prodhimit përcaktohet në përputhje me planet e qeverisë, jo me kërkesat apo preferencat e konsumatorëve. Gjithashtu, qeveria përcakton se si do të realizohet prodhimi; se si do të shpërndahen të mirat dhe shërbimet dhe sa do të jenë pagat e prodhuesve. Meqenëse vendimet nuk merren në përputhje me nevojat e konsumatorëve për produkte, atëherë mund të ndodhë që sasia e produkteve të prodhuara të jetë më e madhe sesa kërkesa, duke çuar kështu në rritjen e stoqeve në depo dhe magazina. Për të njëjtën arsye, mund të ketë mungesa të produkteve në treg, pavarësisht se njerëzit kanë kërkesa dhe nevoja për to.

Në shekullin e 20-të, shumica e ekonomive të komanduara ekzistonin në shtete të vetëquajtura socialiste, por që në fakt ishin diktatura komuniste. Për këtë arsye, koncepti i ekonomisë së planifikuar shpesh lidhet me komunizmin. Ekonomitë e planifikuara dështuan dhe në ditët e sotme ka shumë pak ekonomi të tilla të mirëfillta. Edhe vende të cilat vazhdojnë të jenë nën sisteme komuniste, si Kuba apo Kina, kanë ndërmarrë reforma ekonomike për të kaluar gradualisht në sisteme ekonomike mikse.

Ekonomia e tregut të lirë

Ekonomia e tregut të lirë është një ekonomi në të cilën tre pyetjet, me të cilat e filluam mësimin, marrin përgjigje nga tregu, pra, nga ndërveprimi i kërkesës me ofertën. Ky sistem është e kundërta e sistemit të ekonomisë së komanduar. Në të, qeveria luan një rol asnjëanës, duke mos ndërhyrë fare në ekonomi.

Në praktikë, sistemet ekonomike të tregut plotësisht të lirë janë shumë të rralla. Jo të gjitha tregjet në një ekonomi mund të lihen pa ndërhyrjen apo rregullimin e shtetit. Prandaj, në përgjithësi, kur në jetën e përditshme përdorim termin “ekonomi e tregut të lirë” nënkuptojmë ekonomi me ndërhyrje të justifikuar të shtetit.

Ekonomia e përzier apo mikse

Praktikisht, nuk ekziston asnjë ekonomi tregu e pastër dhe asnjë ekonomi e komanduar apo e planifikuar e pastër. Pothuajse të gjitha ekonomitë në botë janë të përziere, të cilat kombinojnë në shkallë të ndryshme tipare të ekonomisë së tregut me ato të ekonomisë së komanduar. Pra, në ekonominë mikse, shteti luan rol rregullues.



Qeveria luan një rol asnjëanës në ekonominë e tregut të lirë.

mjaftueshme të ardhurash për të jetuar. Në një rast të tillë, ndërhyrja e shtetit, duke iu marrë më të pasurve (nëpërmjet taksave) për t'iu dhënë të varfërve (nëpërmjet pagesave të papunësisë, pagesave sociale, ofrimit të shërbimeve falas etj.) është e justifikueshme nga ana sociale.

HAPËSIRË INFORMUESE:

Një vështrim i shkurtër mbi historinë e zhvillimit të ekonomisë shqiptare pas viteve '90

Në fillim të viteve '90, Shqipëria kaloi nga një sistem me ekonomi të komanduar në një sistem që mbështeste parimet e ekonomisë së tregut të lirë. Kështu, Shqipëria u kthye në një vend me ekonomi të hapur, duke marrë pjesë plotësisht në tregtinë dhe investimet botërore.

Gjatë kësaj periudhe u ndërmorën këto reforma:

- *Zvogëlimi i ndjeshëm i rolit të shtetit në ekonomi;*
- *Vendosja e pronës private si gur themeli për funksionimin e modelit të ri ekonomik;*
- *Liberalizimi i çmimeve;*
- *Nxitja e sipërmarrjeve private në bujqësi, industri e shërbime;*
- *Ndërtimi i një sistemi financiar eficient dhe të shëndetshëm, të aftë për t'iu përgjigjur nevojave të ekonomisë së tregut.*

Këto reforma krijuan mundësi të reja për vendin. Shqipëria u kthye shpejt në një vend tërheqës për donatorët dhe investitorët e huaj, duke qenë e pasur me burime natyrore dhe gjeografikisht pranë tregjeve evropiane. Gradualisht, ekonomia jonë, nga një ekonomi e dominuar nga industria dhe bujqësia, filloi të orientohet më shumë drejt shërbimeve dhe ndërtimit.

Ky zhvillim i vrullshëm i viteve të para të tranzicionit u ndërpre nga kriza e skemave piramidale, në vitin 1997, e cila u shndërrua në një krizë ekonomiko-politike. Pavarësisht kësaj, ekonomia e vendit u ringrit shpejt, duke iu kthyer normalitetit.

Që prej vitit 1998, ekonomia shqiptare është rritur mesatarisht me 6% në vit. Shqipëria ka kaluar nga një vend me të ardhura të ulëta për frymë (rreth 290 dollarë në vitin 1992), në një vend me të ardhura të mesme (3,950 dollarë në vitin 2010). Ky kapërcim në standardin e jetesës, shënon rritjen më të shpejtë se në çdo shtet tjetër të Evropës Qendrore dhe Juglindore. Megjithatë, niveli i të ardhurave të Shqipërisë mbetet i ulët: në vitin 2009, të ardhurat e saj për frymë ishin vetëm sa 27% e mesatares së Bashkimit Evropian.

PYETJE?

1. Cilat janë sistemet kryesore ekonomike? Përshkruani tiparet e secilit sistem ekonomik.
2. Bëni dallimet midis sistemeve kryesore ekonomike.
3. Arsyejtoni se cili nga tre sistemet ekonomike të shpjeguar më sipër përshkruan më mirë ekonominë shqiptare para dhe atë pas '90-ës?
4. Cili është sistemi ekonomik më i mirë që një vend duhet të adoptojë?
5. Kur është e justifikueshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi? Jepni shembuj të ndërhyrjes së shtetit në ekonominë tonë.

FJALOR

Të mirat ose mallrat – janë produktet që plotësojnë një nevojë njerëzore (duke u konsumuar ose u investuar), të cilat mund të shiten dhe të blihen.

Shërbime – janë veprimtari ekonomike që nuk materializohen në sende të prekshme por që plotësojnë nevoja personale të individëve e të bizneseve. Disa shembuj shërbimesh janë ato që plotësojnë nevojat për arsim, shëndetësi, argëtim, administrim shtetëror, financiar, bankar ose për mirëmbajtje (pastrim e zbukurim rrugësh, ambientesh etj.).

Kapitali – përbën tërësinë e fondeve financiare të investuara në një biznes, me qëllim nxjerrjen e fitimeve në të ardhmen.

Kërkesë – përfaqëson sasinë e një malli apo shërbimi që konsumatorët dhe investitorët dëshirojnë të blejnë në një kohë të caktuar në treg, me një nivel të dhënë çmimesh.

Ofertë – nënkupton sasinë e mallrave dhe të shërbimeve të prodhuara dhe ofruara në një ekonomi në një kohë të caktuar, për plotësimin e kërkesave të shoqërisë.

3. EKONOMIA DHE INFLACIONI


3.1 EKONOMIA

Prindërit tuaj fitojnë para nëpërmjet punës. Një pjesë të këtyre parave ata e shpenzojnë për të blerë mallrat dhe shërbimet e nevojshme në jetën e përditshme: ushqime, ujë, energji elektrike, transport me autobus etj. Një pjesë tjetër e këtyre të ardhurave përdoret për blerje më të mëdha, por më të rralla, si një lavatriçe e re apo një televizor i ri. Ndërkohë, pjesën e mbetur të parave që fitojnë, ata e kursejnë. Prindërit tanë dhe ne si konsumatorë jemi vetëm një pjesë e ekonomisë. Nga kjo pikëpamje, **ekonomia mund të përkufizohet edhe si tërësia e aktiviteteve që përfshin gjithçka ne bëjmë në punë, dyqane, zyra, ndërmarrje, banka, madje edhe në shtëpi apo në shkollë.** Ekonomia përbëhet nga konsumatorët, bizneset dhe qeveria.

Prindërit tanë dhe ne jemi konsumatorë. **Konsumatorët** blejnë mallra e shërbime për konsumin e tyre të përditshëm (ushqime, veshje, energji elektrike etj.) dhe për konsumin afatgjatë (mobilie, lavatriçe, frigorifer, fonde pensioni etj.).


Bizneset prodhojnë pjesën më të madhe të mallrave dhe shërbimeve që ne konsumojmë. Për këtë, ato blejnë lëndë të para dhe produkte të tjera, si dhe kryejnë investime, në mënyrë që të prodhojnë produktet që shiten në treg. Produktet e tyre nuk blihen vetëm nga konsumatorët (ushqimet, veshjet, pajisjet elektroshtëpiake), por edhe nga biznese të tjera (si lëkurë, çelik, grurë, makineri etj.) dhe nga qeveria.

Qeveria është njëkohësisht konsumatore por edhe prodhuese në ekonomi. Ajo blen mallra e shërbime (pajisje mjekësore dhe ilaçe për spitalet; armë, ushqime dhe veshje për ushtrinë



Ekonomia mund të përkufizohet si tërësia e aktiviteteve që përfshin gjithçka ne bëjmë.

dhe forcat e rendit), kryen investime (ndërtimi i rrugëve, urave, shkollave, parqeve), por edhe ofron produkte për ne, të cilat janë kryesisht shërbime, si: shërbimi spitalor publik, sistemi arsimor, transporti publik, mbrojtja e qytetarëve, pastrimi i qytetit etj.



Tërësia e mallrave dhe shërbimeve që konsumatorët, bizneset dhe qeveria dëshirojnë të blejnë për qëllime konsumi apo për qëllime investimi, përbën **kërkesën e brendshme** në ekonomi për mallra dhe shërbime.

A e dini se?

Konsumi i familjarëve është përbërësi kryesor i kërkesës së brendshme në ekonominë tonë. Në 10-vjeçarin e fundit, ai

përbën rreth 61% të saj. Një pjesë tjetër të konsiderueshme zënë edhe investimet, prej mesatarisht rreth 31%. Pjesën tjetër, prej mesatarisht 8% e zë konsumi i qeverisë.

Ekonomia jonë është një ekonomi e hapur: ne tregtojmë lirisht mallra me vendet e tjera. Kur blejmë produkte nga vendet e tjera, ne themi se importojmë. Tërësia e produkteve që janë prodhuar jashtë vendit tonë, të cilat ne i blejmë dhe i konsumojmë brenda vendit përbëjnë **importet** tona. Kur shesim produktet tona në vende të tjera, themi se eksportojmë. Tërësia e produkteve që ne prodhojmë në vend dhe i shesim jashtë, përbën **eksportet** tona jashtë vendit.

Shqipëria është një vend kryesisht importues, që do të thotë se importon më shumë se sa eksporton. E shprehur ndryshe, diferenca mes eksporteve dhe importeve është negative. Kjo diferencë njihet me termin **deficit tregtar**.

A e dini se?

Importet tona janë rreth 4 herë më të larta se sa eksportet.

Vendet kryesore partnere me të cilat shkëmbejmë mallra janë: Italia, Greqia, Gjermania, Turqia dhe vendet e rajonit (Kosova, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi). Në 5 vitet e fundit (2005 - 2010), mesatarisht rreth 27% e importeve tona kanë ardhur nga Italia, 15% nga Greqia, 7% nga Turqia, 2% nga vendet e rajonit dhe rreth 28% nga vendet e tjera evropiane. Po në këtë periudhë, 68% e eksporteve tona kanë shkuar në Itali, 9% në Greqi, 10% në vendet e rajonit dhe 5% në Gjermani.

Pjesën më të madhe të importeve tona në 5 vitet e fundit e zënë zërat: makineri dhe pajisje (22%); ushqime, pije dhe duhan

(17%); materiale ndërtimi (16%); minerale, lëndë djegëse, energji (15%); tekstile dhe këpucë (11%). Për këtë periudhë, eksportet tona janë kryesisht: tekstile dhe këpucë (50%); materiale ndërtimi dhe metale (16%); minerale, lëndë djegëse, energji (13%); ushqime, pije, duhan (7%).

Tërësia e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga sektorë të ndryshëm ekonomikë përbën **ofertën** në ekonomi për mallra dhe shërbime, e quajtur ndryshe edhe **prodhimi i brendshëm bruto** (PBB).

Sektorët e ekonomisë

Ekonomia e një vendi ndahet në 3 sektorë kryesorë, në varësi të distancës së aktivitetit ekonomik nga mjedisi natyror. Sektori parësor është sektori i bujqësisë, i ndjekur nga sektori dytësor – sektori i industrisë, dhe së fundi, sektori tretësor – sektori i shërbimeve.

Bujqësia përfshin veprimtaritë ekonomike, që kanë për qëllim të përftojnë nga natyra produkte të dobishme dhe të domosdoshme. Këto veprimtari përfshijnë: punimin e tokës dhe kultivimin e bimëve, shfrytëzimin e pyjeve, mbarështimin e kafshëve dhe të peshqve, si dhe gjuetinë.

Industria përfshin veprimtaritë, që kanë të bëjnë me nxjerrjen e lëndëve të para nga nëntoka, përpunimin dhe prodhimin e produkteve të ndryshme. Ajo përfshin nënsektorë të ndryshëm, si: industrinë nxjerrëse, industrinë përpunuese, prodhimin e shpërndarjen e energjisë elektrike, gazit dhe ujit, ndërtimin etj.

Shërbimet përfshijnë veprimtaritë ekonomike, të cilat nuk prodhojnë të mira të prekshme, por plotësojnë nevoja



Në Shqipëri, sektori i bujqësisë përbën rreth 18% të PBB-së.

personale të njerëzve e të njësive të tjera ekonomike, të tilla si: tregtia, administrimi publik, transporti, telekomunikacioni, turizmi, shërbimet financiare, përpunimi i të dhënave, arsimimi, shëndeti dhe veprimtaritë sociale, argëtimi, ushtrimi i profesioneve të lira etj.

A e dini se?

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, prodhimi i brendshëm bruto është mbizotëruar nga sektori i shërbimeve dhe ai i ndërtimit, të cilët përbëjnë më shumë se 60% të tij. Peshën më të madhe të shërbimeve e zënë “Tregtia, hotelet dhe restorantet”, zhvillimi i të cilave ka kontribuar në rreth një-të-katërtën e prodhimit vendas gjatë 15 viteve të fundit. Zgjerimi i këtyre sektorëve është nxitur nga kërkesa e lartë në ekonomi, e mbështetur nga rritja e produktivitetit dhe paratë e dërguara nga emigrantët (remitancat). Nga ana tjetër, sektori i industrisë ka ruajtur pjesën e tij në PBB me rreth 9%, fillimisht si rezultat i rritjes së prodhimit të tekstileve dhe këpucëve me destinacion kryesor eksportin dhe më së fundi, për shkak të zgjerimit të materialeve të ndërtimit (prodhimi i çimentos). Pavarësisht uljes së rëndësisë së bujqësisë në ekonomi, pësia e këtij sektori mbetet ende e lartë në krahasim me vendet e rajonit. Bujqësia përbën 18% të PBB-së dhe mbulon mbi 40% të punësimit në Shqipëri. Kjo sugjeron se ka ende mundësi për rritjen e produktivitetit të përgjithshëm dhe të prodhimit, përmes stimujve në bujqësi dhe lehtësimit të lëvizjes së vazhdueshme të fuqisë punëtore, ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

3.2 INFLACIONI

Gjyshja juaj, ju bleu një palë atlete me rastin e fillimit të shkollës, të cilat kushtuan 3,000 lekë. Rrugës për në shtëpi, ajo thotë: “Çmimet vetëm rriten. Më kujtohet kur vëllai yt ishte në moshën tënde, para 10 vjetësh. Atëherë një palë atlete kushtonin 1,500 lekë.” Shumica e gjërave që gjyshja blen kushtojnë më shtrenjtë tani sesa para 10 apo 20 vjetësh, duke filluar nga buka e deri tek veshjet.

Në ekonominë tonë, disa çmime rriten dhe disa të tjera bien në një kohë të caktuar, në varësi të faktorëve që ndikojnë çmimet e mallrave apo shërbimeve të veçanta. Por, ka periudha të caktuara kur çmimet e shumicës së mallrave rriten. Në të tilla raste, kemi inflacion. **Inflacioni është rritja e përgjithshme dhe e vazhduar e nivelit të çmimeve në ekonomi.**

Masa me të cilën çmimet rriten, matet çdo muaj. Kjo quhet normë e inflacionit. Norma e inflacionit merr parasysh ndryshimet e çmimeve të qindra produkteve të blera nga shumica e njerëzve: buka dhe ushqimet e tjera, veshjet, nafta, energjia elektrike, pushimet.

Në Shqipëri, matja zyrtare e inflacionit realizohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT¹) dhe publikohet çdo muaj. Në varësi të metodës së llogaritjes, kemi dy lloje inflacioni: inflacion mujor dhe inflacion vjetor. **Inflacioni mujor** mat masën e ndryshimit të çmimeve në krahasim me një muaj më parë. **Inflacioni vjetor** mat masën e ndryshimit të çmimeve në krahasim me të njëjtin muaj të një viti më parë.

Inflacioni është rritja e përgjithshme dhe e vazhduar e nivelit të çmimeve në ekonomi.

¹ Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Institutit të Statistikave në adresën www.instat.gov.al

Shembull: Inflacioni mujor në muajin dhjetor 2010 ishte 2.2%. Inflacioni vjetor i muajit dhjetor 2010 ishte 3.4%. Një inflacion mujor prej 2.2% do të thotë se, në muajin dhjetor 2010 çmimet janë mesatarisht 2.2% më të larta se në muajin nëntor 2010. Një inflacion vjetor prej 3.4% do të thotë se, në muajin dhjetor 2010 çmimet janë 3.4% më të larta se në muajin dhjetor të vitit 2009.

Në përgjithësi, një nivel i ulët i inflacionit është i nevojshëm për zhvillimin e ekonomisë. Në vendin tonë, Banka e Shqipërisë, banka jonë qendrore, është përgjegjëse për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ky objektivi është përkthyer në terma sasiorë, në ruajtjen e inflacionit vjetor në afat të mesëm, në nivelin 3% me një interval tolerance +/-1 pikë përqindje.

A e dini se?

Gjatë viteve të para të tranzicionit, në vitet 1995 – 1999, në vendin tonë, inflacioni vjetor shfaqti luhatje të mëdha. Ai mori vlerën më të lartë prej 42.1% në vitin 1997, si pasojë e krizës së rëndë ekonomike që erdhi nga shkatërrimi i skemave piramidale. Si rezultat i politikave të përshtatshme makroekonomike, inflacioni vjetor gjatë 10 viteve të fundit është luhatur mesatarisht rreth vlerës 2.8%, duke qëndruar shumë pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve.

Nga se shkaktohet inflacioni?

Një ditë duke u kthyer nga shkolla ju dëgjoni administratorin e supermarketit në lagjen tuaj duke biseduar me një të njohurin e tij. Ai ishte i kënaqur, pasi biznesi po ecte shumë mirë dhe njerëzit po blinin gjithnjë e më shumë në

supermarketin e tij. Ai mendonte të punësonte një punonjës tjetër për të përballuar punën e shtuar.


Kohë të tilla, kur konsumatorët shpenzojnë shumë, duken të mira për të gjithë. Bizneset ecin mirë dhe punësojnë më shumë njerëz. Njerëzit ndihen më të sigurt për punën e tyre dhe kërkesa për mallra dhe shërbime vazhdon të rritet. Rritja e të ardhurave i bën njerëzit më optimistë dhe më të sigurt për të ardhmen. Kështu, ata ndihen më të qetë në shpenzimin e parave. Madje, ata mund të marrin edhe kredi për të financuar blerjen e një makine të re apo rimobilimin e shtëpisë.

Por, rritja e shpejtë e konsumit brenda një periudhe të shkurtër kohe, mund të shkaktojë rritje të padëshiruar të çmimeve, pra, një inflacion më të lartë sesa ai që dëshirojmë. Si ndodh kjo?

Të gjendur përballë një kërkesë të shtuar të konsumatorëve, bizneset (prodhuesit e mallrave dhe shërbimeve) mund të hasin vështirësi në rritjen e prodhimit për të kënaqur kërkesën në mënyrë të menjëhershme. Që ta bëjnë këtë, bizneset përballen me kosto më të larta. Ata kanë nevojë të blejnë makineri dhe hapësira të reja prodhimi. Gjithashtu, punonjësit e tyre duhet të punojnë jashtë orarit dhe për këtë duhet të paguhen më shumë. Lëndët e para mund të kushtojnë më shtrenjtë, pasi kërkesa për to mund të rritet. Bizneset, pasi përballen me kosto më të larta prodhimi, rrisin çmimet e produkteve të tyre. Kështu, çmimet rriten për pjesën më të madhe të mallrave. Në këto kushte, njerëzit kërkojnë paga më të larta për të përballuar rritjen e çmimeve. Nëse bizneset pranojnë të rrisin pagat e punonjësve, kostot e produkteve që ata prodhojnë rriten përsëri (si rrjedhojë e rritjes së pagave). Si pasojë, bizneset mund të rrisin sërish çmimet. Dhe kështu ekonomia futet në një cikël të mbyllur të rritjes së koston dhe të çmimeve.



Rritja e shpejtë e konsumit brenda një periudhe të shkurtër kohe, mund të shkaktojë rritje të padëshiruar të çmimeve.



Pra, rritja e kërkesës më tepër sesa prodhuesit kanë aftësi të prodhojnë (oferta) shkakton rritjen e shpejtë dhe të përgjithshme të çmimeve. Prodhuesit mund të rrisin kapacitetet e prodhimit nëpërmjet investimeve të reja dhe rritjes së numrit të punonjësve, dhe të prodhojnë një sasi më të madhe mallrash. Por, kjo kërkon kohë e nuk mund të realizohet në një afat të shkurtër. Prandaj, është më mirë kur rritja e kërkesës është e qëndrueshme, në mënyrë që bizneset të mund ta përballojnë atë, pa shkaktuar presione për rritjen e kostove dhe çmimeve.

HAPËSIRË INFORMUESE:

Inflacioni, deflacioni dhe stabiliteti i çmimeve

Të gjithë kemi dëgjuar nga gjyshërit apo nga personat më të moshuar se ne, sa ndryshe ishin gjërat kur ata ishin në moshën tonë. Një bukë kushtonte 5 lekë. Bileta e kinemasë ishte 12 lekë. Me kalimin e kohës çmimet janë rritur dhe Leku e ka humbur vlerën e tij. Tani, për të blerë një bukë duhen 80 lekë dhe për të parë një film në kinema nevojiten 500 lekë. Ky është inflacioni.

*Në këtë mësim u njohëm me kuptimin e inflacionit. Në parim, **inflacioni** përkufizohet si një rritje e përgjithshme e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve për një periudhë të zgjatur kohe, duke sjellë si rrjedhojë një rënie të vlerës së parasë dhe të fuqisë së saj blerëse.*

Në një ekonomi tregu, çmimet e mallrave të veçanta ulen dhe ngrihen vazhdimisht, duke pasqyruar zgjedhjet dhe pëlqimet e konsumatorëve, si dhe ndryshimet e kostove.

*E kundërta e inflacionit është **deflacioni**, i cili shprehet në rënien e nivelit të përgjithshëm të çmimeve për një periudhë të zgjatur kohe. Deflacioni ndodh si pasojë e uljes së kërkesës për mallra dhe shërbime, çka i detyron kompanitë t'i shesin produktet e tyre me çmime më të lira.*

*Luhatjet e forta të çmimeve shkaktojnë pasiguri dhe e dëmtojnë ekonominë. Në këtë mënyrë, **stabiliteti i çmimeve** është një parakusht i rëndësishëm për një ekonomi të shëndetshme.*

Ekonomia botërore njeh raste të shumta kur njerëzit janë ndodhur në situata të vërteta pasigurie dhe dëshpërimi, për shkak të luhatjeve apo ndryshimeve të mëdha të çmimeve. Madje ka ndodhur edhe që vlera e një banese, për një kohë të shkurtër të barazohet me një pagë mesatare mujore. Më poshtë mund të gjeni disa shembuj historikë të inflacionit në vende të ndryshme të botës.*

Franca, në vitet 1790

- *Gjatë revolucionit, Qeveria Franceze shiti sasi të konsiderueshme obligacionesh qeveritare për të paguar borxhet.*
- *Por huamarrja e lartë dhe mungesa e ushqimeve, shkakuan rritje të çmimeve.*
- *Në vitin 1796, inflacioni arriti në 1,153%.*

Mbretëria e Bashkuar, në vitet 1921-1933

- *Përfundimi i financimit të luftës dhe rikthimi tek standardi i floririt në vitin 1925, shkaktoi presione rënëse tek çmimet.*
- *Çmimet ranë pothuajse çdo vit gjatë periudhës 1921-33.*
- *Në vitin 1933, çmimet kishin rënë 38%.*

Gjermania, në vitin 1923

- *Në dhjetor 1923, çmimet e shumicës ishin 85,000,000,000% më të larta se një vit më parë.*
- *Kartëmonedha me vlerë nominale më të lartë, mbante vlerën e 1,000,000,000,000 markave.*

- Në tetor, më shumë se 99% e kartëmonedhave qëndruan në qarkullim për më pak se 30 ditë.

Rusia, në vitin 1923

- Në vitet që pasuan Revolucionin Rus, Rusia përjetoj trazira shoqërore dhe ekonomike.
- Disa historianë ekonomikë, besojnë se qeveria krijoi inflacionin për të varfëruar ata që ishin në një gjendje më të mirë.
- Në vitin 1923, inflacioni kapi shifrën 60,804,000%.

Greqia, në vitin 1944

- Në tetor 1944, 99% e shpenzimeve qeveritare mbuloheshin duke emetuar para të re dhe jo nga mbledhja e taksave.
- Inflacioni arriti kulmin në tetor me 130,000%.
- Besimi në vlerën e monedhës u rrënuar.
- Në nëntor 1944, grekët e mbanin një kartëmonedhë dhabrahme mesatarisht për vetëm 4 orë.

Hungaria, në vitin 1946

- Hungaria ka përjetuar normën më të lartë të inflacionit të regjistruar ndonjëherë brenda një dite.
- Në muajin e pikut, korrik 1946, çmimet dyfishoheshin në pak më shumë se 12 orë.
- Kartëmonedha me vlerën më të lartë në qarkullim ishte 100,000,000,000,000,000,000 pengo.

Kina, në vitet 1945-1949

- Lufta civile filloi në vitin 1945.
- Shpenzimet ushtarake ishin të larta, duke kapur 80% të buxhetit të shtetit.
- Çmimet, të matura në monedhën kombëtare kineze, u rritën me 2,372% deri në mars 1948.

Argjentina, në vitet '80

- Gjatë viteve '80, inflacioni ishte mesatarisht 750% në vit, për të arritur kulmin në dhjetor 1989 me 4,924%.
- Shkaku kryesor i inflacionit ishte deficiti buxhetor i vazhdueshëm i qeverisë.

- Deficiti financohej nga banka qendrore, duke çuar në inflacion.

Republika Federale e Jugosllavisë, në vitet 1993-94

- Në janar 1994, norma e inflacionit arriti shifrën 331,000,000%.
- Kartëmonedha me vlerën më të lartë, në qarkullim në atë periudhë, ishte ajo prej 500,000,000,000 dinarësh.
- Shkaqet e inflacionit ishin ndarja e ish-Jugosllavisë në vitin 1992 dhe humbja e kontrollit monetar e fiskal.

Zimbabve, në vitet 2006-2008

- Inflacioni arriti në 66,212% në dhjetor 2007, vlera më e lartë në botë e regjistruar deri në atë moment.
- Kartëmonedha me vlerën më të lartë, në qarkullim në atë periudhë, ishte ajo prej 10,000,000 dollarësh zimbabvianë.
- Dyqanet shtypnin përditë tabela me çmimet e reja.

* Burimi: Banka e Anglisë (<http://www.bankofengland.co.uk/education/inflation/map/map.htm>)

PYETJE ?

1. Përkruani përmbajtjen dhe kuptimin e termave të mëposhtëm. Tregoni lidhjen që ekziston mes tyre.

- Ekonomi
- Konsumator
- Biznes
- Kërkesë e brendshme
- Import
- Eksport
- Prodhim i brendshëm bruto
- Inflacion

2. Cilët janë sektorët kryesorë ekonomikë?

3. Gruponi aktivitetet e mëposhtme ekonomike në sektorët kryesorë ekonomikë:

- prodhimi i automobilave
- gjuetia
- bankat
- ndërtimi
- përpunimi i metaleve
- restorantet
- prodhimi i tekstileve
- shëndetësia
- farmaceutika
- blegtoria
- noteria
- prodhimi i anijeve
- media
- energjetika
- peshkimi
- turizmi

4. Nga se shkaktohet inflacioni?

5. Si ndikon inflacioni në spiralen pagë-çmim, çmim-pagë?

6. Si matet inflacioni në Shqipëri?

7. Cili është objektivi i Bankës së Shqipërisë për inflacionin?

8. Në tabelën e mëposhtme jepen normat mujore dhe vjetore të inflacionit gjatë 12 muajve të vitit 2010. Interpretojini ato. Arsyetoni si ka ecur inflacioni në

Shqipëri gjatë kësaj periudhe. A është norma vjetore e inflacionit në këta muaj brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë për inflacionin?

	Mujor	Vjetor
Janar	0.9%	4.3%
Shkurt	1.1%	4.7%
Mars	0.1%	4.1%
Prill	-0.4%	3.7%
Maj	-1.2%	3.3%
Qershor	-0.7%	3.2%
Korrik	-0.5%	3.4%
Gusht	0.8%	3.5%
Shtator	0.7%	3.4%
Tetor	0.2%	3.0%
Nëntor	0.2%	2.8%
Dhjetor	2.2%	3.4%

Detyrë

Vizitoni faqen e internetit të INSTAT në adresën elektronike www.instat.gov.al. Gjeni publikimin më të fundit për inflacionin dhe diskutojeni atë me aq njohuri sa keni marrë për inflacionin.

FJALËR

Kosto - është tërësia e të gjitha shpenzimeve për prodhimin dhe shitjen e një produkti. Ajo përfshin shpenzimet për blerjen e lëndëve të para, pagat e punonjësve, taksat dhe sigurimet, si dhe çdo lloj tjetër shpenzimi që biznesi kryen për prodhimin e produkteve apo ofrimin e shërbimeve.

Çmimi – përfaqëson vlerën e mallrave dhe shërbimeve, ose sasinë e parave që një blerës i paguan shitësit për një njësi të blerë të mallit apo shërbimit. Për shembull, çmimi për një kg mollë, apo çmimi për një prerje flokësh, apo çmimi për një orë palestër.

Remitanca - janë dërgesa në para të emigrantëve, që jetojnë e punojnë jashtë vendit, për familjarët e tyre. Këto të ardhura përbëjnë një ndihmë ekonomike të vlefshme jo vetëm për familjet e tyre, por edhe për rritjen financiare dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

4. POLITIKAT MAKROEKONOMIKE

Politikat makroekonomike janë veprime që merren nga institucione të caktuara shtetërore të një vendi, për të ndikuar ekonominë e tij. Ato kanë si qëllim arritjen e objektivave kryesorë të mëposhtëm:

- rritjen e qëndrueshme ekonomike, e cila rrit standardin e jetesës së popullsisë;
- nivele të ulëta të papunësisë;
- stabilitetin e çmimeve.

Politikat makroekonomike janë dy: politika monetare dhe politika fiskale.

Politika fiskale hartohet dhe zbatohet nga qeveria, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe ka për qëllim, ndër të tjera, arritjen e dy objektivave të parë të mësipërm – rritjen ekonomike dhe punësimin.

Politika monetare hartohet dhe zbatohet nga banka qendrore, Banka e Shqipërisë në rastin e vendit tonë, dhe ka si objektiv kryesor sigurimin e stabilitetit të çmimeve. Nëpërmjet kombinimit të përshtatshëm dhe koordinimit të mirë të këtyre dy politikave, arrihet të kontrollohet ekonomia e vendit, në mënyrë që të sigurohet përmbushja e objektivave të mësipërm.




Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

4.1 POLITIKA MONETARE DHE BANKA E SHQIPËRISË

Politika monetare hartohet dhe zbatohet nga bankat qendrore, të cilat i ndeshim edhe me emrin *autoritete monetare*. Qëllimi i politikës monetare është të sigurojë qëndrueshmëri të çmimeve në vend.

Banka qendrore në vendin tonë është Banka e Shqipërisë. Si për çdo bankë qendrore të ditëve të sotme, objektivi kryesor i saj është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Të arrish stabilitetin e çmimeve do të thotë të arrish norma të ulëta pozitive të inflacionit, pra, të arrish norma të ulëta të ndryshimit të çmimeve të konsumit. Të ruash stabilitetin e çmimeve do të thotë të sigurosh norma të ulëta pozitive të inflacionit për periudha relativisht të gjata kohe.

Banka e Shqipërisë ka vendosur si objektiv mbajtjen e inflacionit në nivelin 3% +/- 1 pikë përqindje në një periudhë afatmesme. Grafiku më poshtë na ndihmon të kuptojmë se si është luhatur inflacioni në vendin tonë në periudhën 2002-2010, në raport me objektivin e Bankës së Shqipërisë.



HAPËSIRË INFORMUESE:

Të njohim Bankën e Shqipërisë

Kur është krijuar Banka e Shqipërisë?

Banka Kombëtare e Shqipërisë (sot Banka e Shqipërisë) u krijua në 4 tetor të vitit 1913, si rezultat i një marrëveshjeje të nënshkruar midis Qeverisë së Ismail Qemalit, përfaqësuesve të Wiener Bank Verein, si dhe përfaqësuesve të Banca Commerciale Italiana. Për shkak të zhvillimeve politike që ndodhën me shpërthimin e luftërave ballkanike dhe të Luftës së Parë Botërore, banka veprroi për një kohë shumë të shkurtër. Pasi kreu disa veprime me Qeverinë e Ismail Qemalit dhe disa subjekte private, ajo e pushoi aktivitetin.

Në 2 shtator 1925, në bazë të një marrëveshjeje të nënshkruar nga Qeveria Shqiptare me një grup financiar italian, u themelua Banka Kombëtare e Shqipërisë, me qendër administrative në Durrës dhe me Komitetin Administrativ në Romë. Në vitin 1926, ajo hodhi në qarkullim monedhën e parë kombëtare shqiptare.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe deri në fund të vitit 1990, Banka e Shtetit mbështeti procesin e zhvillimit të ekonomisë socialiste. Karakteristikë për këtë periudhë ka qenë centralizimi i skajshëm i këtij sistemi në duart e shtetit. Banka e Shtetit Shqiptar, si bankë qendrore, vazhdonte të ishte qendër e emisionit të monedhës. Ajo kryente shërbimin e thesarit dhe arkës së shtetit, ruante fondet në valutë të shtetit, kryente veprimet ekonomike e financiare të shtetit me vendet e tjera dhe me bankat e huaja. Gjithashtu, u jepte ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore dhe personave të veçantë kredi; shërbente si qendër për mbajtjen e llogarive rrjedhëse, për pranimin e depozitave të kursimit dhe ruajtjen e tyre në para, tituj, monedha ari e argjendi; dhe kryente veprime të këmbimit të valutave të huaja për llogari të vet ose të të tretëve.

Me fillimin e viteve '90, ndërrimi i sistemit politik në Shqipëri solli ndryshime thelbësore edhe për sistemin bankar. Tiparet kryesore të

këtij ndryshimi ishin: ndarja e funksioneve të bankës qendrore nga funksionet e bankave tregtare, rritja e numrit të bankave, shtrirja e veprimtarisë së tyre të kreditit në disa degë të ekonomisë shqiptare, si dhe hyrja e kapitalit të huaj në tregun bankar.

Cilat janë funksionet kryesore të Bankës së Shqipërisë?

Banka e Shqipërisë drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryesohet nga Guvernatori. Ajo përfaqëson institucionin e vetëm në Republikën e Shqipërisë përgjegjës për hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikës monetare. Kjo politikë hartohet në funksion të përmbushjes së objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë: arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

Është e rëndësishme të kuptojmë se Banka e Shqipërisë nuk kryen të njëjtat funksione dhe nuk ofron të njëjtat shërbime me bankat tregtare. E thënë më thjesht, ajo nuk u shërben drejtpërdrejt individëve dhe bizneseve: nuk u jep atyre kredi, në të nuk mund të hapen llogari personale dhe nuk lëshon karta debiti e as krediti. Pra, ajo i ngjan një banke pa sportele. “Klientët” e bankës qendrore janë bankat tregtare dhe qeveria.

Përveç hartimit të politikës monetare, ajo gëzon funksione dhe detyra të tjera, që lidhen kryesisht me garantimin e stabilitetit financiar në vend, licencimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së bankave tregtare, emetimin e monedhave dhe kartëmonedhave kombëtare dhe administrimin e rezervës valutore.

Më parë thamë që inflacioni shkaktohet nga rritja më e shpejtë e kërkesës së përgjithshme në ekonomi në krahasim me ofertën, pra, kur kërkojnë të blihen më shumë mallra sesa mund të prodhojnë bizneset në një moment të caktuar kohe. Gjithashtu pamë edhe se si kjo mund të përfundojë në një rreth të mbyllur, kur rritja e kostove çon në rritje të çmimeve, e kështu me radhë. Në një moment, ky rreth vicioz duhet të ndërpritet. Nëse lejohet që inflacioni të rritet shumë, ulja e tij


më vonë mund të rezultojë në një proces të dhimbshëm dhe të pakëndshëm për pjesëtarët e ekonomisë. Kjo do të kërkonte rënien drastike dhe të menjëhershme të kërkesës për mallra dhe shërbime në ekonomi, që do të çonte në rënie ekonomike dhe rritje të papunësisë. Për të shmangur këtë, Banka e Shqipërisë vepron në kohën e duhur në mënyrë që inflacioni të qëndrojë brenda objektivit.

Si e mban Banka e Shqipërisë inflacionin pranë objektivit?

Në mënyrë që të mbajë inflacionin pranë objektivit, Banka e Shqipërisë siguron që kërkesa e përgjithshme për mallra dhe shërbime në ekonomi të rritet në mënyrë të qëndrueshme, as shumë shpejt por as shumë ngadalë, në mënyrë që oferta ta përballojë atë. Si arrihet kjo?


Kjo arrihet nëpërmjet ndryshimit të normës bazë të interesit që ajo aplikon për bankat tregtare, duke ndikuar kështu normat e interesit që ato vendosin për depozitat dhe kreditë. Në këtë mënyrë, ndikohen vendimet për të kursyer apo konsumuar dhe investuar në ekonomi, pra, kërkesa e përgjithshme për mallra dhe shërbime.

Nëse Banka e Shqipërisë mendon se kërkesa po rritet shumë shpejt dhe kjo do të shkaktojë rritjen e inflacionit mbi vlerën 3% të objektivit për të, atëherë ajo rrit normën bazë të interesit. Kur normat e interesit rriten, njerëzit janë të prirur të kursejnë më shumë nga të ardhurat e tyre, pra të konsumojnë më pak. Rritja e normës së interesit do të thotë gjithashtu këste më të larta për kreditë e marra. Kështu, njerëzit shpenzojnë më pak, pra blejnë më pak mallra dhe shërbime. Kërkesa e përgjithshme ngadalësohet dhe inflacioni bie. Ky është një shembull i një **politike monetare shtrënguese**, të cilën banka




Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për mbajtjen nën kontroll të inflacionit.

qendrore e ndjek kur kërkesa rritet më shpejt se sa duhet dhe inflacioni pritet të rritet mbi objektiv.



Banka e Shqipërisë zbaton një **politikë monetare lehtësuese** kur mendon se kërkesa në ekonomi është duke u rritur shumë ngadalë dhe inflacioni pritet të bjerë nën objektivin e Bankës. Në këtë rast, Banka e Shqipërisë ul normën bazë të interesit. Këstet e kredive të marra bëhen më të ulëta dhe kreditë e reja bëhen më të lira. Ndërkohë, normat më të ulëta të interesit i bëjnë kursimet më pak tërheqëse dhe kështu njerëzit kursejnë më pak e shpenzojnë më shumë. Kërkesa e përgjithshme rritet dhe inflacioni gjithashtu rritet, duke iu afruar objektivit.



Kështu, kur të dëgjoni Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë të thotë gjatë konferencës për shtyp se Këshilli Mbikëqyrës i saj ka vendosur të rrisë apo të ulë normën e interesit, ju e dini pse ai e ka bërë këtë: për të mbajtur inflacionin pranë objektivit prej 3% +/-1 pikë përqindje. Gjithashtu, ju dini tashmë pse kjo është e rëndësishme për të gjithë ne.

4.2 POLITIKA FISKALE

Politika fiskale është kontrolli i shpenzimeve dhe të ardhurave qeveritare me qëllim ndikimin e ekonomisë. Politika fiskale hartohet dhe zbatohet nga qeveria nëpërmjet Ministrisë së Financave².

Më lart (mësimi “*Ekonomia dhe inflacioni*”) thamë se qeveria blen mallra dhe shërbime njësoj si konsumatorët. Nga ana tjetër, ajo kryen edhe investime. Të gjitha këto përbëjnë shpenzimet e qeverisë. Këto shpenzime financohen nga të ardhurat, të cilat qeveria i siguron nëpërmjet taksave që ne të gjithë paguajmë. Më shumë për taksat do të mësojmë në mësimin “*Llojet e taksave në Shqipëri*”.

Si të gjithë ne, edhe qeveria duhet të administrojë me kujdes financat e saj, duke u treguar e kujdesshme me realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve. Nëse qeveria planifikon të kryejë më shumë shpenzime se sa të ardhurat që mund të mbledhë, atëherë buxheti i saj është në **deficit**. Në këtë rast, qeveria merr borxh për të financuar deficitin e saj dhe paguan interes për borxhin e marrë. Në rast se qeveria shpenzon më pak se të ardhurat e realizuara, buxheti i saj është në **suficit**, dhe qeveria mund ta përdorë këtë suficit, për të shlyer një pjesë të borxhit të marrë në vitet e kaluara.

Si ndikon politika fiskale në ekonomi?

Qeveria ndikon ekonominë nëpërmjet dy instrumenteve: shpenzimeve që ajo kryen dhe taksave që ajo mbledh nga




Politika fiskale shtrënguese realizohet nëpërmjet uljes së shpenzimeve apo rritjes së taksave.

² Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Ministrisë së Financave në adresën www.minfin.gov.al

qytetarët. Një politikë fiskale mund të jetë lehtësuese ose shtrënguese.


Një **politikë fiskale lehtësuese** (ose ekspansioniste) është një politikë që nxit nivelin e konsumit në ekonomi dhe rrit kërkesën e përgjithshme. Kjo politikë zbatohet kur ekonomia nuk po rritet sa duhet dhe/ose kur papunësia është në nivele të larta. Ajo mund të realizohet në dy mënyra: nëpërmjet rritjes së shpenzimeve dhe/ose uljes së taksave. Nëse kërkesa e të gjithë pjesëtarëve në ekonomi nuk është aq e lartë sa oferta, qeveria vendos të blejë më shumë mallra dhe shërbime. Duke qenë se vetë qeveria është pjesë e kërkesës për mallra dhe shërbime në ekonomi, atëherë do të rritet direkt kërkesa e përgjithshme e ekonomisë. Shembulli i një politike lehtësuese nëpërmjet rritjes së shpenzimeve pasqyrohet në skemën më poshtë.



Edhe politika lehtësuese nëpërmjet uljes së taksave funksionon në mënyrë të ngjashme: nëse prindërit tuaj do të paguanin më pak taksa mbi të ardhurat nga puna, në familjen tuaj do të tepronin më shumë para për t'u shpenzuar. Në këtë rast, familja juaj do të shpenzonte më shumë, pra do të rriste konsumin dhe si rrjedhojë, do të rritej edhe kërkesa e përgjithshme.

Një **politikë fiskale shtrënguese** realizohet nëpërmjet uljes së shpenzimeve apo rritjes së taksave. Ulja e shpenzimeve qeveritare ul direkt kërkesën për mallra dhe shërbime të

qeverisë dhe për rrjedhojë, edhe kërkesën e përgjithshme. Në rastin kur taksat rriten, konsumatorëve u mbeten më pak të ardhura për të shpenzuar. Ata do të blejnë më pak mallra dhe shërbime, pra kërkesa e përgjithshme ulet. Më poshtë paraqitet skematikisht ndikimi i rritjes së taksave në kërkesën e përgjithshme.



PYETJE?

1. Përshkruani dy politikat makroekonomike dhe objektivat që kanë ato.
2. Çfarë është politika monetare? Cili është institucioni përgjegjës për politikën monetare në Shqipëri?
3. Cili është objektivi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë?
4. Si e zbaton Banka e Shqipërisë politikën monetare?
5. Kur Banka e Shqipërisë zbaton një politikë monetare shtrënguese dhe kur zbaton një politikë monetare lehtësuese?
6. Cilat janë instrumentet me anë të të cilave politika fiskale arrin objektivat e saj?

7. Shpjegoni politikën fiskale lehtësuese dhe atë shtrënguese.


8. Përshkruani me anë të një skeme ndikimin e uljes së taksave në kërkesën e përgjithshme.

9. Përshkruani me anë të një skeme ndikimin e uljes së shpenzimeve në kërkesën e përgjithshme.

5. SISTEMI FINANCIAR³

Sistemi financiar është shumë i rëndësishëm për ekonominë. Ai bashkon kursimtarët e ekonomisë (ata që shpenzojnë më pak para se të ardhurat e tyre) me huamarrësit (ata që shpenzojnë më shumë para, se sa kanë të ardhura), duke mundësuar kështu kalimin e fondeve nga ata që i kanë tepër, tek ata që kanë nevojë për to. Në nivel të përgjithshëm, individët (familjarët) janë kursimtarët tipikë dhe u japin hua kursimet e tyre bizneseve dhe qeverisë. Huamarrësit tipikë më të mëdhenj në një ekonomi tregu janë bizneset, të pasuar nga qeveria. Megjithatë, ndodh që edhe individë të veçantë të jenë huamarrës në një periudhë kohe (për shembull, kur marrim kredi për të blerë një shtëpi apo makinë) dhe biznese të veçanta apo qeveria, të jenë huadhënës të bizneseve të tjera apo individëve.

Në mënyrë skematike, qarkullimi i fondeve midis huadhënësve (kursimtarëve) dhe huamarrësve nëpërmjet sistemit financiar paraqitet si më poshtë.



³ Shënim: të dhënat mbi numrin e institucioneve financiare të paraqitura në këtë mësim i përkasin muajt korrik të vitit 2013.

Kalimi i fondeve nga huadhënësit tek huamarrësit mundësohet nëpërmjet **tregjeve financiare** dhe **ndërmjetësve financiarë**.

Tregjet financiare mundësojnë kalimin direkt të fondeve nga huadhënësit tek huamarrësit. Shpeshherë, lidhja mes huadhënësve dhe huamarrësve kalon nëpërmjet ndërmjetësve financiarë.

Ndërmjetësit financiarë përfshijnë të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime financiare. Institucionet më të rëndësishme financiare janë bankat, institucionet kredituese jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit, kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit.



Bankat tregtare janë institucione financiare që pranojnë depozita dhe i përdorin ato për të dhënë kredi.

A e dini se?

Sistemi bankar shqiptar është segmenti më i zhvilluar i ndërmjetësve financiarë dhe përbën mbi 90% të tij.

Aktualisht, në Shqipëri operojnë 16 banka tregtare, nga të cilat 2 banka janë tërësisht me kapital shqiptar privat, ndërsa

bankat e tjera zotërohen nga kapitali austriak, grek, italian, turk, gjerman dhe francez.

Institucionet kredituese jobanka janë institucione financiare që japin kredi, por nuk mbledhin depozita. Me përjashtim të faktit që ato nuk kanë të drejtë të grumbullojnë depozita nga publiku, aktiviteti i tyre është i ngjashëm me atë të bankave.

A e dini se?

Aktualisht në Shqipëri operojnë 21 institucione kredituese jobanka. Ndër to, 2 janë institucione të mikrokredisë. Nga vetë emërtimi, këto institucione janë të specializuara për kreditimin e individëve dhe njësive të vogla të biznesit në shuma jo më tepër se 600,000 lekë. Ato janë të rëndësishme pasi financojnë individë dhe biznese, aktiviteti i të cilëve zhvillohet në zona që nuk mbulohen nga bankat tregtare.

Shoqëritë e kursim-kreditit janë institucione financiare që pranojnë depozita dhe i përdorin ato për të dhënë kredi, por vetëm për anëtarët e tyre.

A e dini se?

Shoqëritë e kursim-kreditit krijohen nga grupe të ndryshme shoqërore të cilat bashkohen në bazë të një tipari të përbashkët, që mund të jetë profesioni (mësuesit, blegtorët, bletërritësit etj.), komuniteti etj.

Parimet kryesore të funksionimit të shoqërive të kursim - kreditit janë ndihma e ndërsjellë dhe vullnetarizmi. Shoqëritë e kursim - kreditit krijojnë dhe unionet e tyre.

Në Shqipëri, numri i shoqërive të kursim-kreditit është 126. Ato janë të organizuara në 2 unione të kursim-kreditit.

Kompanitë e sigurimit janë institucione financiare që mundësojnë mbulimin financiar të humbjeve si rrjedhojë e fatkeqësive të ndryshme (zjarrit, aksidentit, sëmundjeve, vjedhjes, vdekjes etj.).

A e dini se?

Aktualisht, në Shqipëri ka 9 kompani të sigurimit të jo-jetës dhe 3 kompani të sigurimit të jetës (shiko skemën në f. 138 për emërtimet e kompanive). Ato ofrojnë shërbime sigurimi të jetës, të aksidenteve njerëzore dhe të shëndetit, të makinave, të pronës dhe të pajisjeve.

Fondet e pensionit janë institucione financiare që sigurojnë të ardhura në moshën e pensionit, kundrejt derdhjes së kontributeve gjatë viteve të punësimit.

A e dini se?

Në Shqipëri, skema bazë e pensionit është shtetërore. Të punësuarit paguajnë kontribute në mënyrë periodike, të cilat mblidhen dhe administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Kushdo që është i punësuar në mënyrë të rregullt, është i detyruar të përfshihet në skemën shtetërore të pensionit.

Përveç kësaj skeme, kushdo mund të përfshihet edhe në skema private të pensionit, në mënyrë vullnetare. Numri i fondeve private vullnetare të pensionit në Shqipëri është gjithsej 3, nga të cilat 1 janë me kapital të huaj dhe 2 me kapital vendas dhe të huaj.

Sistemi financiar duhet të jetë i sigurt dhe i qëndrueshëm, në mënyrë që të kryejë si duhet funksionin e tij të kalimit të fondeve nga kursimtarët tek huamarrësit. Mandati i ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi i është dhënë Bankës së Shqipërisë⁴.

Ndërkohë, përgjegjësia për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e segmenteve të ndryshme të këtij sistemi ndahet mes Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare⁵.

Banka e Shqipërisë mbulon sistemin bankar, institucionet kredituese financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mbulon pjesën tjetër: kompanitë e sigurimit, fondet e pensionit dhe tregun e letrave me vlerë.

Të dyja këto institucione gëzojnë pavarësi të plotë në ushtrimin e këtij funksioni. Ato përgjigjen përpara Kuvendit të Shqipërisë, pra, përpara përfaqësuesve të zgjedhur nga populli nëpërmjet votës së lirë.

Mandati i ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar në tërësi, i është dhënë Bankës së Shqipërisë.

⁴ Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë në adresën www.bankofalbania.org

⁵ Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në adresën www.amf.gov.al





LINJA 2:

FINANCAT PERSONALE



KREU 2: FINANCAT PERSONALE

Në pjesën e parë të kësaj lënde, ju morët disa njohuri bazë mbi ekonominë si dhe u njohët me institucionet kryesore ekonomike të rëndësishme për jetën dhe për vendimet tuaja financiare. Në pjesën e dytë të lëndës, do të trajtojmë në detaje aspekte të ndryshme të financave tuaja personale, si më poshtë:


- Paraja dhe vlera e saj në kohë,
- Ndikimi i inflacionit në vlerën e parasë,
- Kursi i këmbimit,
- Buxheti personal,
- Hartimi i një plani kursimi,
- Produktet dhe shërbimet bankare,
- Investimi i kursimeve,
- Të drejtat dhe detyrimet e konsumatorit,
- Pensionet,
- Sigurimet,
- Taksat dhe tatimet.

Në përfundim të studimit të kësaj lënde, ju duhet të jeni të aftë:

- Të hartoni një buxhet të vogël individual dhe të bëni një plan kursimesh;
- Të njihni produktet e ndryshme bankare dhe kostot e tyre;



- Të zgjidhni produktet më të përshtatshme bankare për kursimet tuaja;
- Të llogarisni interesin që mund të fitoni nga depozitat bankare;
- Të njihni llojet e ndryshme të kredive bankare, kostot, si dhe parimet kryesore të përdorimit të tyre;
- Të njihni taksat dhe tatimet kryesore që do të paguani si qytetar i këtij vendi dhe llogaritjen e tyre;
- Të njihni llojet e ndryshme të sigurimit dhe përfitimet nga përdorimi i tyre;
- Të njihni mundësitë që ju keni për të siguruar kushte të mira financiare në moshën e pensionit.



1. Ç'ËSHTË PARAJA? FUNKSIONET E SAJ.


Paraja ka qenë e ndryshme në kohë të ndryshme, por gjithmonë ka qenë e rëndësishme për individët dhe për ekonominë. Fjala “para” përdoret shpesh në të folurën e përditshme dhe merr kuptime të shumta, por, për ekonomistët, paraja është gjithçka e pranuar gjerësisht si mjet pagese për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, si dhe për shlyerjen e detyrimeve.

Monedhat dhe kartëmonedhat e ditëve të sotme i përmbahen këtij përkufizimi dhe, kur njerëzit në gjuhën e përditshme i referohen parasë, shpesh ata nënkuptojnë pikërisht këtë formë paraje. Por, në historinë e njerëzimit, paraja ka marrë forma të ndryshme. Si para kanë shërbyer guaskat (në Egjiptin e lashtë), artikuj të përdorimit të gjerë, si: drithërat, duhani, çaji, sheqeri, kafeja, kakao, por edhe sende të çmuara, si: peliçet dhe metalet e çmuara.

Në pjesën më të madhe të ekonomive të ditëve të sotme, monedhat dhe kartëmonedhat apo ndryshe *cash*-i, janë forma më e përhapur e parasë. Por, “paraja” nuk përkufizohet vetëm si tërësia e monedhave dhe kartëmonedhave të emetuara. Me zhvillimin e shoqërisë, shpikjen e kompjuterit dhe të internetit, janë krijuar edhe forma të tjera të parasë. Kështu, në ditët e sotme në para përfshihet edhe **çeku**, i përdorur masivisht në shekullin e kaluar, **paraja elektronike** dhe **pagesat elektronike**.

Çeku

Çeku është një urdhër nga ju për bankën tuaj, për të transferuar para nga llogaria juaj në llogarinë e dikujt tjetër. Çeku mundëson kryerjen e transaksioneve pa transportuar shumën të mëdha parash me vete.



Guaskat janë një nga format më të hershme të përdorura si mjet këmbimi.

Pagesat elektronike

Pagesat elektronike kanë zëvendësuar çekun në shlyerjen e pagesave. Në vizitat tuaja në qendrat tregtare, duhet të keni vënë re prindërit apo klientë të tjerë, të cilët nuk paguajnë me *cash*, por me karta bankare, që janë të lidhura me llogaritë e tyre bankare në mënyrë elektronike dhe kohë reale. Tashmë, me teknologjinë e internetit, ju mund të kryeni pagesa dhe veprime me llogarinë tuaj bankare pa qenë nevoja të paraqiteni në bankë. Për këtë, ju duhet vetëm një kompjuter, lidhja me internetin dhe një kod sigurie.

Paraja elektronike

Paraja elektronike është zëvendësuese e monedhave dhe kartëmonedhave. Ajo ruhet në një pajisje elektronike në formën e një karte *chip* apo memorie kompiuteri dhe i lejon mbajtësit të kryejë pagesa dhe transfertat elektronike në shumën të kufizuar. Mënyrën e përdorimit të saj mund ta konceptoni njësoj si kartën telefonike me impulse, me të cilën mund të flitet derisa mbarojnë impulsat.

Funksionet e parasë

Pavarësisht formës që mund të marrë paraja, ajo luan tre funksione kryesore në ekonomi. Paraja shërben si mjet këmbimi në blerjen dhe shitjen e mallrave dhe shërbimeve; si njësi matëse ose ndryshe, si standard i vlerës; si ruajtëse e vlerës.

Pothuajse në të gjitha transaksionet e tregut në ekonominë tonë, paraja në formën e monedhës dhe të kartëmonedhës përdoret si **mjet këmbimi**, pra për të paguar mallrat dhe shërbimet që blejmë. Përdorimi i parasë si mjet këmbimi shkurton kohën për shkëmbimin e mallrave dhe të shërbimeve. Për të kuptuar këtë, imagjinoni një vend, të quajtur Trambë, në ekonominë e të cilit nuk ekziston paraja.



Paraja përdoret si mjet këmbimi për të paguar mallrat dhe shërbimet që blejmë.

Në këtë vend jeton edhe Ina, e cila është psikologe. Që Ina të ushqehet, ajo duhet të gjejë një fermer. Por jo vetëm kaq. Ajo duhet të sigurohet gjithashtu, se fermeri ka nevojë për shërbimin e saj si psikologe, në mënyrë që të mund “të paguajë” ushqimet nëpërmjet disa seancave psikoterapie. Ju mund ta imagjinoni se sa e vështirë është për Inën të ushqehet në këtë ekonomi. Ndoshta asaj do t’i duhet të lërë profesionin dhe të bëhet fermere. Tani imagjinojmë se çfarë do të ndodhte nëse një person i mençur në Trambë shpik paranë. Ina do të paguhej në para për shërbimin që do t’u ofronte klientëve të saj, që nuk kishin pse të ishin fermerë. Me këto para, ajo do të blinte ushqim nga fermerët, të cilët, nga ana tjetër, do t’i përdornin këto para për të blerë mallrat dhe shërbimet për të cilat ata kanë nevojë. Në këtë mënyrë, paraja nxit eficiencën ekonomike, duke eliminuar kohën e shpenzuar në shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve, dhe duke u mundësuar njerëzve të specializohen në atë që ata bëjnë më mirë.



Funksioni i dytë i parasë është të shërbejë si njësi matëse.


Funksioni i dytë i parasë është të shërbejë si **njësi matëse**, pra, si matëse e standardizuar e vlerës në ekonomi. Ne e përdorim paranë për të shprehur vlerën e mallrave dhe shërbimeve, ashtu siç masim peshën me kilogramë apo distancën me kilometra. Për të parë se pse ky funksion është i rëndësishëm, le t’i kthehemi sërish vendit tonë imagjinar, Trambës, përpara përdorimit të parasë. Nëse në Trambë ka vetëm tre të mira: mollë, shërbime psikoterapie dhe një qendër argëtimi, atëherë ne na duhet të dimë tre çmime për të përcaktuar sasinë e nevojshme të shkëmbimit të njërit mall me një tjetër: çmimin e mollëve në terma të seancave të psikoterapisë (sa seanca psikoterapie duhen për të blerë 1 kg mollë), çmimin e mollëve në terma të orëve të kaluara në qendrën e argëtimit dhe çmimin e seancës së psikoterapisë në terma të orëve të kaluara në qendrën e argëtimit. Por, nëse në Trambë do të kishte 10 të mira, atëherë numri i çmimeve

që do të na duhej të mbanim mend do të ishte 45¹. Dhe, nëse ekonomia jonë do të kishte 1000 mallra, atëherë do të na duhej të mbanim mend 499500 çmime. Në momentin që në Trambë fillon të përdoret para, çmimet e të gjitha të mirave përcaktohen në para. Nëse në Trambë do të kishte vetëm 3 të mira, nuk do të kishim ndonjë përfitim shumë të madh, nga përdorimi i parasë. Por, nëse numri i mallrave dhe shërbimeve shkon në 1000, atëherë do të na duhet të mbajmë mend vetëm 1000 çmime dhe jo 499500.

Para përdoret edhe si **ruajtëse e vlerës**. Ajo mundëson ruajtjen e fuqisë blerëse në kohë, nga momenti kur të ardhurat merren deri në atë që ato shpenzohen. Ky funksion i parasë është shumë i dobishëm, pasi shumë nga ne nuk duan t'i shpenzojmë të gjitha të ardhurat sapo i marrin, por të presin derisa të kenë kohën, dëshirën dhe nevojën të blejnë mallra dhe shërbime. Para nuk është i vetmi mjet që na ofron ruajtjen e vlerës. Edhe mjete të tjera, si: toka, apartamenti, veprat e artit, bizhuteritë, bonot e thesarit etj. mund të përdoren si ruajtëse të vlerës. Madje, shumë nga këto mjete kryejnë më mirë këtë funksion dhe jo vetëm e ruajnë, por edhe mund të rrisin vlerën e pasurisë tuaj. Atëherë përse njerëzit mbajnë para?

Përgjigja e kësaj pyetjeje lidhet me një koncept të rëndësishëm në ekonomi: konceptin e **likuiditetit** – shpejtësisë me të cilën një mjet (shtëpi, makinë, etj.) mund të këmbetet me para. Këmbimi i mjeteve me para përfshin kosto transaksioni. Nëse doni të shisni shtëpinë për shembull, duhet të paguani një komision prej 2.0-3.0% të vlerës së shtëpisë pranë ndërmjetësit që ka mundur shitjen. Gjithashtu, nëse keni nevojë urgjente për ato para,

¹ Numri i çmimeve në një ekonomi me n mallra, që nuk përdor para, është $n \times (n-1)/2$.



Para përdoret edhe si ruajtëse e vlerës.

mund ta shisni shtëpinë me një çmim më të ulët se sa vlera reale e saj, në mënyrë që të përfitoni vlerën në para sa më shpejt. Pra, ne mbajmë para edhe pse ajo nuk është mjete më tërheqës për të ruajtur vlerën e pasurisë sonë.

A e dini se?

Nga vjen fjala monedhë? Monedhat e para prej argjendi në Romën e lashtë prodhoheshin në tempullin e perëndeshës Juno Moneta. Për këtë arsye, kjo fjalë gjendet në shumë gjuhë edhe sot e kësaj dite, si për shembull: moneta (italisht), money (anglisht), monnaie (frëngjisht) etj.

Në vendin tonë prerja (shtypja) e monedhave e ka zanafillën që në shekullin IV p.e.s në Dyrrah (Durrësi i sotëm) dhe Apolloni (Pojan i Fierit), për të vijuar më vonë edhe në qytete të tjera në Iliri.

PYETJE?

Diskutoni

1. Cila nga shprehjet e mëposhtme lidhet me përkufizimin e parasë të përdorur në këtë tekst?

- “Sa para fiton në muaj?”
- “Para se të shkoj në dyqan, duhet të sigurohem që të kem mjaftueshëm para me vete.”
- “Paraja të prish.”

Arsyetoni

1. Në një vend të vogël banojnë tre njerëz që prodhojnë

tre mallra, si më poshtë:

Malli	Prodhuesi
Mollë	Bujku
Bukë	Bukëpjekësi
Peshk	Peshkatari

Nëse bujku ha vetëm bukë, bukëpjekësi ha vetëm peshk dhe peshkatari ha vetëm mollë, a ka mundësi tregtimi në këtë ekonomi? Si do të përfitonin këta banorë/prodhues nga përdorimi i parasë në ekonominë e tyre?

2. Pse njerëzit prehistorikë që jetonin në shpella nuk kishin nevojë për para?

3. Banorët e Greqisë së lashtë përdornin monedha floriri si para. Pse përdorimi i verës si mjet shkëmbimi nuk ishte aq i mirë sa përdorimi i floririt?

4. Diskutoni mbi aftësinë për të ruajtur dhe rritur vlerën e pasurisë tuaj, si dhe likuiditetin e mjeteve të mëposhtme:

- depozita në një bankë;
- monedha dhe kartëmonedha;
- piktura;
- sende të çmuara, të vjetra;
- makina.

FJALË 

Fuqia blerëse e parasë – tregon se sa shumë mallra dhe shërbime mund të blejë paraja në një moment të caktuar.

Mjet ose aktiv – quhet gjithçka që është burim i një vlere ekonomike për zotëruesin e tij. Mjetet mund të jenë financiare (të paprekshme) ose fizike (të prekshme).

Mjet ose aktiv financiar – quhen të gjitha mjetet që kanë vlerë financiare, e cila buron nga detyrimet e një kontrate. Këto mjete quhen ndryshe të paprekshme, pasi nuk kanë cilësi fizike, si shtëpia apo makina. Shembuj mjetesh financiare janë depozitat bankare, letrat me vlerë, bonot e thesarit.

Konvertim – tregon procesin dhe veprimet konkrete të kthimit ose shndërrimit të një mjeti në një tjetër. Për shembull, mund të përdoret në rastin e kthimit në para të një aksioni, të një pasurie të paluajtshme ose në rastin e këmbimit të një valute me një tjetër.

Kosto transaksioni – në varësi të llojit të transaksionit (shkëmbimit) mund të përfshijë komisionin e kërkuar nga ndërmjetësi financiar, tarifa apo taksa direkte të ndryshme.

2. VLERA NË KOHË E PARASË

Ju jeni nipi apo mbesa e preferuar e gjyshit tuaj. Në ditëlindjen tuaj të 15-të, ai ju kërkon të zgjidhni midis dy dhuratave: (1) 5,000 lekë sot apo (2) 7,000 lekë, por pas 3 vjetësh. Shuma e dytë është më e madhe se e para. Por, shumën e parë e merrni sot, ndërkohë që deri sa të merrni të dytën, duhet të kalojnë 3 vjet. A ia vlen të hiqni dorë nga shuma 5,000 lekë sot për të marrë 7,000 lekë pas 3 vjetësh? Kësaj pyetjeje do të dini t'i jepni përgjigje në fund të këtij mësimi.

Përgjigjja e pyetjes së mësipërme varet nga vlera në kohë e parasë, subjekti i këtij mësimi. Në përgjithësi, termi “*vlerë në kohë e parasë*” ka të bëjë me faktin se 1 lek i zotëruar sot vlen më shumë se 1 lek i premtuar për t'u marrë, në një kohë të ardhme. Një nga arsyet më të rëndësishme për këtë është se 1-lekëshi që ju keni sot mund të depozitohet dhe të fitojë interes, duke u rritur në më shumë se 1 lek në të ardhmen. Lidhja mes parasë sot dhe parasë në të ardhmen, varet nga **norma e interesit** që ju do të fitoni duke investuar paratë dhe nga **periudha e investimit**.

Koncepti i parë që do të trajtojmë është **vlera e ardhshme**. *Vlera e ardhshme e një shume është sasia e parave që do të përfitojmë pas investimit të kësaj shume, me një normë të caktuar interesi, për një periudhë kohe të caktuar. Do të fillojmë me shembullin më të thjeshtë të këtij problemi, investimi për 1 vit.*

Rasti i një viti

Supozoni se vendosni 1,000 lekë në një llogari kursimi që ju paguan një interes prej 10% në vit. Sa lekë do të jenë në llogari pas një viti? Përgjigjja është e thjeshtë: ju do të keni 1,100 lekë në llogarinë tuaj të kursimit pas një viti. Shumës fillestare prej 1,000 lekësh, do t'i jetë shtuar edhe interesi i fituar prej



Koncepti i parasë është i lidhur ngushtë me konceptin e kohës.

100 lekësh ($10\% \times 1,000 = 100$). Shuma prej 1,100 lekësh në fund të vitit është vlera e ardhshme e shumës fillestare prej 1,000 lekësh. Pra, 1,000 lekë sot vlejnë sa 1,100 lekë pas një viti, nëse norma e interesit është 10% në vit.

Rasti i shumë viteve

Duke vazhduar më tej me shembullin e mësipërm, sa lekë do të kishit në llogarinë tuaj pas dy vjetësh, në qoftë se norma e interesit do të vazhdonte të ishte e njëjtë? Kujtoni që, në fund të vitit të parë ju keni në llogari 1,100 lekë. Kjo shumë parash do të investohet edhe për një vit tjetër, me një normë interesi prej 10% në vit. Interesi i fituar do të jetë: $10\% \times 1,100 = 110$. Vlera në fund të vitit të dytë do të jetë $1,100 + 110 = 1,210$ lekë.

Pra formula për llogaritjen e vlerës së ardhshme është:

$$\text{Vlera e ardhshme} = \text{vlerë e tashme} + \text{vlerë e tashme} \times \text{interes}/100$$

Me njohuritë e marra deri tani, ju mund t'i përgjigjeni tashmë pyetjes së ngritur në fillim të këtij mësimi: më mirë të pranoni 5,000 lekë sot apo 7,000 lekë pas 3 vjetësh? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, ju duhet të krahasoni shumat e mësipërme. Por kujdes, për të krahasuar këto dy shuma, duhet që shumën prej 7,000 lekësh ta krahasoni me vlerën që do të përfitoni nëse shumën prej 5,000 lekësh që merrni sot do ta depozitoni në një llogari për 3 vjet. Supozoni se norma e interesit është 9% në vit, në të treja vitet.

$$\text{Interesi në fund të vitit të parë} = 5,000 \times 9\% = 5,000 \times 0.09 = 450 \text{ lekë}$$

$$\text{Shuma e parave në fund të vitit të parë} = 5,000 + 450 = 5,450 \text{ lekë}$$

$$\text{Interesi në fund të vitit të dytë} = 5,450 \times 9\% = 5,450 \times 0.09 = 490.5 \text{ lekë}$$

$$\text{Shuma e parave në fund të vitit të dytë} = 5,450 + 490.5 = 5,940.5 \text{ lekë}$$

$$\text{Interesi në fund të vitit të tretë} = 5,940.5 \times 9\% = 5,940.5 \times 0.09 = 534.65 \text{ lekë}$$

$$\text{Shuma e parave në fund të vitit të tretë} = 5,940.5 + 534.65 = 6,475.15 \text{ lekë}$$

Më mirë 5,000 lekë sot
apo 7,000 lekë pas
3 vjetësh???

Pra, nëse do të zgjidhni të merrni 5,000 lekë sot dhe t'i depozitoni ato në llogari, pas tre vjetësh do të keni 6,475 lekë.



Kjo shumë është më e vogël sesa alternativa e dytë e dhuratës prej 7,000 lekësh, të premtuar nga gjyshi pas tre vjetësh.

PYETJE?

1. Ç'kuptoni me vlerë në kohë të parasë?
2. Nga se varet vlera në kohë e parasë?
3. Çfarë është vlera e ardhshme?
4. Plotësoni kolonën e fundit në tabelën e mëposhtme. Krahasoni vlerat mes pikës 1 dhe pikës 2, pikës 3 dhe pikës 4, pikës 5 dhe pikës 6. Çfarë përfundimesh nxirrni nga këto krahasime?

	Vlera e tashme	Interesi	Periudha	Vlera e ardhshme
1	20,000	5%	1 vit	
2	20,000	8%	1 vit	
3	25,000	10%	2 vjet	
4	30,000	10%	2 vjet	
5	15,000	6%	1 vit	
6	15,000	6%	3 vjet	

5. Zgjidhni mes alternativave të mëposhtme. Norma e interesit është 10% në të gjitha rastet.

- 10,000 lekë sot apo 11,500 pas 1 viti;
- 10,000 lekë sot apo 12,100 pas 2 vjetësh;
- 10,000 lekë sot apo 13,000 pas 3 vjetësh?

FJALOR

Investim – nënkupton përdorimin e parave në një moment të dhënë, me qëllim rritjen e vlerës ose përfitimin e të ardhurave shtesë prej tyre në të ardhmen. Disa forma investimi janë bonot e thesarit, letrat me vlerë, pasuritë e paluajtshme.

Normë interesi – quhet çmimi që një huamarrës i paguan huadhënësit për përdorimin e parave të këtij të fundit, e thënë më thjesht çmimi i parave që janë marrë hua ose janë kursyer në një llogari kursimi. Në rastin e marrjes së një kredie, huamarrësi merr një shumë parash për t'i përdorur për një periudhë kohe të caktuar, ndërsa huadhënësi i dorëzon këto fonde duke hequr përkohësisht dorë nga përdorimi i tyre. Meqenëse huadhënësit sakrifikojnë përdorimin e menjëhershëm të fondeve, ata kërkojnë një kompensim shtesë përveç shumës së parave të dhëna borxh. Kjo është një nga arsyet, që në rastin e marrjes së një kredie, ne i paguajmë bankës një normë të caktuar interesi, ndërsa në rastin e çeljes së një depozite është banka ajo që na paguan normën e interesit.

3. NDIKIMI I INFLACIONIT NË VLERËN E PARASË


Kur folëm për paranë dhe funksionet e saj, thamë që paraja shërben edhe si ruajtëse e vlerës. Gjithashtu, mësuam se paraja shpesh nuk është mjeti më i përshtatshëm për të ruajtur vlerën e pasurisë tuaj, në krahasim me mjete të tjera (shtëpia, pikturat, sende me vlerë etj.), e megjithatë, njerëzit mbajnë para për qëllime likuiditeti.

Aftësia e parasë për të ruajtur vlerën e pasurisë varet nga niveli i çmimeve, pasi vetë vlera e saj është e lidhur me sasinë e mallrave që mund të blihen dhe për rrjedhojë, edhe me nivelin e çmimeve të këtyre mallrave. Dyfishimi i çmimeve për shembull, do të thotë se sasia e mallrave dhe shërbimeve që mund të blejmë me të njëjtën shumë parash është përgjysmuar. Në të kundërt, përgjysmimi i çmimeve do të thotë se sasia e të mirave që mund të blejmë me këtë shumë parash është dyfishuar. Pra, aftësia e parasë për të ruajtur vlerën varet nga ndryshimi i çmimeve në kohë ose nga **norma e inflacionit**.

Përpara se të trajtojmë më tej efektin e inflacionit tek paraja, rifreskoni njohuritë tuaja mbi inflacionin, të cilat i keni marrë në mësimin “*Ekonomia dhe Inflacioni*”!

Efektet e inflacionit

Inflacioni zbeh funksionin e parasë si ruajtëse e vlerës së pasurisë. Nëse të ardhurat tona nuk ndryshojnë, ndërkohë që çmimet e mallrave rriten me kalimin e viteve, ne do të mund të blejmë më pak mallra në krahasim me sot. Në këtë rast, fuqia blerëse e parasë ka rënë: ne blejmë më pak mallra



Inflacioni “gërryen” vlerën e parasë!

dhe shërbime me të njëjtën sasi parash. Ndryshe, themi se **vlera reale e të ardhurave** – vlera e të ardhurave tona e shprehur/matur me sasinë e mallrave që mund të blejmë me to – ka rënë.


Shembull: Efekti i inflacionit në vlerën reale të parasë

Për të matur efektin e inflacionit në vlerën reale të parasë marrim një shembull: llogarisim vlerën reale të shumës prej 1,000 lekësh, të zotëruar në fund të vitit 1994, ndër vite. Në kolonën e dytë të tabelës së mëposhtme paraqitet norma vjetore e inflacionit në fund të çdo viti, duke filluar nga viti 1995. Në kolonën e tretë të tabelës është vlera reale e 1,000-lekëshit në fund të çdo viti. Në kolonën e katërt shpjegohet se si është llogaritur kjo vlerë reale.

Viti	Inflacioni vjetor	Vlera reale	Llogaritja e vlerës reale
1994		1,000 lekë	
1995	6.3%	941 lekë	= 1000/(1+6.3/100)
1996	16.9%	805 lekë	= 941/(1+16.9/100)
1997	44.6%	557 lekë	= 805/(1+44.6/100)
1998	6.0%	525 lekë	= 557/(1+6.0/100)
1999	-1.0%	530 lekë	= 525/(1+(-1/100))
2000	4.2%	509 lekë	= 530/(1+4.2/100)
2001	3.5%	492 lekë	= 509/(1+3.5/100)
2002	1.7%	484 lekë	...
2003	3.3%	468 lekë	...
2004	2.2%	458 lekë	...
2005	2.0%	449 lekë	...
2006	2.5%	438 lekë	...
2007	3.1%	425 lekë	...
2008	2.2%	416 lekë	...
2009	3.7%	401 lekë	...
2010	3.4%	388 lekë	= 401/(1+3.4/100)

Nga fundi i vitit 1994 deri në fund të vitit 1995 ka kaluar një vit. Gjatë këtij viti, inflacioni ka qenë 6.3%, që do të thotë se çmimet e mallrave janë rritur mesatarisht me 6.3%. 1000-lekëshi që kishim në fund të vitit 1994, në fund të vitit 1995 nuk mund të blejë më të njëjtën sasi mallrash dhe shërbimesh, por më pak. Saktësisht, në fund të vitit 1995, vlera reale e 1,000-lekëshit të zotëruar në fund të vitit 1994 është: $1,000/(1+6.3/100) = 941$ lekë. Në fund të vitit 2010, vlera reale e këtij 1,000-lekëshi është 388 lekë. Më poshtë ecuria e vlerës reale të 1,000-lekëshit paraqitet edhe në grafik.

Ecuria e vlerës reale të 1000 lekëve në vite



Formula për llogaritjen e vlerës reale është:

Vlera reale e një viti = Vlerën reale të vitit të kaluar / (1 + normën vjetore të inflacionit / 100)

Për t'u mbrojtur nga inflacioni, disa punëdhënës i rrisin pagat, që u paguajnë punonjësve, çdo vit me një normë të paktën të barabartë me normën e inflacionit vjetor.

Shpesh thuhet se inflacioni është miku më i mirë i huamarrësit dhe armiku më i keq i huadhënësit. Për të kuptuar këtë, supozoni se një vit më parë i keni marrë borxh 20 mijë lekë një mikut tuaj, të cilat do t'ia ktheni sot, pa paguar interes. Gjatë vitit që kaloi, ekonomia përjetoi inflacion të lartë, prej 15%.

Ju i ktheni mikut tuaj 20 mijë lekët e marra borxh. Por, në të vërtetë, ju i keni kthyer mikut tuaj më pak se sa i keni marrë. Me një rritje të nivelit të çmimeve prej 15%, ai nuk mund të blejë më të njëjtën sasi të mirash që blinte në momentin kur ju huazoi paratë. Në të vërtetë, ai blen aq të mira dhe shërbime sa do të kishte blerë me 17,391 lekë në momentin kur ju huazoi paratë, para 1 viti [$20,000/(1+0.15) = 17,391$].

Inflacioni “gërryen” vlerën e kursimeve tuaja!

Supozoni se sot vendosni 10,000 lekë në një llogari, e cila fiton 5% interes në vit. Në fund të vitit të parë, ju do të keni 10,500 lekë [$10,000 \times (1.05)$]. Gjatë këtij viti, inflacioni ishte 7%. Kjo do të thotë se me 10,500 lekët që keni në llogari, ju gjithsesi mund të blini më pak mallra dhe shërbime se sa para një viti, edhe pse fituat interes për kursimet tuaja. Ju mund të blini $10,500/(1+0.07) = 9,813$ lekë mallra dhe shërbime me çmimet e një viti më parë. Gjithsesi, interesi ju ndihmoi të ruanit një pjesë të fuqisë blerëse. Nëse ju nuk do të kishit fituar interes me kursimet tuaja, do të kishit në llogari vetëm 10,000 lekë, të cilat do të vlenin 9,345 [$10,000/(1+0.07)$] lekë mallra dhe shërbime me çmimet e një viti më parë. Në mënyrë që të ruani fuqinë blerëse të kursimeve tuaja, duhet t'i investoni ato me një normë interesi të paktën sa inflacioni.

PYETJE?

1. Shpjegoni efektet e inflacionit në vlerën e parasë.
2. Përmendni disa nga mënyrat e mbrojtjes nga inflacioni.

3. Sillni një shembull kur inflacioni nuk është i dëmshëm për ju.

4. Në tabelën në tekst (f. 70), llogarisni vlerën reale të shumës prej 1,000 lekë për periudhën 2002-2009. Kontrolloni rezultatin tuaj me atë të paraqitur në tabelë.

5. Prindërit tuaj sapo kanë vendosur në bankë 20,000 lekë, në një depozitë me afat 12 muaj. Norma vjetore e interesit është 5%.

- a. Sa është interesi i fituar për 1 vit?
- b. Sa është shuma e parave në bankë pas 1 viti?
- c. Llogarisni vlerën reale të 20,000 lekëve pas 1 viti nëse norma vjetore e inflacionit ka qenë 3%, 5%, 7%. Çfarë vini re?
- d. Llogarisni vlerën reale të shumës së gjetur në pikën b, për tre normat vjetore të inflacionit. Çfarë vini re?
- e. Çfarë përfundimesh mund të nxirrni nga krahasimi i rezultateve të marra në pikat c dhe d? Për ta patur më të lehtë krahasimin, plotësoni tabelën e mëposhtme me vlerat e gjetura.

Inflacioni	Vlera reale e 20 000 lekëve	Vlera reale e shumës së gjetur në pikën b
3%		
5%		
7%		

FJALOR


Indeksim – quhet lidhja e nivelit të një treguesi ekonomik-financiar me një tjetër. Në rastin e inflacionit, për të ruajtur standardin e jetesës së punonjësve nga rritja e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve, disa punëdhënës i indeksojnë (lidhin) pagat me normën e inflacionit. Kështu, çdo vit niveli i pagave rritet me të njëjtën normë sa edhe inflacioni.

4. KURSI I KËMBIMIT DHE NDIKIMI I TIJ NË JETËN TONË

Në botë, thuajse çdo vend ka monedhën e tij. Në Shqipëri ne përdorim lekun, në vendet e Eurozonës përdoret monedha euro, në SHBA përdoret dollari amerikan, në Angli përdoret paundi britanik, në Japoni jeni japonez, e kështu me radhë. Gjithashtu, tregtia mes vendeve përfshin shkëmbimin e monedhave të ndryshme. Kur një kompani shqiptare blen mallra të huaj (importon), për shembull nga Greqia, ajo duhet ta paguajë shitësin e këtyre mallrave në euro. Për këtë, firma duhet të shkëmbejë lekë për të blerë euro. Pra, tregtimi mes vendeve të ndryshme çon në nevojën për të shkëmbyer edhe monedhat e këtyre vendeve me njëra-tjetrën.

Shkëmbimi i monedhave kryhet në tregun valutor apo ndryshe në tregun e këmbimit. Në këtë treg, monedhat e huaja blihen dhe shiten njësoj sikur të ishin një mall, dhe çmimi i tyre është **kursi i këmbimit**. Sasia e lekëve të nevojshme për të blerë 1 euro, është pikërisht çmimi i euros i shprehur në lekë. Si në shumë vende të tjera, regjimi i kursit të këmbimit në Shqipëri është i lirë, që do të thotë se monedhat e huaja mund të tregtohen pa kufizime, dhe se çmimi i tyre në lekë përcaktohet nga kërkesa dhe oferta për këto monedha, pra nga tregu.

Në një regjim të lirë të kursit të këmbimit, vlerat e monedhave të ndryshme luhaten në kohë. Kështu, 1 euro sot kushton 135.0 lekë, por pas një viti, ajo mund të kushtojë 125.0 lekë ose 145.0 lekë. Në rastin e parë (125.0), na duhen më pak lekë për të blerë 1 euro dhe themi se monedha jonë është mbiçmuar kundrejt euros, kurse monedha euro është nënçmuar kundrejt lekut. Në rastin e dytë (145.0), na duhen më shumë lekë për të blerë 1 euro dhe themi se monedha



Në një regjim të lirë të kursit të këmbimit, vlerat e monedhave të ndryshme luhaten lirisht.


jonë është nënçmuar kundrejt euros, kurse monedha euro është mbiçmuar kundrejt lekut.

Pse është i rëndësishëm kursi i këmbimit?

Kursi i këmbimit është i rëndësishëm sepse ndikon në çmimet e mallrave të importuara dhe të atyre të eksportuara. Çmimi në lekë i një malli nga Italia përcaktohet nga ndërveprimi i dy faktorëve: çmimi në euro dhe kursi i këmbimit euro/lek. Supozoni se Ada dëshiron të blejë një kuti djathi italian, e cila kushton 10 euro. Kursi i këmbimit euro/lek sot është 135.0 lekë për 1 euro. Çmimi në lekë i djathit është $10 \times 135.0 \text{ lek/euro} = 1,350 \text{ lekë}$. Adës i pëlqen shumë djathi që bleu dhe pas dy muajsh ajo kërkon të blejë edhe një kuti tjetër. Çmimi i kutisë së djathit vazhdon të jetë 10 euro, por çmimi në lekë do të varet edhe nga kursi i këmbimit. Supozojmë se gjatë këtyre dy muajve, leku është nënçmuar dhe 1 euro tregtohet me 145.0 lekë. Blerja e kutisë së dytë të djathit do t'i kushtojë Adës $10 \times 145.0 = 1,450 \text{ lekë}$ ose 100 lekë më shumë se blerja e parë.

Në të njëjtën kohë, marrim shembullin e një studenti italian, Markos, të cilit i pëlqen peshku shqiptar. Çmimi i peshkut në lekë është 3,000 lekë/kg. Çmimi në euro që do të paguajë Marko për 1 kg është 22.22 euro kur kursi është 135.0 lekë/euro ($3,000/135$) dhe 20.69 euro ($3,000/145$) kur kursi është 145.0 lekë/euro. Të ekspozuar përpara të njëjtit ndryshim në kursin e këmbimit – nënçmimit të lekut – produkti italian u bë më i shtrenjtë për Adën, ndërkohë që produkti shqiptar u bë më i lirë për Markon.

Shembulli i mësipërm na çon në përgjithësimin e mëposhtëm: *Kur monedha e një vendi mbiçmohet (i rritet vlera në krahasim me monedhat e tjera), mallrat e atij vendi bëhen më të shtrenjta për të huajt dhe mallrat e huaja bëhen më të lira për vendasit.*



... po sikur kursi i këmbimit të shkojë në vlerën 125.0 lekë/euro?

Anasjelltas, kur monedha e një vendi nënçmohet, mallrat e tij bëhen më të lira për të huajt dhe mallrat e huaja bëhen më të shtrenjta për vendasit.

Përcaktuesit e kursit të këmbimit

Përmendëm se në një ekonomi me regjim të lirë të kursit të këmbimit, ky i fundit përcaktohet nga oferta dhe kërkesa për monedhën e huaj. Për ta thënë më thjesht, sa më shumë mallra të importojmë nga jashtë, aq më shumë monedhë e huaj do të na duhet për të shlyer detyrimet ndaj të huajve; dhe sa më shumë kërkesë të huaj të ketë për të blerë mallra shqiptare, aq më shumë valutë do të hyjë në vendin tonë si e ardhur nga shitja e këtyre mallrave. Në rastin e Shqipërisë, një pjesë e rëndësishme e ofertës përcaktohet edhe nga dërgesat e emigrantëve apo flukset e investimeve të firmave të huaja në Shqipëri.

Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në ekonominë tonë

Më lart u tregua se nënçmimi i monedhës vendase, ndër të tjera, i bën mallrat e huaja më të shtrenjta. Për një vend kryesisht importues, si Shqipëria, kjo marrëdhënie është shumë e rëndësishme. Nënçmimi i lekut do të sjellë rritjen e çmimeve në lekë të mallrave të konsumit, të cilat importohen nga jashtë.

Përveç efektit të mësipërm, kursi i këmbimit ka rëndësi të veçantë për ekonominë shqiptare, rëndësi që buron nga përfitimi i të ardhurave (paga e të punësuarit ose fitimi i biznesit) në monedhë të huaj dhe përdorimi i monedhave të huaja si ruajtëse të vlerës. Për një pjesë të familjeve shqiptare, një sasi e të ardhurave që përdoren për të blerë



... po sikur kursi i këmbimit të shkojë në vlerën 155.0 lekë/euro?

të mira vijjnë nga të afërmit e tyre, të cilët punojnë e jetojnë në Itali, Greqi apo ndonjë vend tjetër. Gjithashtu, nuk janë pak edhe ata individë që paguhen në monedhë të huaj. Se sa shumë të mira dhe shërbime mund të blejnë këta individë me për shembull, 200 euro, do të varet nga kursi i këmbimit të euros në lekë. Nëse 1 euro këmbehet me 135.0 lekë, atëherë ata mund të blejnë $200 \times 135.0 = 27,000$ lekë të mira dhe shërbime në Shqipëri. Nëse kursi i këmbimit është 145.0 lekë/euro, atëherë ata do të blejnë $200 \times 145.0 = 29,000$ lekë të mira dhe shërbime.



Gjithashtu, ka njerëz të cilët kanë kursime në monedhë të huaj apo zotërojnë mjete që tregtohen në monedhë të huaj (si për shembull, apartamente apo makina). Për ta është i rëndësishëm kursi i këmbimit, pasi përcakton vlerën e kursimeve dhe të pasurisë së tyre në monedhën vendase, lekë.

Shembull 1: Imagjinoni sikur keni një apartament 100 m^2 , i cili aktualisht mund të shitet me çmim 500 euro/m^2 . Në këtë moment, apartamenti juaj vlen $50,000$ euro. Me kursin e sotëm prej 135.0 lekë/euro, apartamenti juaj vlen 6.75 milionë lekë ($50,000 \times 135.0 = 6,750,000$ lekë). Pas 10 muajsh çmimi në euro i apartamentit tuaj nuk ka ndryshuar, por kursi i këmbimit rritet në 145.0 lekë/euro. Në këtë moment, vlera e apartamentit tuaj është rritur në 7.25 milionë lekë ($50,000 \times 145.0 = 7,250,000$ lekë). Pasuria juaj është rritur me $500,000$ lekë ($7,250,000 - 6,750,000$) vetëm nga ndryshimi i kursit të këmbimit.



... nga ndryshimi i kursit të këmbimit edhe mund të përfitohet...

Një efekt i rëndësishëm i kursit të këmbimit shfaqet edhe në shlyerjen e kredisë, të marrë në monedhë të huaj. Në Shqipëri, duke qenë se normat e interesit kanë qenë më të ulëta për monedhën euro në krahasim me lekun, shumë familjarë dhe biznese kanë marrë kredi në euro, edhe pse të ardhurat i kanë në lekë. Pavarësisht përparësisë të normës

së ulët të interesit, një veprim i tillë i ka vënë kredimarrësit përballë luhatjeve të kursit të këmbimit, sikurse tregon edhe shembulli i mëposhtëm.

Shembull 2: Ju keni marrë një kredi për blerjen e një banese. Kredia është marrë në monedhën euro dhe kësti që duhet t'i paguani bankës çdo muaj është 250 euro. Me kursin e sotëm prej 135.0 lekë/euro, ju duhen 33,750 lekë (250×135.0) në muaj për të paguar këstin e kredisë. Pas 10 muajsh, kur kursi i këmbimit është rritur në 145.0 lekë/euro, do t'ju duhen 36,250 lekë (250×145.0) ose 2,500 lekë më shumë.

Nga shembujt e mësipërm, kuptoni se luhatjet në kursin e këmbimit mund të jenë fitimprurëse ose të dëmshme për ju. Për shmangien e situatave të tilla, konsumatorët këshillohen që:

Të marrin parasysh efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit sa herë që kryejnë veprime me monedha të ndryshme nga leku.

Veçanërisht: të përputhin monedhën e kredisë me atë të të ardhurave. Nëse të ardhurat i kanë në lekë, të marrin kredi në lekë. Nëse të ardhurat i kanë sistematikisht dhe në vazhdimësi në euro, të marrin kredi në euro!

PYETJE?

1. Përshkruani çështë kursin e këmbimit? Nga se përcaktohet ai?
2. Argumentoni pse është i rëndësishëm kursin e këmbimit në ekonomi?

3. Vizitoni faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë dhe merrni të dhënat më të fundit mbi kursin e këmbimit të lekut ndaj monedhave të ndryshme. Interpretojini ato.
4. Plotësoni informacionin e munguar në tabelën e mëposhtme:

	Vlera në euro	Vlera në lekë	Kursi i këmbimit lekë për 1 euro
Këst kredie në euro	377.48	?	138.6
Çmimi i një pikturë	?	5000	136.5
Vlera e një apartamenti	50000	?	135.7
Çmimi i një vere italiane	30	?	137.3

FJALËR

Importi – tregon mallrat e prodhuara jashtë vendit tonë dhe të shitura në vendin tonë për qëllime konsumi ose investimi. Importet i sjellin para vendit që i prodhon, duke ia hequr ato vendit në të cilin mallrat shiten.

Eksporti – përfaqëson mallrat e prodhuara në vend dhe të shitura jashtë tij.


5. BUXHETI PERSONAL

Hartimi i një buxheti personal luan një rol mjaft të rëndësishëm në marrjen e vendimeve dhe në ecurinë e veprimeve të jetës tonë të përditshme. Por, përpara se të flasim për rëndësinë e hartimit të një buxheti personal është e rëndësishme që në fillim të kuptojmë se çfarë është një buxhet personal.

Me **buxhet personal** do të kuptojmë: një plan financiar i cili llogarit të ardhurat dhe shpenzimet e një personi ose familjeje, në një periudhë kohe të përcaktuar. Pra, buxheti personal është një pasqyrë e gjendjes tuaj financiare, i cili ju ndihmon të organizoheni më mirë për të arritur një objektiv të caktuar. Objektivi mund të jetë blerja e një telefoni të ri celular në fund të muajit ose kursimi i shumës së nevojshme për të filluar universitetin. Kur një buxheti i vendosni një qëllim dhe një afat të mirëpërcaktuar, ju bëheni akoma më të ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe dobinë që ai ka, si dhe mund të kuptoni më mirë disiplinën dhe respektimin e disa kriterëve që ai kërkon, me qëllim miradministrimin e të ardhurave tuaja.

Përse është e rëndësishme të hartojmë një buxhet personal?

Krijimi i një buxheti personal përbën një nga hapat më të rëndësishëm dhe domethënës për të arritur objektivat tuaj financiarë. Nëpërmjet mbajtjes së një buxheti personal do të bëheni më të aftë dhe të kujdesshëm për të kontrolluar shpenzimet dhe për të shtuar kursimet tuaja. Në një farë mënyre buxheti është ndërgjegjja juaj financiare, që ju tregon sa fitoni dhe sa jeni duke shpenzuar.



Një fjalë e urtë popullore thotë: "Shtriji këmbët sa ke jorganin!"

Hartimi i një buxheti personal ofron një sërë përparësish, të cilat prekin dhe ndikojnë drejtpërsëdrejti cilësinë dhe stilin e jetesës tuaj.

Përparësitë e hartimit të një buxheti janë:

- Identifikon të gjitha të ardhurat e përfituara;
- Identifikon se për çfarë i shpenzoni paratë;
- Qartëson mbi mënyrën më të drejtë për t'i shpenzuar paratë;
- Tregon se nuk mund të shpenzosh më shumë se sa ke;
- Orienton në gjetjen e rrugëve për të përdorur paratë me qëllim shtimin e pasurisë tuaj.

Disa përparësi dytësore janë:

- Zhvillon dhe përmirëson aftësitë organizative, duke siguruar të dhëna për të gjitha veprimet tuaja me para;
- Zhvillon dhe përmirëson aftësitë tuaja të komunikimit dhe vetëbesimit, në rastet kur i ndani paratë ose keni krijuar një buxhet të përbashkët me dikë tjetër, duke ju dhënë një mundësi më shumë për të gjetur gjuhën e përbashkët në lidhje me shpenzimin e parave;
- Zhvillon dhe përmirëson edukimin tuaj në mënyrën e kategorizimit të të ardhurave.




Hartimi i një buxheti orienton në gjetjen e rrugëve për të shtuar pasurinë tuaj.

Si të hartojmë një buxhet dhe ta ndjekim atë?

Buxheti duhet të përmbajë dy fusha kryesore: të ardhurat dhe shpenzimet. **Të ardhurat** tregojnë të gjitha paratë që ju merrni nga burime të ndryshme, të cilat mund të jenë: paga mujore, shpërblimet, ndihma sociale nga shteti apo të afërm tuaj, pensionet, të ardhura nga qiraja e një prone të paluajtshme apo nga investimi i kursimeve. Në anën tjetër të buxhetit gjejmë **shpenzimet**, të cilat tregojnë paratë që ju nevojiten për të përballuar pagesat e ndryshme. Ato mund të shkojnë për të paguar qiranë mujore apo këstin e kredisë, faturat mujore të elektricitetit, ujit, telefonit apo internetit, pagesat e shkollës, ushqimet, veshmbathjet dhe argëtimet tuaja.

Në momentin e hartimit të një buxheti personal, duhet të ndiqni këta hapa kryesorë:

- 1. Identifikoni të ardhurat që merrni gjatë periudhës në fjalë** (pagat, shpërblimet, dhuratat në para, ndihmat ekonomike apo edhe të ardhura nga investimi i kursimeve tuaja);
- 2. Llogarisni të gjitha shpenzimet duke filluar nga ato të detyrueshmet** (ndër shpenzimet e detyrueshme kemi: qiranë e shtëpisë, detyrimet mujore të energjisë elektrike ose të telefonit, sigurimet shëndetësore apo shoqërore, pagesat e kësteve të kredisë, pagesat për abonime të ndryshme, ushqime);
- 3. Llogarisni bilancin e buxhetit tuaj** (kjo është shumë e thjeshtë dhe llogaritet me formulën: *Bilanci = Të ardhura – shpenzime*). Bilanci përbën shumën që ju tepron nga



Gjatë hartimit të një buxheti mos harroni të llogarisni të gjitha shpenzimet!

të ardhurat, pasi keni paguar gjithë detyrimet tuaja. Atë mund ta përdorni për të kursyer, në mënyrë që në të ardhmen të mund të blini celularin e ri, të paguani pushimet, shkollën ose thjesht ta investoni për të përfituar diçka më shumë për të ardhmen.

Nëse të ardhurat janë më të larta se shpenzimet, atëherë bilanci i buxhetit tuaj do të quhet pozitiv. Në të kundërt, kur shpenzimet janë më të mëdha se të ardhurat, bilanci do të jetë negativ. Në rast se bilanci juaj i përket rastit të dytë, zgjidhjet do të jenë dy: të gjeni mënyrën për të fituar më tepër të ardhura ose të shkurtoni shpenzimet, duke filluar nga ato më pak të nevojshme.

Rregulli i artë për të mbajtur nën kontroll financat tuaja është: shpenzimet nuk duhet të tejkalojnë të ardhurat!

Kujdesuni që buxheti juaj personal të jetë i thjeshtë, të pasqyrojë realitetin e të ardhurave dhe shpenzimeve tuaja dhe të përshtatet në rastet e ndryshimit të tyre.

Tabela në faqen në vijim pasqyron aspektin skematik të hartimit të një buxheti familjar. Siç do ta shikoni, hartimi skematik është sa i thjeshtë aq dhe efikas për të kuptuar funksionimin e një buxheti. Zërat e tij mund të përshtaten sipas veçorive të të ardhurave dhe shpenzimeve të secilit prej nesh.

Por, rëndësi akoma më të madhe ka vlerësimi dhe ndjekja e tij. Aftësia për të hartuar një buxhet personal është e rëndësishme, por nëse nuk tregojmë kujdes dhe përpikmëri në plotësimin dhe ndjekjen e tij, atëherë ai nuk do të kishte asnjë vlerë.



Vlerësoni rëndësinë që ka ndjekja e një buxheti personal.

Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që ju të shënoni rregullisht të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet tuaja dhe t'i qëndroni besnikë objektivave tuaj. Kjo do t'ju ndihmonte të jeni vërtet të suksesshëm në kontrollin dhe shpërndarjen më të mirë të parave tuaja.

Të ardhura mujore neto	
Të ardhura nga puna	95,000
Shpërblime	1,500
Ndihma ekonomike	-
Të ardhura nga qiraja	-
Të ardhura nga investimi i kursimeve	2,500
Të ardhurat totale	99,000
Shpenzimet bazë	
Ushqim	27,000
Ujë	1,000
Energji elektrike	5,000
Qira/këst kredie	27,000
Shpenzimet bazë totale	60,000
Shpenzime të tjera	
Mirëmbajtje e shtëpisë (riparime, blerje pajisjesh të vogla)	5,000
Transport (shpenzime për makinën, autobus, tren, taksi)	3,500
Veshje	7,500
Komunikim (telefon, internet)	2,000
Argëtim (dalje me shokët, kinema, teatër, pushime)	4,500
Të tjera	2,500
Shpenzime të tjera totale	25,000
Bilanci (lekë)	14,000

Bilanci = Të ardhura mujore neto - (shpenzime bazë + shpenzime të tjera) =
= shuma totale e mbetur për kursim ose investim.

PYETJE ?

1. Çfarë është një buxhet personal?

2. *Përse është e rëndësishme të hartojmë një buxhet personal?*
3. *Argumentoni se cilat janë përparësitë e një buxheti personal?*
4. *Cilat janë 3 hapat e ndjekura për hartimin e një buxheti personal?*

Detyra

1. *Ndërtoni një skemë të thjeshtë buxheti dhe mendohuni për prindërit tuaj shënimi në të, gjithë të ardhurat dhe shpenzimet e një muaji të familjes tuaj. Çfarë shume parash ju tepron në fund të muajit?*

2. *Në një tjetër tabelë mbani shënim të gjitha të ardhurat që merrni ju vetë gjatë një muaji dhe shpenzimet tuaja. Me siguri që në fund të muajit do të çuditëni se sa shumë shpenzoni.*

6. HARTIMI I NJË PLANI KURSIMI

Imagjinoni sikur bashkë me tre shokët tuaj më të ngushtë të vendosni të shkoni në Sarandë për të kaluar disa ditë pushimi. Ju nuk do të merrni rrugën e parë që ju del përpara, duke shpresuar që të jetë ajo e duhura. Me siguri që do ta planifikoni udhëtimin tuaj përpara, për të vizituar edhe disa pika turistike interesante. Rrugës mund të hasni në trafik dhe duke kontrolluar hartën të devijoni në një drejtim alternativ për të mos humbur kohë. Gjatë udhëtimit do të kontrolloni vazhdimisht ecurinë tuaj.

Një plan kursimi funksionon në të njëjtën mënyrë. Ju ndihmon të arrini objektivin në kohën më të shkurtër të mundshme dhe sa më lehtësisht.

Me **plan kursimi** do të kuptojmë një mënyrë investimi, në të cilën individit kontribuon me një shumë të caktuar parash në mënyrë periodike, për të arritur një objektiv financiar në periudhën afatshkurtër ose afatgjatë. Një shembull i mirë i një plani kursimi është heqja mënjanë dhe depozitimi në një llogari kursimi, i një shume fikse parash çdo muaj. Kjo jo vetëm do t'ju bëjë të mos i shpenzoni ato para, por edhe të përfitoni një interes nga banka.

Arsyet për të krijuar një plan kursimi janë të shumta dhe relative, në varësi të qëllimeve dhe përparësive të gjithsecilit prej nesh. Megjithatë disa nga arsyet që mund të na bëjnë të krijojmë një fond të veçantë parash janë, për:

- raste të paparashikuara/urgjente – ku përfshihen sëmundjet, fatkeqësitë, humbja e vendit të punës etj.;
- shpenzime për banesë/automjet;
- arsimim;



Krijimi i një plani kursimi, ju bën automatikisht më të aftë për të arritur qëllimet tuaja.

- dalje në pension;
- pushime.


Kur hartoni një plan kursimi, ju bëheni automatikisht më të aftë për të arritur qëllimet tuaja, qofshin ato afatshkurtra apo afatgjata. Një plan kursimi ju ndihmon të përmbushni jo vetëm dëshirat dhe nevojat tuaja, por ju siguron qetësinë e nevojshme psikologjike për të zgjidhur probleme të ndryshme financiare që mund të hasni në të ardhmen. Sa më shpejt të vendosni të hartoni një plan kursimi, aq më i vlefshëm do të jetë ai për jetën tuaj.

Është e rëndësishme të dini se nëse vendosni të depozitoni paratë tuaja në një llogari kursimi, ju do të siguronit më shumë përfitime sesa po t'i depozitoni ato në arkën personale të kursimit. Kjo ndodh sepse banka jo vetëm që i ruan paratë tuaja por i kthen ato bashkë me një interes mbi shumën fillestare. Sa më gjatë t'i lini paratë në llogarinë e kursimit, aq më shumë do të grumbullohet interes.

Për të krijuar një ide mbi “**fuqinë**” e **interesit**, marrim një shembull. Supozojmë se brenda një periudhe 2-vjeçare ju dëshironi të blini një celular të ri që kushton 30,000 lekë. Për të arritur rezultatin e dëshiruar duhet që çdo muaj përgjatë 2 viteve të fusni në arkën tuaj të kursimit 1,250 lekë ($30,000/24 = 1,250$).


Shuma e synuar	= 30,000 lekë
Afati kohor	= 24 muaj
Shuma që ju duhet të kurseni çdo muaj	= 1,250 lekë

Nëse vendosni të depozitoni në llogarinë e kursimit nga 1,250 lekë për çdo muaj, me një interes vjetor 5%, falë interesit që fiton llogaria e kursimit, pas 2 vjetësh ju do të keni në llogari jo vetëm 30,000 lekë, por edhe 1,482 lekë



Hartimi i një plani kursimi ju siguron qetësinë e nevojshme psikologjike për të zgjidhur probleme të ndryshme financiare.

më shumë si rrjedhje e interesit të fituar (figura poshtë, majtas). Këtë shumë mund ta përdorni fare mirë për të blerë një këllëf mbrojtës për celularin e ri. Me kalimin e viteve, efekti i interesit është edhe më i madh.



Tre janë konceptet e rëndësishme për hartimin e një plani kursimi: shuma e synuar (objektivi), afati kohor dhe shuma që duhet të kurseni çdo muaj. Dhe mos harroni “fuqinë” e interesit!

Gjithashtu, mund të llogaritet edhe se sa është shuma që ju duhet të kurseni çdo muaj në mënyrë që në fund të dy viteve të keni vlerën prej 30 mijë lekësh. Nëse norma e interesit është 5%, kjo shumë është 1,191 lekë ose 59 lekë më pak se shuma prej 1,250 lekësh, që duhet të hiqni mënjanë nëse kursimet nuk i vendosni në bankë.

Meqenëse për ndjekjen e planit të kursimit do të na duhet të kursëjmë, më poshtë gjeni disa këshilla praktike:

- Hapni një llogari kursimi dhe vlerësoni përparësinë që ju sjell sigurimi i një depozite personale. Depozitimin e rregullt në llogarinë e kursimit vlerësojeni si një shpenzim të pashmangshëm, njëloj si pagesën e faturës së energjisë elektrike.



Mos harroni “fuqinë” e interesit!

- Pajisuni me kartën e “Studentit” dhe mundohuni të gjeni dyqane, të cilat ofrojnë çmime të ulura për studentët.
- Shfrytëzoni transportin publik. Kështu do të shpenzoni më pak se sa të përdorni një makinë personale.
- Përpara se të dilni në treg, bëni një listë të sendeve që vërtet ju nevojiten. Kjo ju jep mundësi që t’i shmangeni blerjeve impulsive, për rrjedhojë edhe të shpenzoni më pak.
- Kur dilni me miqtë, në bare apo diskoteka, mos i mbani të gjitha paratë me vete dhe nëse keni një kartë krediti, lëreni atë në sirtar!

PYETJE ?

1. Çfarë është një plan kursimi?
2. Përse shërben një plan kursimi?
3. Çfarë hapash duhet të ndiqni për të hartuar një plan kursimi?

Argumentoni

Pse është e rëndësishme që paratë e kursyera, sado pak që të jenë ato, t’i mbani në bankë? Ilustrojeni mendimin tuaj me shembuj.

7. PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE

Në mësimin mbi sistemin financiar, pamë që bankat luajnë rolin e ndërmjetësit financiar, duke lehtësuar kalimin e fondeve nga ata që i kanë tepër (kryesisht individët) tek ata që kanë nevojë për to (kryesisht bizneset). Në kryerjen e këtij funksioni, bankat ofrojnë lloje të ndryshme produktesh dhe shërbimesh për të gjithë aktorët e ekonomisë: individë e familjarë, biznese dhe institucione shtetërore. Në këtë mësim, do t'ju prezantojmë produktet dhe shërbimet që i ofrohen individëve dhe familjarëve.

Produktet dhe shërbimet bankare për individët dhe familjarët mund të grupohen si më poshtë:

- Llogari rrjedhëse,
- Llogari kursimi dhe depozita me afat,
- Kredi,
- Karta bankare,
- Transferta bankare,
- Këmbim valutor.

Llogaria rrjedhëse

Marrëdhënia me bankën zakonisht fillon me hapjen e një llogarie rrjedhëse. Në llogarinë rrjedhëse depozitohen të ardhurat nga puna apo nga aktivitete të tjera të zakonshme për individët. Qëllimi kryesor i llogarisë rrjedhëse është përdorimi i parave të depozituara në to për të kryer pagesa (për shembull, për të paguar faturën e energjisë elektrike



Bankat ofrojnë lloje të ndryshme produktesh dhe shërbimesh për të gjithë aktorët e ekonomisë.

apo për të transferuar para në llogarinë e dikujt tjetër) dhe jo kursimi i tyre. Fondet në llogarinë rrjedhëse mund të përdoren në çdo moment dhe zakonisht zotëruesi i llogarisë rrjedhëse nuk fiton interes prej tyre.

Veprimet që mund të kryeni me llogarinë rrjedhëse janë:

- Marrja e pagës mujore nga punëdhënësi juaj;
- Tërheqja dhe depozitimi i parave në sportelet e bankës apo në bankomate (ATM) nëpërmjet kartës së debitit;
- Pagesa për fatura të ndryshme (telefoni, energji elektrike, qira etj.);
- Shlyerja e këstit të kredisë ose e detyrimit të kartës së kreditit;
- Pagesa të ndryshme me kartë debiti të lidhur me llogarinë rrjedhëse (për shembull, në dyqane, restorante etj.);
- Pagesa nëpërmjet çeqeve;
- Transferata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.



Nëpërmjet llogarisë rrjedhëse, ju mund të kryeni shumë lloje veprimesh.

Llogaria e kursimit dhe depozita me afat

Në rast se dëshironi të kurseni, atëherë ju duhet të zgjidhni t'i vendosni paratë në një llogari kursimi apo depozitë. Me të dyja këto produkte, do të njiheni më gjerësisht në mësimin pasardhës, i cili flet për investimin e kursimeve tuaja.

Kredia

Kredia është një produkt financiar nëpërmjet të cilit, kundrejt pagesës së interesit, ju përdorni lekët e bankës për të blerë mallra dhe shërbime. Kredia bankare është një

mjet shumë i rëndësishëm, pasi na mundëson të blejmë të mira dhe shërbime në momentin që ato na duhen, edhe pse në atë çast mund të mos i kemi paratë e nevojshme për të përballuar blerjen e tyre. Për këtë përfitim në kohë të të mirave apo shërbimeve, kredimarrësi paguan një çmim, interesin. Nga ana tjetër, kredia duhet të përdoret me zgjuarsi dhe përgjegjshmëri. Më shumë për kredinë, për llojet e saj dhe për mënyrën se si duhet ta administrojmë, do të mësoni në mësimin e dedikuar posaçërisht për kredinë.

Kartat bankare

Kartat bankare janë mjete pagese elektronike të lëshuara nga bankat tregtare. Ato shërbejnë si zëvendësuese të parasë letër dhe përdoren për të kryer pagesa ose për të tërhequr para *cash* nga llogaria e zotëruesit të kartës nëpërmjet një bankomati. Për nga funksionet dhe karakteristikat e tyre, kartat bankare ndahen në *karta debiti* dhe *karta krediti*.

Zakonisht, me hapjen e një llogarie rrjedhëse, banka ju jep edhe një **kartë debiti**. Me kartën e debitit mund të tërhiqni paratë që keni në llogarinë tuaj rrjedhëse nëpërmjet bankomatit dhe të kryeni pagesa nëpër dyqane, restorante, të pajisura me pikat e shitjes ose POS. Tërheqjet dhe pagesat e ndryshme nëpërmjet kartës së debitit mund të kryhen vetëm nëse në llogarinë rrjedhëse ka para të mjaftueshme.

Me **kartën e kreditit** mund të kryeni të gjitha veprimet që kryeni me kartën e debitit, me një dallim të rëndësishëm. Ndryshimi është se kur paguani apo tërhiqni *cash* me kartë krediti, ju nuk përdorni fondet tuaja, por fonde të bankës, të cilat banka jua ka lënë në llogarinë tuaj. Pra, përdorimi i kartës së kreditit është i ngjashëm me kredinë - ju përdorni paratë e bankës për të blerë të mira dhe shërbime, dhe në



Me kartën tuaj të kreditit nuk mund të shpenzoni pa limit!

një moment të dytë shlyeni detyrimet tuaja ndaj bankës për këto blerje. Në këmbim të përdorimit të fondeve të bankës, ju paguani komisione dhe në raste të veçanta edhe interes.

Me dhënien e kartës së kreditit, banka ju jep të drejtën për të përdorur paratë në zotërim të bankës, për të bërë pagesa të ndryshme. Shuma maksimale që mund të shpenzoni quhet **limit i kartës së kreditit**. Limiti i kartës së kreditit përcaktohet kryesisht nga të ardhurat tuaja dhe nga korrektësia juaj në marrëdhënie me bankën.

Shumica e kartave të kreditit kanë një periudhë gjatë së cilës nuk llogarisin interes për detyrimet tuaja të pashlyera. Kjo është zakonisht 30-45 ditë. Në fund të kësaj periudhe, ju duhet të shlyeni detyrimet. Por, banka ju ofron mundësinë të shlyeni vetëm një pjesë të detyrimit, për shembull 10% apo 20% të tij. Për pjesën që mbetet pa paguar do të paguani interes, i cili zakonisht është i lartë.

Kujdes! Në qoftë se bini në grackën e “paguaj vetëm pjesërisht”, ju do ta keni shumë të vështirë të vetëdisiplinoheni dhe të shlyeni plotësisht detyrimet ndaj bankës.

Kartat e kreditit janë një shoqërues shumë i mirë i udhëtimit jashtë vendit. Ato zëvendësojnë paratë *cash* që do t’ju duhej të merrnit me vete në udhëtim, të cilat mund të humbasin lehtë.

Kartën e kreditit ju mund ta përdorni për të tërhequr para *cash* jashtë vendit ose për të paguar për blerjet e ndryshme nëpër dyqane.

Në tabelën pasardhëse u jepet përgjigje disa nga pyetjeve më

të zakonshme mbi funksionet dhe karakteristikat e dy llojeve të kartave bankare.

	Kartat e debitit	Kartat e kreditit
Përdoret për të tërhequr cash?	Po, në çdo sportel, bankomat (ATM) të bankës tuaj kur në llogari ka gjendje cash Brenda dhe jashtë vendit	Vetëm në bankomate (ATM), por jo në sportele të bankës Brenda dhe jashtë vendit
Shërben për të paguar të mira dhe shërbime?	Po, në dyqanet, qendrat tregtare, restorantet e pajisura me POS	Po, në dyqanet, qendrat tregtare, restorantet e pajisura me POS
A përbën kredi?	Jo	Jo
Si kryhet pagesa?	Drejtëpërdrejt nga fondet tuaja në llogari	Nga fondet e bankës. Brenda një periudhe kohe të caktuar (1 muaj) ju duhet të shkoni në bankë dhe të shlyeni detyrimet tuaja, plotësisht ose pjesërisht.
Paguhen komisione për përdorimin e tyre?	Në shumicën e rasteve jo, në raste të caktuara po (p.sh. tërheqje cash në bankomate të bankave të tjera)	Zakonisht po, në disa raste jo. Kjo varet nga banka në të cilën jeni klientë.

Transferta bankare

Transferta bankare është veprim përmes të cilit klienti i një banke udhëzon bankën që të dërgojë një shumë të caktuar parash nga llogaria e tij bankare, në llogarinë bankare të një personi tjetër apo të një biznesi. Transferta mund të kryhet brenda të njëjtës bankë, nga një bankë në një bankë tjetër dhe ndërmjet bankash që nuk ndodhen në të njëjtin shtet. Dy llojet e para të transfertave quhen transferta kombëtare, kurse transfertat e tretë quhet transfertë ndërkombëtare. Në ditët e sotme, teknologjia ka bërë të mundur që klienti mund të urdhërojë një transfertë bankare edhe përmes bankomatit (ATM-së), telefonit apo internetit, pa qenë e nevojshme të paraqitet fizikisht në sportelet e bankës.

Kryerja e një transferte bankare përgjithësisht ofrohet kundrejt një komisioni, që quhet komision transferte. Në shumicën e rasteve, transfertat mes klientëve të së njëjtës bankë brenda vendit nuk kanë komision. Është e drejta juaj që të kërkonit informacion nga banka dhe të njiheni mirë me komisionet e transfertave përpara se të udhëzoni kryerjen e një transferte.

Këmbim valutor

Këmbimi valutor është një shërbim financiar që përfshin njëkohësisht blerjen e një monedhe dhe shitjen e një monedhe tjetër. Për shembull, nëse do të bëni një udhëtim në Itali, ju duhet të blini euro. Në këmbim të shumës në euro, ju jepni një shumë të caktuar lekësh. Gjithashtu, ju bëni një këmbim valutor nëse “thyni” dollarët amerikanë që ju ka dhuruar tezja që jeton në SHBA. Ju jepni dollarët dhe në këmbim të tyre merrni lekë. Të gjitha këto veprime ju mund t’i kryeni në bankë, por mund t’i kryeni edhe në agjencitë e këmbimit valutor. Zakonisht, mund të jetë më e leverdisshme që t’i kryeni në agjencitë e këmbimit valutor.

Kujdes, ju asnjëherë nuk duhet të kryeni këmbim valute në njerëz apo agjenci, të cilët nuk janë të autorizuar të ofrojnë këtë lloj shërbimi.

PYETJE?

1. *Cilat janë produktet dhe shërbimet kryesore që ofrohen nga bankat?*

2. Çfarë është llogaria rrjedhëse? Për çfarë përdoret ajo?
3. Ku ndryshon llogaria rrjedhëse nga llogaria e kursimit dhe depozitat me afat?
4. Çfarë është kredia?
5. Çfarë janë kartat bankare? Për çfarë na shërbejnë ato?
6. Bëni dallimin mes kartave të debitit dhe atyre të kreditit.
7. Çfarë është transferta bankare? Sa llojesh i kemi ato?
8. Çfarë është këmbimi valutor? Jepni shembuj të këmbimit valutor.

FJALOR

ATM (Automated Teller Machine) ose bankomat- Pajisje elektromekanike, e cila i mundëson zotëruesit të një karte debiti apo krediti që nëpërmjet saj të kryejë veprime për tërheqjen ose depozitimin e parave, pagesa për shërbime apo transferimin e fondeve ndërmjet llogarive. Këto pajisje mund t'i gjeni përgjithësisht pranë degëve të bankave, por edhe në të gjitha qendrat e mëdha tregtare apo qendrat kryesore të biznesit.

POS (Point of Sale) ose pikë shitjeje - Pajisje fizike që bën të mundur përdorimin e kartave bankare për të paguar produktet ose shërbimet e blera. Këto pajisje mund t'i gjeni pranë të gjitha aktiviteteve tregtare, të tilla si: dyqane, agjenci udhëtimi apo supermarketete.

8. INVESTIMI I KURSIMEVE

Ju duhet ta keni kuptuar tashmë se të mirat dhe shërbimet që do të dëshironit të blinit janë të pafundme, por të ardhurat tuaja janë të kufizuara. Gjithashtu, ju e dini se disa gjëra, si për shembull një celular i ri, nuk mund të blihen me paratë që prindërit ju japin çdo javë apo çdo muaj. Ju duhet të hiqni mënjane një shumë të caktuar çdo javë ose çdo muaj në mënyrë që ta blini atë. Nga ana tjetër, ju mund të doni që të keni gjithmonë një shumë të caktuar mënjane, për ta përdorur për shpenzime të paparashikuara. Ky proces quhet ndryshe **kursim**.

Kursimi është procesi i heqjes mënjane të asaj pjese të të ardhurave që nuk e konsumojmë (që nuk e përdorim tani për të blerë të mira dhe shërbime), të cilën e ruajmë për ta konsumuar në një moment të dytë ose për të përballuar shpenzimet e papritura.

Me procesin e kursimit ju u njohët në mësimin 6, ku mësuat edhe disa këshilla praktike se si të hartoni një plan kursimi për veten tuaj.

Por, natyrshëm lind pyetja, çfarë të bëjmë me paratë e kursyera? Një mundësi është që t'i mbajmë ato në shtëpi, në një arkë kursimi. Kjo mund të jetë normale kur jemi shumë të rinj, kursejmë pak dhe kur jemi më të vegjël se 18 vjeç e nuk mund të kryejmë veprime financiare, por nuk është shumë e përshtatshme kur jemi më të rritur e kursimet tona janë më të mëdha. Për më tepër, përveç ruajtjes mënjane të kursimeve tona, do të ishte akoma edhe më mirë sikur të kishte një mënyrë që vlera e këtyre kursimeve të rritej. Kjo realizohet nëpërmjet **investimit** të kursimeve.

Çfarë të bëjmë me paratë e kursyera?

Investimi është procesi i përdorimit të kursimeve për të blerë produkte financiare ose mjete të tjera me qëllim përfundimtar rritjen e vlerës së tyre (kursimeve).

Ka shumë mënyra për të rritur vlerën e kursimeve nëpërmjet investimit. Në vijim ju do të njiheni me mënyrat kryesore. Të gjitha këto alternativa kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre, dhe çdonjëra mund të jetë më e përshtatshme se të tjerat në situata të caktuara.

A. Depozitat bankare

Mënyra më e thjeshtë për të investuar kursimet tuaja është depozitimi në bankë i tyre. Dy janë alternativat kryesore për vendosjen e kursimeve në bankë: **llogaria e kursimit** dhe **depozita me afat**. Përgjithësisht, banka paguan interes për paratë që ju depozitoni në të.

Llogaria e kursimit, e quajtur ndryshe edhe **depozitë pa afat**, është një formë e depozitimit të fondeve pranë bankës për një periudhë të pacaktuar kohe, me qëllim kursimin e tyre. Në llogarinë e kursimit mund të depozitohen dhe tërhiqen para në çdo moment, por fondet e depozituara në të nuk mund të përdoren për të kryer pagesa. Banka paguan interes për paratë e depozituara në llogari. Zakonisht, kjo formë kursimi përdoret kur konsumatori dëshiron të kursejë, por nuk është i sigurt për madhësinë e kursimit dhe/ose kohën gjatë së cilës dëshiron t'i kursejë këto fonde.

Nëse konsumatori është i sigurt që ato para nuk i duhen për një periudhë kohe të caktuar, atëherë do të ishte e këshillueshme që ai të zgjidhte depozitën me afat si një formë më të përshtatshme për kursimet e tij.



Jastëku nuk ju jep interes për paratë që depozitoni nën të!

Depozitat me afat janë fonde të vendosura nga klientët e bankës në bankë, për një afat të përcaktuar kohe, i cili quhet ndryshe edhe *afat maturimi*. Fondet mund të depozitohen në monedha të ndryshme. Klienti fiton interes për paratë e depozituara në depozita me afat dhe zakonisht, sa më i gjatë afati i maturimit, aq më e lartë është edhe norma e interesit që banka paguan për depozitën. Ndryshe nga llogaritë e kursimit, klienti nuk mund të tërheqë lirisht paratë e vendosura në depozita me afat përpara mbarimit të afatit të maturimit. Në rast se ai dëshiron ta bëjë këtë, atëherë ai duhet të paguajë një gjobë, e cila është e përcaktuar në kontratën e nënshkruar mes bankës dhe klientit. Në rastin më të keq, klienti do të marrë vetëm shumën e vendosur në momentin e hapjes së depozitës dhe do të humbasë interesin e fituar deri në momentin e prishjes së depozitës.

A e dini se?

Institucioni që mbron kursimet e qytetarëve nga rreziku i një falimentimi të mundshëm të bankave është Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD). Ajo siguron dhe kompenson të gjitha llojet e depozitave në lekë dhe në valutë deri në shumën prej 2.5 milionë lekësh, për çdo depozitues dhe në çdo bankë që vepron brenda territorit të vendit tonë. Për më shumë informacion vizitoni faqen e internetit të ASD-së në adresën www.dia.org.al

Publikimi i normës së interesit dhe afati i depozitave


Në tabelën në vijim paraqitet një informacion mbi normat e interesit për depozitat pa afat (llogaritë e kursimit) dhe depozitat me afate të ndryshme, nga 1 muaj deri në 60 muaj (ose 5 vjet), për monedhën Lek. Kjo tabelë është e ngjashme me ato që publikohen nga bankat, por është më e thjeshtë.

Lloji i depozitës	Llogari kursimi	Depozita me afat								
		pa afat	1- muaj	3- muaj	6- muaj	12- muaj	24- muaj	36- muaj	48- muaj	60- muaj
Afati	pa afat									
Norma e interesit		3.00%	3.60%	3.80%	4.30%	5.40%	6.50%	6.70%	6.80%	7.00%


Ajo që duhet të keni parasysh është se normat e dhëna nga banka për afate të ndryshme maturimi janë të shprehura në terma vjetorë. Kështu për shembull, tek depozita me afat 1 muaj, ju nuk fitoni 3.6% interes në 1 muaj. Norma 3.6% është një normë vjetore interes. Në një muaj ju do të fitoni 1/12-ën e saj. Po kështu, norma e interesit që do të fitoni për depozitën me afat 6 muaj nuk është 4.3%, por $\frac{1}{2}$ ($= 6/12$) e saj. Me të njëjtën logjikë, norma e interesit që shihni tek depozita 24-mujore nuk është norma e interesit që do të fitoni nga depozitimi i kursimeve për 24 muaj, por vetëm për 12 muajt e parë.

Ajo që vihet re nga tabela është se sa më i gjatë afati i maturimit, aq më e lartë është edhe norma e interesit që paguan banka. Kjo, pasi banka paguan për “ngurtësimin” e parave tuaja për një kohë të gjatë, pra, ju paguan më shumë kur koha për të cilën ju hiqni dorë nga përdorimi i kursimeve tuaja është më e gjatë.

Sa më e lartë norma e interesit, aq më shumë fitoni (figura poshtë majtas) !!!
Sa më gjatë t’i depozitoni paratë tuaja, aq më shumë fitoni (figura poshtë djathtas)!!!



■ Interesi
■ shuma e investuar



■ Interesi
■ shuma e investuar

Llogaritja e interesit

Në mësimin mbi vlerën e parasë ju mësuat se si të bëni një llogaritje të thjeshtë interesi. Rifreskoni njohuritë e marra në këtë mësim përpara se të vazhdoni me leximin më poshtë.

Shembull 1: Llogaritja e interesit për depozita me afat më të shkurtër se 1 vit

Supozoni se do të depozitoni 10,000 lekë në një depozitë me afat 3 muaj. Norma vjetore e interesit (nga tabela) është 3.8%. Sa do të fitoni ju pas 3 muajsh?

Norma e interesit për periudha më të vogla se një vit llogaritet: Interesi i shpallur (vjetor) x (numrin e muajve të depozitës) / (numrin e muajve në një vit)

Norma e interesit për 3 muaj = $3.8\% \times 3/12 = 0.95\%$

Interesi i fituar për **3 muaj** = $10,000 \times 0.95\% = 10,000 \times 0.95/100 = 95$ lekë

Në fund të 3 muajve, vlera e depozitës tuaj do të jetë bërë: $10,000 + 95 = 10,095$ lekë.

Hapi 1: gjeni normën e shpallur vjetore të interesit për depozitën me afat maturimi x muaj.

Hapi 2: pjesëtojeni me 12 dhe shumëzoheni me x muaj.

Hapi 3: gjeni interesin e fituar për x muaj.

Hapi 4: mbliidhni shumën e depozituar me interesin e fituar.

Shembull 2: Llogaritja e interesit për depozita me afat më të gjatë se një vit

Supozoni se do të depozitoni 10,000 lekë në një depozitë me afat 24 muaj. Norma vjetore e interesit (nga tabela në f. 101) është 6.5%. Sa do të fitoni ju pas 24 muajsh?

Norma e interesit e publikuar është vjetore. Pra, për vitin e parë ju fitoni 6.5% mbi 10,000 lekëshin e depozituar:

Interesi i vitit të parë = $10,000 \times 6.5\% = 10,000 \times 6.5/100 = 650$ lekë



...1>3!

Në fund të vitit të parë, vlera e depozitës tuaj do të jetë bërë: $10,000 + 650 = 10,650$ lekë. Kjo shumë do të investohet edhe për një vit tjetër, me një normë interesi vjetor po 6.5%.

Interesi i vitit të dytë = $10,650 \times 6.5\% = 10,650 \times 6.5/100 = 692.25$ lekë.

Në fund të vitit të dytë, vlera e depozitës tuaj do të jetë e barabartë me vlerën e saj në fund të vitit të parë plus interesin e fituar vitin e dytë, pra $10,650 + 692.25 = 11,342.25$ lekë.

***Hapi 1:** gjeni normën e shpallur vjetore të interesit për depozitën me afat maturimi y muaj.*

***Hapi 2:** gjeni interesin e fituar për vitin e parë duke përdorur këtë normë.*

***Hapi 3:** gjeni vlerën e depozitës në fund të vitit të parë.*

***Hapi 4:** gjeni interesin e fituar për vitin e dytë duke përdorur të njëjtën normë interesi.*

***Hapi 5:** gjeni vlerën e depozitës në fund të vitit të dytë.*


***Hapi 6:** gjeni interesin e fituar për vitin e tretë duke përdorur të njëjtën normë interesi.*

***Hapi 7:** gjeni vlerën e depozitës në fund të vitit të tretë.*

.... e kështu me radhë deri në vitin e fundit të maturimit të depozitës.


B. Investimi në bono thesari

Vendosja e kursimeve tuaja në depozita bankare është një mënyrë shumë e sigurt për ruajtjen e kursimeve. Por, një alternativë tjetër edhe më e sigurt është investimi i kursimeve në bono thesari.



Sa më i gjatë afati i maturimit, aq më i madh fitimi.

Bonot e thesarit janë letra me vlerë të qeverisë, me afat maturimi deri në 1 vit. Nëpërmjet blerjes së tyre, ju i jepni borxh qeverisë për të financuar projektet e saj të investimit. Në këmbim, qeveria ju kthen shumën që i keni dhënë borxh së bashku me interesin.



Qeveria Shqiptare ka bono thesari me maturim 3, 6 dhe 12-mujor. Për më shumë informacion mbi bonot e thesarit dhe investimin në to, shfletoni broshurën e Bankës së Shqipërisë, të publikuar në faqen e saj të internetit:

http://www.bankofalbania.org/web/Te_njohim_Bonot_Thesarit_5715_1.php

Zakonisht, investimi në depozita dhe bono thesari realizohet nga individë të cilët nuk kanë kursime shumë të mëdha, por edhe nga ata individë të cilët preferojnë të kenë një nivel të lartë sigurie për vlerën e kursimeve të tyre. Kursimet rriten pak, por janë shumë të sigurta.

C. Investime në pasuri të paluajtshme

Në një moshë më të madhe, ndoshta rreth të 40-ave, në qoftë se keni qenë të suksesshëm në punën dhe karrierën tuaj, mund të keni grumbulluar një sasi të konsiderueshme kursimesh. Ju

mund të jeni të kënaqur duke i mbajtur ato të investuara në depozita bankare apo bono thesari. Kursimet tuaja do të ishin të sigurta, ndërkohë që do të fitonit edhe një normë interesi. Po nëse nuk do të ishit të kënaqur me interesin e fituar dhe do të kërkonit të fitonit më shumë? Një alternativë e mirë mund të ishte edhe investimi në pasuri të paluajtshme: blerja e apartamenteve, shtëpive, dyqaneve, ambienteve të biznesit (zyra, magazina) etj.

Shembull 3: Investim i suksesshëm në pasuri të paluajtshme

Në moshën 45 vjeç, ju keni arritur të kurseni një shumë prej 8 milionë lekësh. Disa miq, njohës të mirë të tregut të pasurive të paluajtshme, ju këshillojnë që këto kursime t'i përdorni për të blerë një apartament, në një lagje të re të qytetit. Vlera e apartamenteve në këtë lagje pritet të rritet në të ardhmen, si rrjedhojë e përmirësimit të infrastrukturës në atë zonë. Ju vendosni të ndiqni këshillën e miqve dhe me 8 milionë lekët që keni, blini një apartament në atë zonë. Miqtë kishin të drejtë dhe pas 5 vjetësh, vlera e apartamentit është rritur. Ju mund ta shisni atë apartament me 12 milionë lekë. Kursimet tuaja u rritën kështu me 4 milionë lekë për 5 vjet.

Në qoftë se ju do t'i kishit vendosur kursimet tuaja në një depozitë 1-vjeçare me një normë mesatare interesi prej 6%, për 5 vjet, vlera e kursimeve tuaja do të ishte: $8 \times (1+0.06)^5 = 10.7$ milionë lekë. Pra, në një depozitë, kursimet tuaja do të ishin rritur me 2.7 milionë lekë për 5 vjet.

Vlera e kursimeve tuaja u rrit më shumë nga investimi në pasuri të paluajtshme. Por ky nuk është i vetmi përfitim që ju merrni nga ky lloj investimi. Gjatë këtyre 5 viteve, ju mund ta kishit dhënë apartamentin me qira. Të ardhurat nga qiraja u shtohen kursimeve tuaja. Në qoftë se qiraja që keni marrë ka qenë 30 mijë lekë në muaj, për 5 vjet, pra për 60 muaj, ju do të keni përfituar një të ardhur shtesë



*Një zgjedhje e zgjuar
financiare mund t'ju
sjellë perfitime të mëdha.*

prej $30,000 \times 60 = 1,800,000$ lekë, të cilën mund ta kishit kursyer ose konsumuar, duke përmirësuar cilësinë e jetesës tuaj. Në rast se do ta kishit kursyer, vlera e kursimeve tuaja do të ishte rritur edhe me 1.8 milionë lekë të tjera, përveç rritjes me 4 milionë nga rritja e vlerës së apartamentit. Gjithsej, kursimet tuaja do të rriteshin me $1.8 + 4 = 5.8$ milionë lekë.

Në një vend në zhvillim si Shqipëria, investimi në pasuri të paluajtshme ka qenë shumë fitimprurës vitet e fundit. Por, në përgjithësi, duhet të keni parasysh se vlera e pasurive të paluajtshme nuk rritet gjithmonë. Ka periudha kur vlera e pasurive të paluajtshme është në rënie. Prandaj, investimi në pasuri të paluajtshme duhet menduar me kujdes. Ai mund të ofrojë rritje të shpejtë dhe të madhe të kursimeve tuaja, por nga ana tjetër ekziston edhe rreziku që ju të mos fitoni asgjë apo edhe të humbisni një pjesë të tyre.

Shembull 4: Investim jo shumë fitimprurës në pasuri të paluajtshme

Në vazhdim të shembullit të mësipërm të investimit në pasuri të paluajtshme, supozoni se vlera e banesave në zonën ku ju bletë apartamentin nuk rritet gjatë 5 vjetëve. Vlera e kursimeve tuaja nuk ka ndryshuar. Edhe po të kishit kursyer të ardhurat nga qiraja e apartamentit, vlera e kursimeve tuaja do të ishte rritur me vetëm 1.8 milionë lekë. Investimi në depozitë do të kishte qenë një mundësi më e mirë për kursimet tuaja, duke ju ofruar një rritje me 2.7 milionë lekë për këto 5 vjet.

Investimi në tregun e pasurive të paluajtshme zakonisht ndërmerret nga konsumatorë mbi moshën 35-40 vjeç, të cilët kanë grumbulluar një sasi të mjaftueshme kursimesh dhe dëshirojnë të rrisin shpejt dhe shumë pasurinë e tyre. Por, ky



Gjatë investimit të kursimeve duhet të tregoheni të kujdesshëm në zgjedhjet që bëni.

investim është gjithashtu i rrezikshëm dhe nuk duhet kryer pa patur njohuri të mira mbi tregun e pasurive të paluajtshme apo pa u këshilluar me specialistë të këtij tregu.

HAPËSIRË INFORMUESE:

Alternativa të tjera të investimit të kursimeve tuaja

Shqipëria është një vend në zhvillim dhe si i tillë ofron mundësi të shumta për të bërë biznes, por pak alternativa për të investuar kursimet tuaja.

Në vendet e zhvilluara është shumë i përhapur investimi në letra me vlerë apo tituj të kompanive shtetërore e private. Nëpërmjet blerjes së tyre, konsumatorët i japin borxh ose bëhen bashkëpronarë të këtyre kompanive. Blerësit e letrave me vlerë përfitojnë në këmbim, përveç parave që kanë investuar edhe interesin ose një të ardhur të ngjashme me të. Këto mundësi investimi mund të jenë shumë fitimprurëse, por edhe rreziku që investitorët të humbasin një pjesë të kursimeve mund të jetë i lartë. Investime të tilla kërkojnë njohuri të thella mbi financat, të cilat jo çdokush mund t'i zotërojë. Për këtë arsye, shumë konsumatorë të thjeshtë mund t'ua besojnë kursimet e tyre një kompanie të specializuar në investimin e kursimeve, me një normë të kënaqshme interesi duke mënjeluar edhe humbjet e mundshme nga mungesa e njohurive.

D. Plani individual (privat) i pensionit

Ju jeni shumë të rinj për të menduar për moshën e pensionit. Por ndoshta keni dëgjuar prindërit apo të afërmit “të bëjnë llogari” se si mund të sigurojnë një të ardhur tjetër, përveç pensionit shtetëror në moshën e artë. Pas shumë vitesh punë

e lodhje, çdokush e meriton të kalojë një pleqëri financiarisht të sigurt dhe pse jo, ta kënaqë veten duke shijuar udhëtime në vendet e preferuara. Por, për të realizuar këtë, duhet të kurseni dhe t'i investoni kursimet tuaja, me një normë të mirë interesi dhe në mënyrë të sigurt. Se si realizohet kjo, do ta mësoni në një mësim të veçantë, atë të planeve individuale të pensionit.


Diversifikimi i investimeve

Një fjalë e urtë popullore thotë: “Mos i vër të gjitha vezët në një shportë!” Kjo urtësi popullore gjen zbatim edhe në fushën e investimit. Më sipër u njohët me depozitat bankare, bonot e thesarit, investimin në pasuri të paluajtshme apo në plane pensioni dhe me alternativa të tjera të investimit të kursimeve, që ndoshta aktualisht në Shqipëri nuk ekzistojnë, por që me kalimin e kohës do të jenë të pranishme. Me kaq sa keni mësuar, duhet të keni kuptuar se çdo investim shoqërohet, përveç se me normën e interesit, edhe me një shkallë të caktuar rreziku për të humbur një pjesë të vlerës së kursimeve. Kështu, çmimet e pasurive të paluajtshme mund të bien, bankat apo shoqëritë e fondeve të pensionit mund të falimentojnë dhe për rrjedhojë, ju mund të humbni kursimet. Për ta shmangur këtë, një këshillë e fundit do të ishte *diversifikimi* i investimeve tuaja.

Diversifikimi i investimeve është shpërndarja e kursimeve në alternativa të ndryshme investimi.

Një fjalë e urtë popullore thotë: “Mos i vër të gjitha vezët në një shportë!”.

Kjo mund t'ju kujtojë lojën televizive “100 milionë”, ku lojtari që nuk është i sigurt për përgjigjen, e ndan shumën në dispozicion midis disa përgjigjeve, për të mos rrezikuar ta humbasë të gjithën.



PYETJE ?

- 1. Listoni forma të ndryshme të investimit të kursimeve. Renditini ato sipas aftësisë për të rritur kursimet. Renditini ato sipas nivelit të sigurisë që ofrojnë për kursimet tuaja.*
- 2. Arsyetoni se sa lloje depozitash kemi në sistemin bankar? Cila është forma e preferuar për ju? Pse?*
- 3. Çfarë janë bonot e thesarit? Pse janë një alternativë më tërheqëse në krahasim me depozitat bankare?*
- 4. Njihuni me informacionin në broshurën e Bankës së Shqipërisë mbi bonot e thesarit. Diskutoni në grupe mbi këtë formë investimi.*
- 5. Cilat janë avantazhet dhe disavantazhet e investimit të kursimeve në pasuri të paluajtshme?*
- 6. Cilat janë dy mënyrat me anë të të cilave investimi në pasuri të paluajtshme ndikon në vlerën e kursimeve tuaja?*
- 7. Çfarë është diversifikimi i investimeve? Çfarë arrijmë nëpërmjet tij?*

Detyra

- 1. Duke përdorur informacionin e dhënë në tabelën në f.110 llogarisni interesin e fituar dhe vlerën në fund të afatit të maturimit, të depozitave me afat 1-mujor, 6-mujor, 12-mujor dhe 36-mujor, për një shumë prej 20,000 lekësh.*

Lloji i depozitës		Depozita me afat						
Afati	1- muajor	3- muajor	6- muajor	12- muajor	24- muajor	36- muajor	48- muajor	60- muajor
Norma e interesit	4.00%	4.20%	4.50%	5.00%	6.00%	7.00%	8.00%	9.00%

2. Prindërit tuaj kanë arritur të kursejnë 5 milionë lekë. Ata i investojnë ato në blerjen e një dyqani në qendër të qytetit, të cilin e japin me qira për 40 mijë lekë në muaj. Alternativa tjetër është investimi në një depozitë me afat maturimi 1-vjeçar, me një normë interesi vjetore prej 5%. Pas 2 vjetësh, vlera me të cilën dyqani mund të shitet është 8 milionë lekë.

a. Llogarisni vlerën e kursimeve të prindërve tuaj pas 2 vjetësh, duke supozuar se vlera e dyqanit nuk ka ndryshuar dhe të ardhurat nga qiraja janë konsumuar.

b. Llogarisni vlerën e kursimeve të prindërve tuaj pas 2 vjetësh, duke supozuar se vlera e dyqanit nuk ka ndryshuar dhe të ardhurat nga qiraja janë kursyer.

c. Llogarisni vlerën në fund të 2 viteve nëse kursimet nuk do të ishin përdorur për blerjen e dyqanit, por do të ishin depozituar në depozitën bankare.

d. Si krahasohet vlera e kursimeve në pikën c me vlerat e llogaritura në pikat a dhe b?

e. Supozoni se 2 vjet pas blerjes, dyqani ka një vlerë prej 4 milionë lekësh. Në periferi të qytetit është hapur një qendër e madhe tregtare dhe zona e qendrës nuk preferohet për të bërë blerje. Llogarisni edhe një herë kërkesën në pikat a dhe b. Si krahasohen ato me vlerën e kursimeve në pikën c?

f. Çfarë mesazhi marrim nga ushtrimi i mësipërm?

9. KREDIA

E mbani mend herën e fundit që keni blerë diçka për veten tuaj? Për ta blerë, keni përdorur kursimet tuaja. Por, në momentin që do të mbaroni shkollën e do të filloni një punë, mund të merrni kredi për të blerë sendet që dëshironi apo ndoshta edhe për të bërë disa ditë pushime. Ju mund t'i merrni paratë që ju nevojiten edhe nga prindërit, qoftë edhe me të drejtën për t'ua kthyer atyre një ditë. Por, nuk ju duket se ata kanë bërë mjaft për ju tashmë? Për më tepër, duhet të mësoni se si të administroni vetë financat tuaja.

Kredia është një shumë parash e marrë hua nga një individ apo institucion, me premtimin dhe/ose detyrimin për ta kthyer atë së bashku me interesin, brenda një afati të caktuar.

Shuma e parave të marra hua quhet **kryegjë** (ky term njihet gjerësisht edhe si principal, nga anglishtja). **Interesi**, së bashku me komisionet dhe shpenzimet e transaksionit, është kostoja e kredisë ose shuma e parave që paguani në këmbim të përdorimit të parave të tjerëve. **Afati i kredisë ose afati i shlyerjes** është periudha kohore gjatë së cilës duhet të keni shlyer të gjithë kryegjënë së bashku me interesin.

Kur merrni kredi, ju “hyni në borxh”. Ndoshta mund të merrni hua nga miq, familjarë, njerëz të njohur e të panjohur, por gjëja më e këshillueshme që mund të bëni, është ta merrni nga institucionet e specializuara për këtë punë: bankat dhe institucionet e tjera të kreditit (rifreskoni njohuritë mbi bankat dhe institucionet e tjera kredidhënese të marra në mësimin mbi sistemin financiar).



Afati i shlyerjes është një ndër elementët kryesorë të kredisë.

Llojet e kredisë janë të shumta. Secila prej tyre përdoret për qëllime të ndryshme, por parimi mbi të cilin ato funksionojnë është i njëjtë: ju shfrytëzoni TANI një shumë parash të cilën nuk e dispononi dhe e ktheni MË VONË. Në pamje të parë duket me shumë leverdi, por mos harroni: në ekonominë e tregut, nuk të jep njeri asgjë falas.

Nëse nuk e përdorni me kujdes kredinë, mund të hyni në shumë telashe. Prandaj, është e rëndësishme të kuptoni se si ta administroni kredinë, në mënyrë që t'i vilni përfitimet dhe të minimizoni kostot.

Çmimi i kredisë – interesi

Sa më e lartë norma e interesit, aq më shumë para paguani për përdorimin e kredisë!!!

Nëse interesi vepron në të mirën tuaj kur investoni, kur merrni kredi interesi është kundër jush. Në grafikun në vijim djathtas krahasohen 3 kredi, secila prej 100,000 lekësh, për t'u kthyer me pagesa mujore për 5 vjet. E para ka një normë interesi 7%, e dyta 13% dhe e treta 18%. Interesi total që i keni paguar bankës në këto 5 vjet rritet me rritjen e normës së interesit (ilustruar në grafik).


Afati i shlyerjes

Si norma e interesit edhe afati i shlyerjes, veprojnë kundër jush në koston e një kredie: sa më i gjatë afati i shlyerjes, aq më i madh është interesi total që do të paguani gjatë kohëzgjatjes së kredisë! Madje, efekti i zgjatjes së afatit është edhe më i ndjeshëm sesa ai i rritjes së normës së interesit. E shohim këtë nëpërmjet një shembulli. Mund të marrim një kredi prej 100,000 lekësh, me një normë



Sa më e lartë norma e interesit, aq më shumë para paguani për përdorimin e kredisë!

interesi 8% në vit dhe kemi 3 mundësi zgjedhjeje për afatin e shlyerjes: 5 vjet, 10 vjet dhe 20 vjet. Siç e shihni nga grafiku poshtë djathtas, interesi total është më i madh se kryegjësja kur afati është 10 vjet, dhe është 3.8 herë më i madh se kryegjësja kur afati i shlyerjes është 20 vjet.



Kosto të tjera të kredisë

Përveç interesit, kredia ka elemente të tjera, të cilat e rrisin koston e saj. Këto elemente janë: komisioni i disbursimit, komisioni i shlyerjes së parakohshme dhe kostoja e mirëmbajtjes së llogarisë.

Komisioni i disbursimit është një komision i cili paguhet nga personi që merr kredinë, në momentin e dhënies së kredisë. Momenti quhet ndryshe edhe momenti i disbursimit. Komisioni është në përqindje të shumës së kredisë dhe zakonisht varion nga 0%-5%.

Ju mund të vendosni të ktheni kredinë e marrë përpara afatit, pra ta shlyeni atë para kohe. Në këtë rast, banka mund t'ju kërkojë të paguani një komision, **komisionin e shlyerjes së parakohshme**. Ai shprehet në përqindje të vlerës së mbetur të paslyer të kredisë.

Përfitimet nga përdorimi i kredisë

Pasi përmendëm kostot që shoqërojnë marrjen e një kredie, natyrshëm ju mund të pyesni: ku qëndron leverdia e marrjes së një kredie?

Si në shumë gjëra të tjera në jetë, kjo varet nga situata juaj. Kredia mund të jetë një mjet shumë i mirë për të përmirësuar kushtet e jetesës, por kjo vetëm nëse i keni bërë mirë llogaritë dhe e përdorni atë në mënyrë të përgjegjshme.

Një ndër përparësitë e kredisë është financimi i menjëhershëm i blerjeve të mëdha. Me të mbaruar shkollën dhe filluar punën, ju mund të dëshironi të largoheni nga shtëpia e prindërve. Këtë mund ta zgjidhni duke marrë një shtëpi me qira, vetëm apo me dikë tjetër. Por, do të ishte gjithashtu shumë bukur nëse ju do të mund të blinit një shtëpi tuajën. Në qoftë se do të vendosni të kurseni për të blerë një shtëpi, do t'ju duhen shumë vite për të kursyer shumën e nevojshme. Ndoshta, gjatë viteve, do të neglizhoni planin e kursimit e do t'i shpenzoni një pjesë të parave për konsum. Përdorimi i kredisë në këtë rast ju mundëson blerjen e shtëpisë tani, ndërkohë që kredinë së bashku me interesat i paguani në vitet në vazhdim.

Në përgjithësi, kredia është një mjet i dobishëm nëse ju e përdorni atë për investime apo konsum afatgjatë (mobilim, blerje makine, elektroshtëpiake), por jo për konsum afatshkurtër (pushime, veshje). Përdorimi i kredisë për blerjen e një apartamenti apo një makine, për rikonstruksionin e banesës tuaj të vjetër, për rinovimin e mobilieve e të tjera si këto, është një përdorim i përgjegjshëm i kredisë. Ndërkohë, të marrësh kredi për të bërë pushime apo për të ndërruar garderobën, mund të duket shumë tërheqëse, por nuk është një vendim i zgjuar financiar. Shumë shpejt do të dëshironi të bëni pushime të tjera, të



Mos ëndërroni shumë...

blini veshje të reja dhe kështu rrezikoni ta gjeni veten të zhytur në borxhe.

Regjistri i Kredive

Në mënyrë që bankat të marrin vendime sa më të sakta për dhënien e kredive ato konsultohen me Regjistrin e Kredive. Ky regjistër është një bazë me informacione dhe të dhëna ku paraqiten të gjitha detyrimet financiare të personave që aplikojnë për kredi. Për më shumë informacion mbi Regjistrin e Kredive klikoni në adresën:

http://www.bankofalbania.org/web/regjistri_i_kredive_3306_1.php

Llojet e kredisë

Në reklama të ndryshme mund të dëgjoni për një shumëllojshmëri kredisë, por në vija të përgjithshme kreditë për individë apo familje ndahen në: kredi personale (ose konsumatore) dhe kredi për shtëpi (ose hipotekare).

Kredia personale (ose konsumatore)

Nëse ju duhet një kredi për të blerë një makinë, një kompjuter të ri, një televizor apo për të bërë një master, për të shkuar për pushime, ju mund të aplikoni për të marrë një kredi personale. Kredia personale ka të përcaktuar kryegjënë, normën e interesit dhe afatin e shlyerjes. Për të shlyer kredinë personale ju bëni pagesa të rregullta, zakonisht mujore, të cilat quhen **këste** të kredisë. Një këst përbëhet nga dy pjesë: njëra pjesë është kryegjëja dhe tjetra interesi i kredisë.



... rrezikoni ta gjeni veten të zhytur në borxhe.

Afati i shlyerjes është i shkurtër rreth 1-2 vjet, por në raste të veçanta mund të shkojë deri në 7 vjet.

Kredia për shtëpi (ose hipotekare)

Mënyra e funksionimit të kredisë për shtëpi është e ngjashme me atë të kredisë personale, por shuma maksimale që mund të përfitoni është mjaft më e madhe, afati i shlyerjes së saj është ndjeshëm më i gjatë dhe shkon deri në 30 vjet. Gjithashtu, në këmbim të marrjes së kredisë për shtëpi, ju duhet të vendosni një pasuri të paluajtshme si garanci në emër të bankës, të quajtur **kolateral**. Kolaterali shërben për të garantuar bankën që do ta shlyeni kredinë. Zakonisht, nëse merrni një kredi për të blerë shtëpi, shtëpia që blini vendoset si kolateral. Në rast se nuk do të shlyeni dot kredinë e marrë, banka e shet kolateralin dhe me të ardhurat nga shitja e tij mbyll detyrimin tuaj ndaj bankës.

Meqenëse, kredia për shtëpi është e siguruar nëpërmjet kolateralit edhe normat e interesit janë të ulëta. Në fakt, kredia për shtëpi është lloji i kredisë me normat më të ulëta të interesit.


Edhe në rastin e kredisë për shtëpi, ju duhet të paguani pranë bankës këstet e rregullta mujore të kredisë, që përbëhen nga kryegjëja dhe interesi i kredisë.

Po si mund të aplikojmë për një kredi? Çfarë dokumentesh na nevojiten? A është e nevojshme të kemi një kolateral për të garantuar kredinë? Të gjitha këto pyetje marrin përgjigje në skemën pasardhëse.

Një nga llojet e kredisë personale është edhe ajo e marrë për blerjen e një makine.



Hapat për marrjen e një kredie



Dosja me dokumente shqyrtohet nga banka dhe merret vendimi për të dhënë apo jo kredinë. Ky vendim varet kryesisht nga:

- Aftësia juaj për të paguar kredinë (mjaftueshmëria e të ardhurave tuaja)
- Historia juaj si kredimarrës (e marrë nga Regjistri i Kredive)
- Cilësia e kolateralit (në rast se është i nevojshëm)

Norma efektive e interesit

Kujdes! Është e rëndësishme që si klient të njihni normën efektive të interesit ose koston apo shumën totale për t'u paguar, në mënyrë që të jeni në gjendje të vlerësoni zgjedhjen e produktit bankar.

Norma efektive e interesit (shkurt: NEI) përfshin të gjitha pagesat e detyrueshme për kredimarrësin, që kërkon banka për dhënien e kredisë. Këtu futen interesi, komisionet e kredisë, komisionet e mirëmbajtjes së llogarisë. Për këtë arsye, kjo normë ka të ngjarë të jetë më e lartë se norma e deklaruar e kredisë. Ajo shprehet në përqindje vjetore të vlerës së kredisë. Njohja e vlerës së saj e bën më të lehtë krahasimin e kushteve të kredive të ofruara nga banka të ndryshme.

Të drejtat dhe detyrimet tuaja

Kur merrni një kredi, ju bini dakord të respektoni kushtet e përcaktuara në kontratën e kredisë: ju merrni përsipër të paguani **kryegjënë** dhe **interesin**, brenda **një afati të caktuar**. Përpara se të firmosni kontratën, lexoni me vëmendje të drejtat dhe detyrimet tuaja, si dhe kushtet e kredisë: normën e interesit, afatin e shlyerjes, periodicitetin e kësteve dhe të gjitha komisionet e tjera bankare.

PYETJE ?

1. Përshkruani se çfarë është kredia? Cilat janë elementet kryesore të saj?
2. Arsyejtoni nëse përdorimi i kredisë është një vendim i mirë apo i keq financiar? Jepni shembuj të ndryshëm për secilin qëndrim.
3. Cilat janë kostot e marrjes së kredisë?
4. Cilat janë përparësitë e përdorimit të kredisë?
5. Si ndikon rritja dhe ulja e normës së interesit në shumën totale të interesit që ju do të paguani gjatë shlyerjes së kredisë? Po zgjatja e afatit të shlyerjes?
6. Cilat janë llojet e ndryshme të kredisë?

Detyrë

Nga faqet e internetit apo nga broshurat e bankave të nivelit të dytë, mundohuni të gjeni kushtet me të cilat banka të ndryshme japin kredi personale prej 200,000 lekësh. Mblidhni informacionin dhe plotësoni tabelën e mëposhtme. Krahasoni bankat mes tyre. Cila ofron kushtet më të mira?

Kushtet	Banka 1	Banka 2	Banka 3	Banka 4	Banka 5
Norma e interesit					
Afati i maturimit					
Kësti					
Komision disbursimi					
Komision shlyerjeje e parakohshme					
Komisione të tjera					

10. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONSUMATORIT

Përse duhet të ndërjegjësohemi si konsumatorë?

Çdo ditë, të gjithë ne dashur pa dashur marrim pjesë në funksionimin e ekonomisë. Blerja e një buke ose e një sendi me një vlerë të vogël, në vetvete është një marrëdhënie tregtare që ne lidhim çdo ditë me personin që na shet bukën apo sendin e çfarëdoshëm. Në pjesën më të madhe të këtyre shkëmbimeve ne jemi ajo palë e kësaj “kontrate” që ka nevojë për mallra dhe shërbime sepse nuk i prodhon ose ofron dot vetë, ndërsa përballë qëndron pala “profesioniste”, ajo që është e aftë të prodhojë dhe të ofrojë atë shërbim për të cilin kemi nevojë. Ne jemi konsumatorët, ndërsa pala tjetër janë tregtarët profesionistë.

Pra, **konsumator** është çdo person, i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave personale, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit.

Konsumatori nuk është i pranishëm në çastin e prodhimit dhe të shpërndarjes së produkteve që blen. Duke patur parasysh se konsumatori është palë e dobët, pikërisht sepse ndodhet në pamundësi për të kontrolluar llojin dhe cilësinë e produkteve, ai duhet të mbrohet nga çdo problem që mund të lidhet me këto produkte. Problemi bëhet akoma më i vështirë duke patur parasysh qarkullimin më të gjerë dhe të lirë të mallrave jo vetëm në Evropë, por në tregje të tjera të cilat janë problematike pasi nuk kontrollohen nga organet kompetente.



Konsumator është çdo person, i cili blen ose përdor mallra apo shërbime për plotësimin e nevojave personale.

Në këto kushte, roli i shtetit është shumë i rëndësishëm: nëpërmjet organeve të tij (Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit², Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit³, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si dhe Inspektoratet që veprojnë në terren), ai kontrollon cilësinë e prodhimeve dhe shërbimeve të vëna në shitje, kontrollon klauzolat e kontratave të lidhura me konsumatorët, që të mos jenë abuzive kundër tyre si dhe mbikëqyr informacionin e nevojshëm që prodhuesi ose furnizuesi (profesionisti) duhet t'i paraqesë konsumatorit. Kjo bëhet që konsumatori të jetë i informuar për mallin që blen, pasi ai jo vetëm shpenzon para për ta blerë, por dhe mund të vërë në rrezik shëndetin e tij nëse malli është i dëmshëm.

Më poshtë janë renditur disa nga detyrimet kryesore që rëndojnë mbi profesionistët, të cilat në të njëjtën kohë, përbëjnë dhe të drejtat që gëzon konsumatori:

- Të informohet në lidhje me përbërjen e mallit dhe me detyrimet kontraktuale (këtu përfshihet dhe etiketimi i produktit, ku duhet të shënohet emërtimi i tij, sasia, cilësia, prejdardhja, shpërndarësi dhe përbërja etj.);
- Të tregohet çmimi i saktë;
- Të pajiset me faturë tatimore (është një detyrim i ri ligjor, por shumë i rëndësishëm, sepse lidhet edhe me të drejtën për ta kthyer mbrapsht produktin e dëmtuar ose të dëmshëm);
- Të dhënat të jenë në gjuhën shqipe;
- Publiciteti duhet të jetë i saktë. Publiciteti krahasues lejohet por nuk duhet të jetë denigrues dhe i pavërtetë;
- Kushtet e kontratave nuk duhet të jenë abuzive në dëm të konsumatorit.

² Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit <http://www.kmk.al/>

³ Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit në adresën www.konsumatori.org.



Çdo produkt i tregtuar në Shqipëri duhet të ketë të dhëna në gjuhën shqipe.

Përveç rolit aktiv që duhet të luajë shteti dhe institucionet e tij, ai duhet të punojë për rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorit, pasi jo çdo herë shteti dhe institucionet publike janë të pranishëm aty ku nuk respektohen të drejtat e konsumatorëve. Ndërgjegjësimi fillon nga informimi i konsumatorëve për shërbimet që përfitojnë, kushtet e tyre, cilësinë si dhe mënyrat e procedurat përkatëse të ankimimit në rast të shfaqjes së problemeve në lidhje me to. Vlen të theksohet se një informacion i plotë, i shoqëruar me një edukatë financiare, ndihmon secilin prej nesh të bëjë zgjedhje më të mira të produkteve që i nevojiten, si dhe të mbrohet më mirë në rastet problematike që mund të shfaqen.

Ç'është mbrojtja e konsumatorit të produkteve dhe shërbimeve financiare?

Bankat dhe institucionet financiare nuk ndryshojnë shumë nga bizneset e tjera. Me produktet dhe shërbimet që ato ofrojnë, ndikojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e disa kërkesave të secilit prej nesh, kundrejt fitimit të tyre si biznes. Në këtë marrëdhënie, të dyja palët kanë si objektiv përfundimtar fitimin, dhe nëse ato nuk janë të qarta lidhur me të drejtat dhe detyrimet e njëri-tjetrit, më vonë mund të ndeshin në konflikte.

Megjithatë, mos u trembni dhe mos e shikoni veten si miushin që përballet me luanin. Në vendin tonë ka një kuadër të zgjeruar ligjor për mbrojtjen e interesave të konsumatorit. Ky kuadër ligjor synon një mbrojtje të efektshme të konsumatorit. Për të siguruar mbrojtjen e tij, konsumatori ka disa të drejta, të cilat përkthehen në detyrime për ofruesit e shërbimeve të ndryshme. Mbrojtja e konsumatorit konsiston në rregulla dhe në autoritete përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë.

Shteti është kontrollori i cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve të vëna në shitje.



Autoritetet që rregullojnë dhe mbikëqyrin pjesë të caktuara të tregut financiar (me të cilat u njohëm në mësimet e mëparshme), janë njëkohësisht përgjegjëse edhe për mbrojtjen e konsumatorit të këtyre produkteve.

Disa këshilla

Libri që mbani në duar ka si fokus financat personale. Për këtë arsye, dëshirojmë të veçojmë disa këshilla mbi sjelljen tuaj si konsumator financiar dhe marrëdhënien tuaj me bankat.

➤ **Krahasoni ofertat e bankave të ndryshme!**

Përpara se të zgjidhni të merrni një kredi apo të investoni kursimet tuaja, mos shkoni në bankën e parë që ju del përpara. Trokisni në disa banka dhe krahasoni ofertat e marra.

➤ **Lexoni përpara se të firmosni!**

Mos u nxitoni të firmosni gjithçka që ju vihet përpara. Tregohuni të kujdesshëm dhe lexoni mirë çka shkruhet në kontratën që ju lidh me bankën për çdo produkt që zgjidhni.

➤ **Lexoni njoftimet e vendosura në ATM!**

Përpara se të përdorni ATM-në ose POS-in e një banke tjetër, lexoni njoftimin.

➤ **Mbani evidenca!**

Ju duhet t'i ruani dokumentet shoqëruese të transaksioneve bankare që kryeni, në mënyrë që, nëse diçka shkon keq, të keni fakte mbështetëse.

➤ **Mos ngurrioni të pyesni!**

Sa herë që ju lindin dyshime mbi lëvizje në llogarinë

tuaj, sa herë që balancat nuk korrespondojnë me atë çfarë ju prisnit apo nëse mendoni se ka ndryshime në normat e interesit, mos nguroni të pyesni mbi gjërat që nuk i kuptoni. Banka është e detyruar t'ju përgjigjet.

➤ **Shprehni ankesat tuaja!**

Nëse personi të cilit i drejtoheni nuk është përgjegjës për t'ju përgjigjur, kërkoni të flisni me eprorin e tij. Ju mund të ankoheni për pakënaqësitë tuaja dhe të kërkoni rishikimin e praktikës tuaj.

➤ **Këshilloni prindërit tuaj!**

Në përfundim të këtij moduli, do ta ndjeni veten më të sigurt në marrëdhënien tuaj me bankat dhe institucionet e tjera që ofrojnë produkte financiare. Ndajini me prindërit këto njohuri dhe do të shikoni se në këtë mënyrë do të përfitojnë edhe ata.

PYETJE?

1. Çfarë do të thotë të jesh konsumator?
2. Cilat janë institucionet kryesore, të cilat kujdesen për mbrojtjen e konsumatorit?
3. Gjeni në internet faqet e tyre zyrtare dhe sillni në klasë pjesë nga funksionet e secilit prej tyre.
4. Cilat janë tre këshillat më të vlefshme që do t'i jepnit një mikut tuaj, përpara se t'i drejtohet një institucioni financiar?

FJALOR

Faturë tatimore – dokument që vërteton kryerjen e një veprimtarie tregtare dhe që përfshin edhe përlogaritjet e detyrimit tatimor. Fatura tatimore përmban numrin rendor dhe numrin personal të identifikimit të tatimpaguesit, datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe adresën e palëve, datën e realizimit të shitjes ose shërbimit, emërtimin e saktë të tij, sasinë, çmimin e plotë të shitjes, si dhe rritjet ose zbritjet e zbatuara për shumat e shënuara.

Detyrim kontraktual – detyrim që u lind palëve të përfshira në një kontratë apo marrëveshje, me nënshkrimin e kësaj të fundit.

11. PLANET INDIVIDUALE TË PENSIONIT

Planet individuale të pensionit s'janë gjë tjetër veçse kontrata që parashikojnë derdhjen e kontributeve periodike dhe tërheqjen e shumës së grumbulluar të parave bashkë me interesat e fituara në një moment të dytë. Veçori e planeve të pensioneve është derdhja e kontributeve në mënyrë periodike (për shembull, çdo muaj) për një periudhë shumëvjeçare kohe. Pas shumë viteve, kur individi del në pension apo kur për shkak të një aksidenti, nuk është më në gjendje të punojë, ai gëzon të drejtën për të tërhequr shumën e kontributeve së bashku me interesat që ato kanë fituar.

Subjektet e përfshira në një plan individual pensioni janë promovuesi, pjesëmarrësi dhe përfituesi.



Promovuesi i planit - është kompania që reklamon dhe ofron pjesëmarrjen në planin e pensionit. Në rastin e planit individual të pensionit, promovues është një subjekt me karakter financiar (institucione kredituese, kompani sigurimi, fond privat i pensionit).

Pjesëmarrësi - është personi që kryen derdhjet e kontributeve, me qëllim përfitimin e pensionit shtesë në të ardhmen.

Përfituesi – është personi që ka të drejtën të gëzojë përfitimet e planit. Ai mund të jetë vetë pjesëmarrës i planit ose një person i tretë, i cili trashëgon përfitimet e planit në rast të vdekjes së pjesëmarrësit.

Planet individuale të pensionit janë një mundësi shumë e mirë për të grumbulluar kursime në afat të gjatë dhe për të siguruar një të ardhur të kënaqshme në përfundim të moshës së punës.

Përparësitë kryesore të këtyre planeve janë:

- Një mënyrë e mirë kursimi nëpërmjet disiplinimit

Duke u angazhuar të hiqni mënjane një shumë të vogël çdo muaj apo çdo disa muaj, në afat të gjatë, ju do të arrini të kurseni një shumë jo të vogël, pa hequr dorë nga konsumimi gjatë jetës suaj.

- Mundësia për të fituar interes të lartë mbi kontributet e derdhura

Kontributet tuaja mbledhen dhe investohen nga kompani të specializuara financiare, të cilat janë të afta të gjejnë mënyrën më fitimprurëse për t'i investuar ato. Përveç kësaj, këto kontribute zakonisht investohen për një periudhë të gjatë kohe, dhe normat e interesit janë më të larta kur paratë “ngurtësohen” për një afat kohor të gjatë. Gjithashtu, kompanitë financiare që merren me investimin e tyre, mbledhin kontributet e mijëra individëve të tjerë. Sa më e madhe të jetë shuma që kanë këto kompani në dispozicion për të investuar, aq më e madhe është edhe mundësia që ato të negociojnë një normë të mirë interesi për investimin e tyre. Këto kompani i investojnë fondet e mbledhura në letra me vlerë të qeverisë, por mund t'i investojnë edhe jashtë vendit, nëse arrijnë të sigurojnë një normë të mirë interesi kundrejt një rreziku të ulët të humbjes së tyre.



Planet individuale të pensionit janë një mundësi shumë e mirë për të grumbulluar kursime në afat të gjatë.

- Investimi i kontributeve shoqërohet me rrezik shumë të ulët të humbjes së kursimeve

Përveç se mund të sigurojnë një normë të mirë interesi për kontributet e mbledhura, kompanitë financiare në rolin e promovuesit zotërojnë njohuri të mira në fushën e financës, që iu mundëson të minimizojnë rrezikun e humbjes nga investime të pasigurta. Kjo arrihet edhe nëpërmjet teknikave të diversifikimit të investimeve.

Kontributet

Kontributet janë shuma e parave që derdhen periodikisht për planin individual të pensionit. Pjesëmarrësi gëzon shumë fleksibilitet në përcaktimin e shumës dhe të periodicitetit të derdhjes së kontributeve. Kjo ndodh për arsye se ky plan është i përshtatshëm për persona me mundësi ekonomike të ndryshme. Kështu, pjesëmarrësi derdh shumën e parapërcaktuar të kontributeve, në mënyrë periodike (muajore, tremujore etj.) përmes bankës, duke patur mundësinë të bëjë ndryshime sipas dëshirës.


Si funksionon skema e pensioneve?

Kontributet e derdhura nga pjesëmarrësi investohen nga promovuesi i planit dhe fitojnë interes. Në fund të periudhës së derdhjes së kontributeve, shuma e parave e grumbulluar në llogarinë e pjesëmarrësit do të jetë më e madhe se sa shuma e kontributeve, pasi ato kanë fituar interes gjatë kësaj periudhe. Interesi i fituar mund të jetë edhe më i madh sesa vetë shuma e kontributeve dhe kjo, për faktin që derdhja e kontributeve dhe investimi i tyre është bërë për një kohë të gjatë (kujtoni nga mësimi për investimet: sa më e gjatë periudha e investimit, aq më shumë interes fitoni).



Kontributet janë shuma e parave që derdhen periodikisht për planin individual të pensionit.

Kjo ilustron edhe nga figura e mëposhtme, e cila tregon fondet e grumbulluara nga kontribute prej 10,000 lekësh, të derdhura çdo muaj, për 20 vjet. Norma e interesit është 7% në vit.



Shuma e kontributeve të derdhura është 2.4 milionë lekë (10,000 x 12muaj/vit x 20 vjet). Interesi total që është grumbulluar në llogari nga investimi i kontributeve të përmuajshme është afërsisht 2.81 milionë lekë⁴. Në total, në fund të 20 viteve, pjesëmarrësi do të ketë në llogarinë e tij 5.21 milionë lekë (2.4 milionë kontribute + 2.81 milionë interesa).

Rastet e përfitimit

Objektivi i planeve të pensionit është që të sigurohet një shumë parash në afat të gjatë për të patur një të ardhur në rastet e mëposhtme:

- Daljes në pension;

⁴ Llogaritjet e interesit në rastin e derdhjes së kësteve/kontributeve dhe të tërheqjes së përfitimeve të pensionit janë të ndërlikuara dhe studimi i tyre shkon përtej qëllimit të këtij teksti. Prandaj, këtu po japim drejtpërdrejt rezultatet e llogaritjeve, me qëllim ilustrimin me shembuj të teorisë.

- Paaftësisë së parakohshme për të punuar (për shembull, në rast aksidenti);
- Vdekjes së pjesëmarrësit (në këtë rast, përfituesi i të ardhurave është një i afërt i pjesëmarrësit (bashkëshorti/ja, fëmijët etj.).

Përfitimet

Përfitimet e planeve të pensionit janë monetare dhe mund të tërhiqen të gjitha përnjëherë (me një këst) ose me disa këste.


Tërheqja me një pagesë të vetme

Vazhdojmë me shembullin e mësipërm. Në fund të 20 viteve në llogarinë e pjesëmarrësit janë grumbulluar rreth 5.21 milionë lekë. Përfituesi mund t'i tërheqë ato të gjitha në mënyrë të menjëhershme.

Tërheqja me disa këste

Tërheqja me disa këste mund të jetë e rregullt ose jo. Nëse tërheqja është e rregullt, atëherë përfituesi merr një shumë fikse periodike. Në shembullin e mësipërm, supozojmë se përfituesi do të donte që paratë e grumbulluara prej 5.21 milionë lekësh t'i tërhiqte çdo muaj, në shuma të barabarta, për 25 vitet e ardhshme. Në këtë rast, ai do të përfitonte 300 (25 vjet x 12muaj/vit) pagesa të barabarta mujore prej 36,800 lekësh. Në figurën vijuese, tregohet se sa do të ishte vlera e pagesave periodike që do të përfitonte përfituesi, me frekuencë mujore dhe tremujore, në një hark kohor 15 vjet dhe 25 vjet.

Përfitimet nga planet individuale të pensionit mund të tërhiqen me një pagesë të vetme ose me disa këste.



Përveç këtyre dy skemave “të pastra” të tërheqjes së përfitimeve, përfituesi së bashku me promovuesin mund të krijojë shumë skema të tjera, të cilat i përshtaten më mirë nevojave të përfituesit.

PYETJE?

- 1. Çfarë janë planet individuale (ose private) të pensioneve? Cilat janë palët e përfshira në një plan individual pensioni?*
- 2. Arsyeoni se cilat janë përparësitë kryesore të planeve individuale të pensionit?*
- 3. Pse nëpërmjet pjesëmarrjes në një plan individual të pensionit ju mund të siguroni një rritje më të madhe të kursimeve tuaja kundrejt investimit të tyre nga vetë ju?*

4. Pse pjesëmarrja në një plan individual pensioni mundëson një mbrojtje më të mirë të kursimeve tuaja nga rreziku i humbjes së tyre?

12. SIGURIMET – NJË MËNYRË PËR TË KONTROLLUAR RREZIKUN

Sigurimet janë një nga ato argumentet që mund të na duken si shumë të mërzitshme, deri në momentin kur diçka shumë e papritur ndodh dhe ne e kuptojmë se vërtet na duhen. Deri në këtë moment ndoshta nuk ia keni ndër mend, pasi janë prindërit ata, të cilët kujdesen për pagimin e sigurimeve. Por, shumë shpejt mund të filloni të mendoni për të blerë një makinë për shembull, dhe pikërisht në atë moment do t'ju duhet të njiheni me botën e sigurimeve.

Çfarë janë sigurimet?

Thënë thjesht, të sigurohesh do të thotë të paguash një shumë të vogël parash çdo vit, në mënyrë që kur diçka e pakëndshme dhe e papritur ndodh, ju të mos jeni të detyruar të paguani një shumë të madhe parash për të riparuar dëmin e pësuar. Është si një *jastëk sigurie* që ju ndihmon të minimizoni koston e rreziqeve me të cilat mund të ndesheni në të ardhmen.

Ngjarjet e paparashikuara ndodhin çdo ditë dhe ato mund të shkojnë nga një aksident me makinë ose rrugor, tek një aksident në vendin e punës apo djegia e shtëpisë apo biznesit. Ndaj të gjitha ngjarjeve të mësipërme, por edhe ngjarjeve të tjerave, ju mund të siguroheni dhe të minimizoni kostot financiare që shoqërojnë ato. Për shembull, në rastin e dëmtimit të rëndë të makinës tuaj, nëpërmjet sigurimit të automjetit, kompania e sigurimit mund të paguajë për rregullimin e pjesshëm apo të plotë të saj.

Përpara se të njiheni më shumë me sigurimet, ju duhet të njiheni me konceptin e rrezikut. **Rreziku** është mundësia e ndodhjes/verifikimit të një ngjarjeje të papritur.



Ngjarjet e paparashikuara ndodhin çdo ditë.

Kontrolli i rrezikut përfshin të gjitha mënyrat me anë të të cilave ju mund të kontrolloni – minimizoni apo shmangni – humbjen financiare që mund të shoqërojë ngjarjen e papritur.

Si kontrollohet rreziku?

Ju keni 3 mënyra për të kontrolluar rrezikun:

-Ta shmangni rrezikun!

Të mos hipni kurrë në makinë, në mënyrë që të mos përfshiheni në një aksident me makinë ose të mos shkoni me pushime dimërore, në mënyrë që të mos rrezikoni të aksidentoheni duke bërë ski.

-Ta minimizoni rrezikun!

Të pajiseni më një sistem të mirë të mbrojtjes ndaj zjarrit për shtëpinë tuaj, në mënyrë që shtëpia juaj, edhe në rast të rënies së zjarrit, të dëmtohet sa më pak. Të mos flisni në celular duke i dhënë makinës, në mënyrë që të shmangni aksidentet nga humbja e vëmendjes.

-Të paguani dikë tjetër për të mbuluar rrezikun në të cilin ju përfshiheni!

Të kërkonti shërbimin e kompanive të sigurimit.

Karakteristika të procesit të sigurimit

Polica e sigurimit

Polica e sigurimit është kontrata e lidhur mes kompanisë së sigurimit dhe blerësit të sigurimit. Në të paraqiten detajet e marrëveshjes mes jush dhe kompanisë së sigurimit, si për shembull: kush është përfituesi i sigurimit, sa është shuma maksimale e kompensimit, cilat janë kushtet në të cilat kompania e sigurimit vendos të kompensojë, cilat janë rastet kur ajo nuk kompenzon të siguruarin për dëmin e ndodhur etj.



... minimizoni rrezikun!

Primi

Primi është pagesa periodike që ju i bëni kompanisë së sigurimit në këmbim të mbrojtjes që ju bën ajo nga humbjet në rast se ngjarja e papritur ndodh.

Kërkesa për kompensim

Në rast se ngjarja e papritur ndodh dhe ju jeni të siguar për të, duhet t'i dorëzoni kompanisë së sigurimit një kërkesë për kompensim, në mënyrë që të përfitoni kompensimin prej saj. Kompania e sigurimit do të vlerësojë kërkesën dhe do t'ju njoftojë në rast se kërkesa juaj është pranuar ose jo.

Kompensimi


Në rast se kërkesa juaj për kompensim është pranuar, ju do të përfitoni shumë finansiare për mbulimin e humbjes që ju ka ndodhur. Këtë shumë ju mund ta merrni të gjithën njëherësh ose me disa pagesa periodike.

Kompensimi maksimal

Përgjithësisht, policat e sigurimit kanë një kufi maksimal të shumës që mund t'ju paguajnë në rast të ndodhjes së ngjarjes së papritur (për shumën maksimale të kompensimit). Kjo do të thotë se, pavarësisht dëmit financiar që mund t'ju ndodhë, kompania e sigurimit nuk paguan më shumë se ky kufi maksimal. Siç mund ta mendoni edhe vetë, sa më e madhe është shuma e mbulimit maksimal, aq më i lartë është edhe primi që ju paguani.

Palët e përfshira në procesin e sigurimit

Në mënyrë që të kuptoni më mirë se si funksionon siguriimi ndaj rreziqeve, ju duhet të njiheni edhe me palët e përfshira në procesin e sigurimeve. Këto palë janë: kompania e sigurimit, blerësi i policës së sigurimit, i siguruari dhe përfituesi i sigurimit.



Policat e sigurimit kanë një kufi maksimal të shumës së kompensimit.

Kompania e sigurimit

Kompania e sigurimit është ajo që ofron shërbimin e sigurimit, pra është pala që merr përsipër të paguajë për dëmin financiar që shkaktohet nga ngjarja e papritur kundrejt primeve të paguara.

Blerësi i policës së sigurimit

Blerësi i policës së sigurimit është ai që blen policën e sigurimit, pra ai që paguan primet e sigurimit.

I siguruari

I siguruari është ai i cili mbrohet nga mundësia e ndodhjes së ngjarjes së papritur.

Përfituesi

Përfituesi i kompensimit është ai që përfiton kompensimin e përcaktuar në policën e sigurimit.

Në skemën më poshtë paraqiten të katërta palët e përmendura më sipër. Në shumicën e rasteve *I siguruari* dhe *Përfituesi* janë i njëjti person dhe në shumë raste të tjera, *Blerësi*, *I siguruari* dhe *Përfituesi* janë i njëjti person. Për ta kuptuar më mirë lidhjen midis palëve të mësipërme, shohim disa shembuj.



Shembulli 1: Blerësi, I siguruari dhe Përfituesi janë i njëjti person

Një shembull shumë i mirë i këtij rasti është sigurimi i makinës nga pronari i saj, që është njëkohësisht edhe ai që i jep makinës. Ai është *blerësi* i policës së sigurimit, është *personi i siguruar* në rast të ndodhjes së aksidentit me makinë, si dhe *përfituesi* i kompensimit të humbjes nga aksidenti.

Shembull 2: I siguruari dhe Përfituesi janë i njëjti person


Marrim shembullin e një sigurimi shëndetësor privat, të cilin një bankë e blen për të gjithë punonjësit e saj. Nëpërmjet kësaj police, mbulohen të gjitha kostot për ekzaminimin dhe trajtimin shëndetësor të punonjësve që preken nga sëmundje të rënda të papritura. *Blerësi* i policës është banka. *I siguruari* është çdo punonjës i kësaj banke, i cili është gjithashtu edhe *përfituesi* i kompensimit për shërbimin shëndetësor privat në rast se preket nga një sëmundje e rëndë dhe e papritur.

Shembull 3: Blerësi, I siguruari dhe Përfituesi janë persona të ndryshëm

Një shembull kur blerësi, i siguruari dhe përfituesi janë të ndryshëm është rasti i blerjes së policës së sigurimit të jetës nga një kompani për punonjësit e saj. Blerësi i policës është kompania, i siguruari është çdo punonjës i saj. Duke qenë se bëhet fjalë për sigurim jete, – për pagesën e një kompensimi financiar në rast të vdekjes së të siguarit – i siguruari përcakton një përfitues të këtij kompensimi, që mund të jetë një anëtar i familjes së tij ose një person tjetër i afërt me të.

Kompanitë e sigurimit në Shqipëri⁵

Në Shqipëri operojnë 11 kompani sigurimi, me kapital vendas dhe të huaj, të cilat ofrojnë një sërë shërbimesh në fushën e sigurimit.



Llojet e sigurimeve

Për të mbuluar llojet e ndryshme të humbjeve që individi ose biznesi mund të pësojë si rrjedhojë e ndodhjes së ngjarjeve të papritura, ekzistojnë edhe lloje të ndryshme sigurimesh. Më poshtë do të shikojmë ato më kryesoret.

➤ Sigurimi i makinës

Të pasurit një makinë përmban edhe rreziqet e veta. Makinat mund të shkaktojnë dëme tek makinat e tjera, tek njerëz të tjerë apo edhe pronat e tyre. Si shofer i makinës, ju jeni përgjegjës për dëmet që mund të shkaktoni kur jeni në timon. Ky është një rrezik i madh me të cilin duhet të përballeni veçanërisht në rast se

⁵ Shënim: të dhënat e përdorura në këtë mësim mbi kompanitë e sigurimit dhe llojet e sigurimeve të ofruara prej tyre i përkasin korrikut të vitit 2013.

pa dashje aksidentoni ose vrisni dikë. Dhe përveç dëmtimeve që mund të shkaktoni ju, ekziston edhe mundësia e vjedhjes së makinës apo dëmtimit të saj nga shkaqe natyrore. Për të mbuluar të gjitha këto rreziqe të mundshme ekziston sigurimi i makinës.

➤ **Sigurimi i jetës**

Sigurimi i jetës mbron personat të cilët varen financiarisht nga i siguruari, në rast të vdekjes së tij. Në rast se jeni beqar dhe asnjë nuk varet financiarisht prej jush mund të mos e keni të domosdoshme blerjen e sigurimit të jetës. Por, në momentin që keni familje dhe fatura të shumta për të paguar, mund të jetë e përshtatshme të mendoni për një sigurim jete. Në këtë mënyrë, personi/at përfitues të sigurimit të jetës tuaj, në rast fatkeqësie do të marrin një shumë parash që do t'i ndihmojë të përballojnë financiarisht jetën në mungesën tuaj.


➤ **Sigurimi i pronës**

Shpesh dëgjoni nëpër lajme për fatkeqësi të ndryshme natyrore apo edhe të shkaktuara me dashje apo pa dashje nga vetë njerëzit, si përmbytja e magazinave të një biznesi, djegia e një godine rezidenciale apo e zyrave të një biznesi, shkatërrimi i tyre nga tërmeti, vjedhja e sendeve të çmuara dhe veprave të artit të zotëruara nga një person, etj. Në të tilla raste, sigurimi i pasurisë mundëson përfitimin e një kompensimi të plotë ose të pjesshëm financiar për humbjet e shkaktuara nga këto ngjarje. Sigurimi i pronës përfshin sigurimin e shtëpive, dyqaneve, magazinave, zyrave apo objekteve të tjera, makinerive, pajisjeve, sendeve të çmuara, nga rreziqet e mësipërme.

➤ **Sigurimi privat i shëndetit**

Ju tashmë e dini se ka një skemë shtetërore të sigurimit shëndetësor, nëpërmjet të cilës ju mund të bëni kontrolle dhe vizita, si dhe të kuroheni falas

apo kundrejt një shume të vogël parash në spitalet shtetërore. Por, në rast të sëmundjeve shumë të rënda, shërbimi shëndetësor shtetëror mund të mos ofrojë shërbimin që ju kërkoni, i cili mund t'ju kushtojë shumë në rast se do të shkoni në një klinikë apo spital privat. Sigurimi privat i shëndetit ju mundëson mbrojtje nga kostot dhe pasojat financiare në rast të këtyre sëmundjeve të papritura. Gjithashtu, përmes sigurimit privat të shëndetit, keni mundësinë të kontrolloni më shpesh shëndetin tuaj pasi të gjitha shpenzimet mjekësore dhe spitalore mbulohen nga kompania e sigurimit.



“... por ju nuk duhet të jeni shkaktar me dashje...”

Duhet të dini se shërbimet e mësipërme nuk ofrohen për të gjithë nga kompanitë e sigurimit. Kështu për shembull, një duhanpirës do ta kishte të vështirë të merrte një sigurim shëndetësor nga kompanitë e sigurimit, pasi me shumë gjasa, në jetën e tij ai do të vuajë nga sëmundje të shkaktuara nga duhanpirja. Këto sëmundje nuk janë më ngjarje të papritura, por ngjarje që kanë një mundësi të lartë që të ndodhin. Ose, në rast se dikush vuan nga një sëmundje e rëndë, me pasojë të sigurt vdekjen, asnjë kompani sigurimi nuk do t'i ofronte këtij personi sigurimin e jetës, pasi vdekja është një ngjarje e sigurt që do të ndodhë.

Gjithashtu, kompanitë e sigurimit nuk mbulojnë humbjet financiare të çdo ngjarjeje që ju ndodh, edhe pse ju mund të jeni siguruar për të. Ato vërtet marrin përsipër që t'ju kompensojnë në rast të ngjarjeve të pakëndshme, por ju nuk duhet të jeni shkaktar me dashje i tyre apo këto ngjarje nuk duhet të kenë ndodhur për pakujdesinë tuaj. Kështu për shembull, kompanitë mund të mos paguajnë në rast se:

- Ju keni siguruar banesën tuaj nga zjarri, por vërtetohet se e keni vendosur vetë zjarrin për të marrë kompensimin;

- Ju keni në zotërim një pikturë me vlerë dhe keni blerë një sigurim ndaj vjedhjes për të. Kusht i kontratës së sigurimit është që ju të keni një sistem sigurie shumë të mirë kundra hyrjes në banesën tuaj. Në rast se ju harroni të aktivizoni sistemin e sigurimit dhe ju vjedhin pikturën, kompania e sigurimit me siguri që nuk do t'ju paguajë.

PYETJE ?

- 1. Çfarë është rreziku? Si mund ta kontrollojmë atë?*
- 2. Çfarë janë sigurimet? Cilat janë llojet e ndryshme të sigurimit?*
- 3. Listoni palët kryesore të përfshira në një sigurim. Jepni shembuj të marrëdhënies së këtyre palëve në lloje të ndryshme të sigurimit.*
- 4. Përshkruani karakteristikat kryesore të një procesi sigurimi.*

Arsyetoni

- 1. Kur një kompani sigurimi nuk merr përsipër të ofrojë shërbimin e sigurimit? Ilustrojeni me shembuj.*
- 2. Kur një kompani sigurimi mund të mos pranojë një kërkesë për kompensim? Ilustrojeni me shembuj.*

Detyra

- 1. Merrni informacion mbi shërbimet e sigurimit të ofruara nga kompanitë e sigurimit në Shqipëri, nëpërmjet faqeve të*

tyre të internetit ose duke vizituar zyrat e tyre. Njihuni me karakteristikat e shërbimeve të sigurimit që ato ofrojnë dhe prezantojani ato edhe shokëve tuaj të klasës.

2. Mundohuni të gjeni kopje të disa policave të sigurimit. Ndahuni në grupe dhe analizoni specifikat e tyre. Gjeni blerësin, të siguruarin, përfituesin, shumën maksimale të mbulimit, rastet kur kompania e sigurimit do të paguajë kompensimin, etj.

13. TAKSAT, TATIMET DHE SIGURIMET SHOQËRORE E SHËNDETËSORE

Në një formë apo në një tjetër të gjithë paguajmë taksa. Taksat përbëjnë një aspekt të rëndësishëm të jetës së gjithsecilit prej nesh. Paga jonë “korrigjohet” nga taksat. Blerja dhe shitja e një shtëpie, kursimi dhe investimi i kursimeve, nisja e një biznesi, janë të gjitha procese që ndikohen nga sistemi i taksave dhe tatimeve në fuqi.

13.1 TAKSAT DHE TATIMET

Në mënyrë që shteti të përmbushë detyrat e tij, i nevojiten të ardhura monetare. Taksat dhe tatimet formojnë pjesën kryesore të të ardhurave të shtetit (rreth 90% të buxhetit të shtetit) dhe e drejta për të vendosur taksa dhe tatime mbi qytetarët e një vendi është monopol vetëm i shtetit. Historikisht, paratë e mbledhura nga taksat janë përdorur për qëllime të ndryshme, që shkojnë nga mbulimi i shpenzimeve për luftëra, tek përforcimi i ligjit dhe rendit publik, mbrojtja e pronës dhe ndërtimi i infrastrukturës publike.

A e dini se?

Na duhet të kthehemi shumë pas në kohë, për të gjetur sistemin e parë të taksave. Rreth viteve 3000-2800 para Krishtit, në Egjiptin e lashtë, faraoni zhvillonte një udhëtim dyvjeçar nëpër mbretërinë e tij për të mbledhur taksa nga populli. Fakte të tjera flasin për dëftesa hambari mbi shtresa guri gëlqeror dhe papirusi. Më vonë, në Perandorinë Perse, gjejmë një sistem të rregulluar dhe të qëndrueshëm taksash, të cilin Dari I i Madhi

në vitin 500 para Krishtit e kishte përshtatur për çdo Satrap (njësi administrative e drejtuar nga satrapi ose guvernatori).

Përveç se **financojnë** shpenzimet dhe investimet e ndërmarra nga shteti, taksat dhe tatimet kryejnë edhe dy funksione të rëndësishme ekonomiko-sociale të shtetit: funksionin e rishpërndarjes dhe funksionin e riçimitit. **Funksioni i rishpërndarjes** realizohet duke përdorur sistemin e taksave dhe tatimeve për të transferuar një pjesë të pasurisë së më të pasurve tek shtresat më të varfra të popullsisë (për shembull, në formën e asistencës sociale). **Funksioni i riçimitit** ka të bëjë me ndikimin e çmimeve të produkteve të caktuara nëpërmjet politikës së taksave. Për shembull, duhani dhe pijet alkoolike kanë akciza të larta, të cilat i bëjnë ato më të shtrenjta dhe në këtë mënyrë, dekurajohet përdorimi i tepruar i këtyre produkteve të konsideruara të dëmshme për shëndetin.

Llojet e taksave dhe tatimeve

Midis taksave dhe tatimeve ka një dallim të rëndësishëm. **Taksa** është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme, të cilën qytetarët e paguajnë kundrejt përfitimit të një shërbimi publik. Të ardhurat nga taksat shkojnë pikërisht për të financuar ofrimin e këtij shërbimi nga shteti apo pushteti vendor. Kështu për shembull, taksa e pastrimit është një taksë e vendosur nga pushteti vendor. Atë e paguajnë të gjithë qytetarët e një bashkie, kundrejt shërbimit të pastrimit të qytetit. Të ardhurat nga kjo taksë përdoren nga bashkia për të blerë pajisjet e nevojshme të pastrimit, për të paguar personat apo bizneset që pastrojnë qytetin.

Tatimi është gjithashtu një detyrim financiar i personave fizikë dhe juridikë të një vendi, por ai nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me ofrimin e një shërbimi të caktuar. Tatimet paguhën më tepër në bazë të të ardhurave ose fitimeve të realizuara, apo mallrave që konsumohen. Të ardhurat nga

tatimet përdoren për të mundësuar një sërë shërbimesh e të mirash publike, si mbrojtja, infrastruktura, arsimi etj.

Në jetën tuaj të përditshme si qytetarë do të ndesheni me një sërë detyrimesh financiare në formë taksash dhe tatimesh për t'i paguar shtetit. Më poshtë do të shohim disa nga më të rëndësishmet prej tyre.

Tatimi mbi të ardhurat nga paga

Të gjithë individët që realizojnë të ardhura brenda territorit të Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen detyrimit për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale. Forma më e prekshme dhe më e hasur e tatimit mbi të ardhurat personale është tatimi mbi të ardhurat personale nga paga dhe shpërblime të tjera. Tatimi mbi të ardhurat personale në Shqipëri aplikohet sipas mënyrës progresive të llogaritjes dhe më konkretisht:

- për pagat 0-50,000 lekë është 0%;
- për pagat 50,000-60,000 lekë është 0% deri në 35,000 lekë dhe 13% për shumën e mbetur;
- për pagat 60,001-200,000 lekë është 0% deri në 30,000 lekë, 13% për shumën mbi 30,000 lekë;
- për pagat mbi 200,000 lekë është 0% deri në 30,000 lekë, 13% për intervalin 30,001 – 200,000 lekë (=22,100 lekë) +23% e shumës mbi 200,000 lekë.

Kjo do të thotë se, për individët e dy fashave të fundit, një pjesë e të ardhurave bruto nga puna (paga + shpërblime) i derdhet shtetit në formën e tatimit mbi të ardhurat personale. Tatimi llogaritet dhe mbahet nga punëdhënësi për llogari të shtetit.

Tatimi mbi të ardhurat personale nga paga llogaritet si më poshtë:

E ardhura nga paga		E ardhura e tatueshme		Norma tatimore në përqindje mujore
(në lekë/muaj)		(në lekë/muaj)		
Nga	Deri në (përfshirë)	Nga	Deri në (përfshirë)	
0	50,000	0	50,000	0%
50,001	60,000	0	35,000	0%
		35,001	60,000	13% të shumës mbi 35,000
60,001	Më tepër	0	30,000	0%
		30,001	200,000	13% e shumës mbi 30,000
		200,001	Më tepër	22,100 lekë + 23% të shumës mbi 200,000 lekë

Shembull 1: Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat nga paga

Babai juaj punon si financier në një kompani private. Paga e tij bruto është 120,000 lekë në muaj. Përveç kësaj, një herë në vit, pas mbylljes së rezultatit financiar të kompanisë, ai merr edhe një shpërblim të barabartë me dy paga bruto. Sa është tatimi mbi të ardhurat personale, që paguan babai juaj në vit?

Norma e tatimit mbi të ardhurat, në këtë rast, është 0% për shumën deri në 30,000 lekë të pagës bruto dhe 13% për pjesën e mbetur të pagës bruto. Çdo muaj, detyrimi i babait tuaj ndaj shtetit për tatimin mbi të ardhurat personale është sa 13% e vlerës mbi 30,000 lekë të pagës së tij bruto.

$$\begin{aligned}
 \text{Tatimi mbi të ardhurat nga paga} &= 30,000 \text{ lekë} \times 0\% + (120,000 - 30,001) \times 13\% \\
 &= 0 + 89,999 \times 13\% \\
 &= 11,700 \text{ lekë}
 \end{aligned}$$

Pas mbylljes së rezultatit financiar të kompanisë, babai përfiton një shpërblim të barabartë me pagën mujore. Ai është i detyruar të paguajë tatim mbi të ardhurat personale edhe për shpërblimin e përfituar. Në këtë rast, tatimi llogaritet mbi shumën e të ardhurave nga paga e atij muaji dhe nga shpërblimi si një e tërë, pra 240,000 lekë. Tatimi mbi të ardhurat personale në këtë rast do të llogaritej:

Nga viti 2014, tatimi mbi të ardhurat personale në Shqipëri llogaritet sipas mënyrës progresive.

0% për shumën deri në 30,000 lekë të të ardhurave bruto, 13% për vlerën (30,001 - 200,000 lekë), dhe 23% për shumën mbi 200,000 lekë.

$$\begin{aligned} \text{Tatimi mbi të ardhurat} &= 30,000 \times 0\% + (200,000 - 30,001) \times 13\% + \\ &(240,000 - 200,001) \times 23\% \\ &= 0 + 22,100 + 9,200 \\ &= 31,300 \text{ lekë} \end{aligned}$$

Në vit, babai juaj paguan 159,998 lekë tatim mbi të ardhurat nga puna (11,700 lekë në muaj x 11 muaj + 31,300 lekë në fund të vitit).

Tatimi mbi të ardhura të tjera personale

Përveç tatimit mbi pagat, individët janë edhe subjekt i tatimit të të ardhurave të tjera personale, siç mund të jenë të ardhurat nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, të ardhurat nga drejta e autorit, pronësia intelektuale, etj. Në këtë rast, norma e tatimit është 15%. Individët janë edhe subjekt i fitimeve të realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme, nga shitja e makinës apo sendeve të tjera, nga investimi i kursimeve në depozita bankare apo në bono thesari. Edhe për këto, norma e tatimit është 15%.

Shembull 2: Llogaritja e tatimit mbi fitimin nga shitja e një pasurie të patundshme

Prindërit tuaj kanë blerë një apartament para 5 vjetësh me një çmim prej 5 milionë lekësh. Sot ata e rishesin këtë apartament me një çmim prej 7 milionë lekësh. Sa është tatimi mbi fitimin që duhet të paguajnë prindërit tuaj?

$$\text{Tatimi mbi fitimin} = 15\% \times \text{Fitimin}$$

Fitimi i realizuar nga prindërit tuaj prej shitjes së apartamentit është i barabartë me diferencën mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes.



Fitimi i realizuar nga shitja e një pasurie të patundshme tatóhet në masën 15%.

$$\text{Fitimi} = 7 \text{ milionë lekë} - 5 \text{ milionë lekë} = 2 \text{ milionë lekë}$$

$$\text{Tatimi mbi fitimin} = 15\% \times 2 \text{ milionë lekë} = (15/100) \times 2,000,000 = 30,000 \text{ lekë}$$

Shembull 3: Llogaritja e tatimit mbi interesin e depozitës

Erjona ka depozituar në bankë 50,000 lekë, në një depozitë me afat 1-vjeçar, me një normë interesi 6%. Sa është tatimi i paguar mbi interesin e fituar nga kjo depozitë?

$$\text{Interesi} = 6\% \times 50,000 = (6/100) \times 50,000 = 3,000 \text{ lekë}$$

$$\text{Tatimi} = 15\% \times \text{Interesin} = (15/100) \times 3,000 = 450 \text{ lekë}$$

Tatimi mbi të ardhurat personale dhe fitimin është një **tatim direkt**. Në përditshmërinë tonë jemi subjekt edhe i një forme tjetër tatimi, tatimit indirekt. **Tatimi indirekt** përfshihet në vlerën e çmimit të produktit, shërbimit apo mallrave të ndryshëm. Ai quhet shpesh tatim i pandjeshëm, për shkak se është pjesë e çmimit të blerjes së një të mire ose shërbimi. Konsumatori e paguan tatimin indirekt si pjesë të çmimit dhe është shitësi apo ofruesi i shërbimit ai i cili ka detyrimin ligjor ta mbledhë, deklarojë dhe derdhë këtë tatim pranë organeve përkatëse.

Tatimi indirekt më i hasur është ai **mbi vlerën e shtuar** (TVSH), i cili është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve në proporcion me çmimin e tyre dhe që e paguajmë sa herë blejmë pjesën më të madhe të të mirave dhe shërbimeve. Në Shqipëri, tatimi mbi vlerën e shtuar është 20%. Përjashtim bëjnë disa mallra të caktuara që kanë një normë TVSH-je më të ulët si për shembull, librat apo ilaçet.

Për shembull, ju paguani 120 lekë për një kuti me karamеле. Ky është çmimi përfundimtar i kutisë së karameleve, i cili përfshin edhe TVSH-në. Çmimi pa TVSH i karameles është



100 lekë, TVSH-ja është 20% e çmimit pa TVSH, pra $100 \times 20\% = 20$ lekë. Në faturat tatimore që shitësit ju japin kur blini mallra, mund të vini re të tre këta zëra: çmimin pa TVSH, TVSH-në dhe çmimin me TVSH apo çmimin përfundimtar.

Më sipër trajtuam llojet kryesore të tatimeve, të cilat kanë subjekt të ardhurat dhe fitimet e ndryshme të individëve. Ndërkohë, ndër taksat që ju apo familjarët tuaj paguajnë janë taksa e pastrimit dhe e gjelbërimit, taksa e televizionit publik, taksa e zotërimit të një pasurie të paluajtshme etj.

Taksat sjellin reduktim të të ardhurave të disponueshme të individëve, por ato vilen për t'i ofruar komunitetit një sërë të mirash dhe shërbimesh publike. Një nivel më i ulët taksash do të nënkuptonte më pak shërbime të ofruara nga autoritetet publike. Për të kuptuar më mirë se cili prej pushteteve ofron cilat shërbime publike në Shqipëri (që financohen kryesisht nga taksat tona), ju ftojmë të shikoni tabelën më poshtë.

Llojet e shërbimeve publike të ofruara nga pushteti qendror dhe vendor

Pushiteti qendror (qeveria)	Pushiteti vendor (bashkitë dhe komunitat)
infrastrukturë rrugore	transport urban
vepra inxhinierike (hidrocentrale)	kopshte dhe çerdhe
sistem shëndetësor publik	pastrim dhe largim të mbeturinave
sistem arsimor	gjelbërim
mbrojtje kombëtare	mirëmbajtje urbanistike
ruajtje e rendit publik	shërbim social për për strehim
administrim i burgjeve	
shërbim zjarrfikës	

13.2 SIGURIMET SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Në piramidën e nevojave të përshkruar nga psikologu amerikan Abraham Maslow, nevoja për siguri (shëndetësore, për punën dhe pronën) paraqitet e dyta në rëndësi pas nevojave jetike si ngrënia, pirja, fjetja, frymëmarrja etj.

Sigurimi shoqëror (duke përfshirë dhe sigurimin shëndetësor) është një sistem që siguron një ndihmë ekonomike, si dhe një akses drejt nevojave thelbësore (edukim, higjienë, sistem shëndetësor) për të gjithë individët (jashtë periudhave të fatkeqësive natyrore ose katastrofave). Sigurimi shoqëror është pjesë e politikës sociale të një shteti, e cila është e integruar brenda politikave publike.

Në Shqipëri kemi dy sisteme të veçanta: sistemin e sigurimeve shoqërore, i cili administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore⁶ dhe atë të sigurimeve shëndetësore, i administruar nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor⁷.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore është një sistem jofitimprurës dhe mbështet me të ardhura personat ekonomikisht joaktivë, me kontributet e atyre që punojnë. Këto kontribute shërbejnë për të financuar pagesat në rastet e paaftësisë së përkohshme në punë për shkak të sëmundjes; barrë lindjes; pleqërisë, invaliditetit dhe humbjes së mbajtësit të familjes; aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale; papunësisë.

⁶ Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në adresën www.iss.gov.al.

⁷ Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në adresën <https://www.fsdksh.com.al/en/>.

Skema e sigurimeve shoqërore financohet nga kontributet e punëdhënësve, punëmarrësve, të vetëpunësuarve dhe të shtetit. Kontributi që paguhet për sigurimet shoqërore të detyrueshme në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrëlindje, pensione, etj., është 24.5% e pagës bruto, ku pjesa:

- për punëdhënësin është 15.0% e pagës bruto të çdo punonjësi dhe;
- për personin e punësuar, 9.5% e pagesës së tij totale bruto,

por jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përveç sigurimit të detyrueshëm, individët mund të paguajnë **sigurime vullnetare**, për të siguruar përfitime pensionale shtesë në të ardhmen. Këto pagesa shkojnë përtej shumave të caktuara në “Ligjin për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk janë të detyrueshme nga shteti.

Për një kategori të caktuar pozicionesh pune, kryesisht për punonjës të cilët kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësit e shtetit, është i detyrueshëm kontributi në fondin e sigurimit suplementar. Masa e kontributit në fondin e **sigurimit suplementar** paguhet mbi pagën bruto, në përqindje (5, 4 ose 3% e pagës bruto) në funksion të grupit të punës të përcaktuar në ligjin përkatës.

Të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore, si për shembull pagesat gjatë lejes së lindjes, janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi. Sistemi i sigurimeve shëndetësore synon të ofrojë një shërbim shëndetësor bazë për çdo shtetas të siguruar.

Sistemi i sigurimeve shëndetësore të detyrueshme është një sistem jofitimprurës që mbulon shpenzimet për:



Sistemi i sigurimeve shëndetësore mbulon shpenzimet për një pjesë të barnave në rrjetin farmaceutik.

- një pjesë të çmimit të barnave në rrjetin farmaceutik;
- shërbimin e mjekut të përgjithshëm ose të familjes për të gjithë shtetasit në Shqipëri që kanë derdhur kontribute;
- të gjitha shërbimet e ekzaminimeve, të trajtimeve dhe të konsultave mjekësore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Për përfitimin nga sigurimet shëndetësore, personi i siguruar pajiset me kartën e shëndetit. Masa e kontributit për personat e punësuar është 3.4% e pagës mujore bruto, nga të cilat 1.7% i paguan punëdhënësi dhe 1.7% i paguan i punësuari.

HAPËSIRË INFORMUESE:

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Kontributi i të vetëpunësuarit për sigurimet shoqërore është në masën 23% të pagës, por jo më pak se paga minimale mujore, ndërsa për sigurimin e kujdesit shëndetësor, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore.

Në llogaritjen e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore duhen pasur parasysh edhe paga minimale mujore dhe ajo maksimale mujore. Këto përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe rishikohen herë pas here, për të siguruar një rishpërndarje të drejtë të të ardhurave. Aktualisht, duke filluar nga data 1 prill 2023, për llogaritjen e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, paga minimale mujore është jo më pak se 40,000 lekë, ndërsa paga maksimale mujore është 176,416 lekë. Pra, edhe personat që kanë një pagë më të lartë se 176,416 lekë paguajnë një vlerë të barabartë kontributesh për sigurimet shoqërore, me ata që përfitojnë një pagë prej 176,416 lekësh.

Si llogariten sigurimet shoqërore dhe shëndetësore?

Pagesat për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe për atë të sigurimeve shëndetësore funksionojnë në të njëjtën mënyrë si tatimi mbi të ardhurat nga paga. Ato llogariten dhe mbahen direkt nga punëdhënësi për llogari të shtetit.

Pra, **pagës bruto** i zbritet tatimi mbi të ardhurat (norma e tatimit progresiv), kontributi për sigurimet shoqërore (9.5%) dhe kontributi i sigurimeve shëndetësore (1.7%). Shuma që mbetet përbën **pagën neto** dhe kjo është shuma që kalon në llogarinë tonë të pagës në bankë.

Shembull: Në përfundim të shkollës, Iliri fillon punë pranë një zyre të vogël për shitjen e pasurive të paluajtshme dhe punëdhënësi e informon se paga mujore bruto e tij, do të jetë 70,000 lekë. A mund ta ndihmoni Ilirin të llogarisë pagën neto?

Më sipër mësuam se:

Paga neto = pagë bruto – tatim mbi të ardhurat personale – sigurime shoqërore – sigurime shëndetësore

Paga neto = 70,000 – [(70,000-30,001) x 0.13] – (70,000 x 0.095) – (70,000 x 0.017) = 70,000 – 5,200 – 6,650 – 1190 = 56,960 lekë

PYETJE ?

1. Përshkruani taksat për të cilat keni dëgjuar të flitet më shpesh? Bëni dallimin mes taksave dhe tatimeve.

Arsyetoni

Përse shërben vjelja e taksave dhe ku përfundojnë fondet e mbledhura në formën e taksave dhe tatimeve?

Detyra

1. Llogarisni vlerën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që një punëdhënës paguan, për të siguruar një të punësuar që përfiton një pagë bruto prej 85,000 lekësh.

2. Një biznesmen i ri është duke përgatitur planin e tij të biznesit dhe ndër të tjera i duhet të llogarisë dhe pagat e punonjësve. Ai mendon të punësojë 3 persona për 3 pozicione të ndryshme pune, të cilëve do t'u paguajë përkatësisht: 40,000 lekë, 67,000 lekë dhe 110,000 lekë.

Duke ditur që këto janë paga mujore bruto, llogarisni:

- a. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që do të paguajë secili punonjës;
- b. Pagat neto për secilin prej punonjësve;
- c. Totalin e kontributeve që biznesmeni duhet të derdhë për të siguruar punonjësit e tij;
- d. Shumën totale që do t'i kushtojë biznesmenit, punësimi i 3 punonjësve.

3. Llogarisni tatimin mbi të ardhurat/fitimet në situatat e mëposhtme:

- a. Fitimi nga shitja e një dyqani 100 m², me një çmim prej 100 mijë lekë/m². Dyqani është blerë më parë me një çmim prej 70 mijë lekë/m².
- b. Të ardhurat nga dhënia me qira e një apartamenti prej 50 mijë lekësh në muaj.
- c. Interesi i fituar nga depozitimi i një shume prej 60 mijë lekësh në një depozitë me afat 1-vjeçar dhe me normë interesi 7%.

FJALOR

Të ardhura bruto – të ardhurat nga puna apo aktivitete të tjera fitimprurëse, pa zbritur detyrimet për taksa dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Përgjithësisht, kjo përbën shumën e deklaruar në kontratën e punësimit.

Të ardhura neto – të ardhurat nga puna apo aktivitete të tjera fitimprurëse, pasi janë mbajtur detyrimet për taksa dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Kjo përbën shumën që në fund të muajit do të kemi në llogarinë personale.

PYETJE ?

1. Cili është roli i sistemit financiar në ekonomi?
2. Cili është roli i ndërmjetësve financiarë në ekonomi?
3. Cilat janë grupimet më të rëndësishme të institucioneve financiare? Përshkruani karakteristikat e secilit prej këtyre grupimeve.

Veprimtari praktike

Ndahuni në 5 grupe. Secili nga grupet të mbledhë informacion për një grup të ndërmjetësve financiarë (duke vizituar njërin prej tyre). Diskutoni dhe ndani me shokët informacionin e marrë.

FJALËR

Ndërmjetës financiarë – janë institucionet (të tilla si: banka, kompani sigurimi, fonde pensioni etj.) që marrin hua fonde nga individët ose bizneset dhe ua japin hua të tjerëve.

Banka – janë institucione financiare ku aktorët e ndryshëm të ekonomisë depozitojnë para dhe fitojnë interes, ndërsa disa të tjerë marrin hua dhe paguajnë interes.

